



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vorë**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

**të ushtruar në**

## **BASHKINË VORË**

**Tiranë, 2023**

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                              |                              |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| <b>SHKURTIME</b> .....                                                                                       | <b>3</b>                     |
| <b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....                                                                       | <b>4</b>                     |
| 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....                                                        | 4                            |
| 2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore .....                                                     | 4                            |
| 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....                                                 | 9                            |
| <b>II. HYRJE</b> .....                                                                                       | <b>12</b>                    |
| 1. Objekti i Auditimit.....                                                                                  | 12                           |
| 2. Qëllimi i auditimit.....                                                                                  | 12                           |
| 3. Identifikimi i çështjes.....                                                                              | 12                           |
| 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....                                                                | 12                           |
| 5. Përgjegjësitë e audituesve .....                                                                          | 12                           |
| 6. Kriteret e vlerësimit .....                                                                               | 13                           |
| 7. Standardet e auditimit .....                                                                              | 15                           |
| 8. Metodot e auditimit .....                                                                                 | 15                           |
| 9. Dokumentimi i auditimit.....                                                                              | 16                           |
| <b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....                                                                     | <b>18</b>                    |
| 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Vorë .....                                                        | 18                           |
| 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit .....                                              | 19                           |
| 2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik .....                                               | 19                           |
| 2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit .....                           | 28                           |
| 2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....                                                      | 56                           |
| 2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik .....                        | 67                           |
| 2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....                                               | 99                           |
| 2.6. Auditim mbi o Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit (IMTV).....                                       | 106                          |
| 2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm .....                             | 110                          |
| 2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit .....                                                              | 128                          |
| <b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b> .....                                                                    | <b>129</b>                   |
| A. Masa organizative .....                                                                                   | 130                          |
| B. Masa për shpërbllim dëmi.....                                                                             | 145                          |
| C. Masa për eliminimin e efekteve negative.....                                                              | 146                          |
| D. Masa për uljen e borxhit tatimor .....                                                                    | 147                          |
| E. Masa disiplinore.....                                                                                     | 149                          |
| F. Njoftim për Departamentin e Administratës Publike dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil..... | 153                          |
| G. Masa administrative .....                                                                                 | 153                          |
| <b>V. ANEKSET</b> .....                                                                                      | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit .....                                                       | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi të ardhurat .....                                                                                | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi pasqyrat financiare .....                                                                        | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi prokurimet publike.....                                                                          | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit .....                                                    | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Lejet e Ndërtimit .....                                                                          | Error! Bookmark not defined. |
| Anekset mbi Zbatimin e Rekomandimeve .....                                                                   | Error! Bookmark not defined. |

## SHKURTIME

|                |                                                                 |
|----------------|-----------------------------------------------------------------|
| <b>AAJM</b>    | Aktive Afatgjata Jo Materiale                                   |
| <b>AAM</b>     | Aktive Afatgjata Materiale                                      |
| <b>AK</b>      | Autoritet Kontraktor                                            |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara                             |
| <b>ASHK</b>    | Agjencia Shtetërore e Kadastrës                                 |
| <b>BOE</b>     | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë                                 |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve                                  |
| <b>GMS</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik                                   |
| <b>IFAC</b>    | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve                         |
| <b>INOTSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit  |
| <b>IPSAS</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik   |
| <b>ISA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit                           |
| <b>ISSAI</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit                                     |
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit                                     |
| <b>KPP</b>     | Komisioni i Prokurimit Publik                                   |
| <b>KVO</b>     | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave                              |
| <b>LPP</b>     | Ligji i Prokurimit Publik                                       |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli                               |
| <b>MAB</b>     | Manuali i Auditimit të Brendshëm                                |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues                                              |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative                                            |
| <b>NJAB</b>    | Njësia e Auditimit të Brendshëm                                 |
| <b>NJP</b>     | Njësia e Prokurimit                                             |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues                                                 |
| <b>OE</b>      | Operator Ekonomik                                               |
| <b>PF</b>      | Pasqyrat Financiare                                             |
| <b>QKB</b>     | Qendra Kombëtare e Biznesit                                     |
| <b>SHA</b>     | Shoqëri Anonime                                                 |
| <b>SHPK</b>    | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar                              |
| <b>SKK</b>     | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit                          |
| <b>UMF</b>     | Udhëzim i Ministrisë së Financave                               |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak                                     |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave                                |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Vorë dhe Ligjit nr. 139/15 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Vorë nga data 01.01.2018 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 16 Akte Konstatimi dhe 3 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

### 2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Ref. në Raport        | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Nga auditimi i analizave të llogarisë 202 “ <i>Studime dhe kërkime</i> ”, u konstatua se në fund të vitit 2021 paraqitej në vlerën 98,503,377 lekë dhe për periudhën ushtrimore 2022 paraqitej në vlerën 101,503,377 lekë. Diferenca e vitit ushtrimor 2022 me atë paraardhës prej 3,000,000 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15% e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2021. Vlera prej 101,503,377 lekë e mbetur në fund të vitit 2022, duhet të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “ <i>Studime dhe kërkime</i> ” si dhe nënvlerësimin e “ <i>Aktiveve Afatgjata Materiale</i> ” në shumën 101,503,377 lekë. Sa më sipër, është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “ <i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i> ”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “ <i>Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik</i> ” Pika 2, Klasa 2, “ <i>Aktivët afatgjata</i> ” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “ <i>Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël</i> ”, Seksioni II “ <i>Aktivët e Qëndrueshme të Patrupëzuara</i> ”, Pika 1/b “ <i>Klasifikimi kontabël</i> ”. | Pika 2.3., faqe 56-67 | E lartë  | Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vorë, të marrë masat për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin si vlerë e shtuar çdo aktivitet afatgjatë material mbi të cilin është kryer investim mbi bazën e projekt-studimeve, si dhe të sistemohet edhe llogaria 202 “ <i>Studime dhe kërkime</i> ” për vlerën 101,503,377 lekë. |
| 2   | Nga auditimi i regjistrimit të aktiveve të Bashkisë Vorë, u konstatua se nuk ka një regjistër të plotë për aktivet “ <i>Ndërtesa e konstruksione</i> ” dhe llogarisë 213 “ <i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i> ”, që zotëron apo ka                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Pika 2.3., faqe 56-67 | E lartë  | Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa që nëpërmjet strukturave të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur, ndërsa                                                                                                                                                                                                        |

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Ref. në Raport        | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Sa më sipër, është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> , pika 26 dhe pika 30.                                                         |                       |          | Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme si dhe të në mënyrë të saktë kryejë kontabilizimin e llogarisë 212 <i>“Ndërtesa dhe Konstruksiione”</i> . |
| 3   | Në mënyrë analitike në llogarinë nr. 213 <i>“Rrugë, rrjete, vepra ujore”</i> në fund të vitit 2022 janë regjistruar aktive me vlerë totale 4,137,982,916 lekë ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 4,175,682,822 lekë. Pra, diferenca prej 37,649,906 lekë nuk është paraqitur në mënyrë analitike në regjistrat e aktiveve në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> , pika 26 dhe pika 30.                                                                                                                                                                                          | Pika 2.3., faqe 56-67 | E lartë  | Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Vorë, të bëhet rakordimi me regjistrat e aktiveve të Bashkisë Vorë, për llogarinë nr. 213 <i>“Rrugë, rrjete, vepra ujore”</i> në vlerën 4,175,682,822 lekë.                                                                                    |
| 4   | Nga auditimi i pasqyrës 7/a <i>“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”</i> , u konstatua se nga ana e Bashkisë Vorë është reflektuar pakësimi i aktiveve, e cila nuk është bërë bazuar në procedurën e asgjësimit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> .                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Pika 2.3., faqe 56-67 | E lartë  | Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa në vijimësi për ngritjen e komisioneve të asgjësimit të aktiveve, kur nga komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimi.                                                       |
| 5   | Nga auditimi i llogarisë nr. 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtje”</i> , u konstatua se në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet vlera kontabël prej 56,077,560 lekë, vlerë kjo e cila është e parakorduar me degën e thesarit Tiranë. Mosrakordimi i vlerës së llogarisë 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtje”</i> ndërmjet Bashkisë Vorë dhe Degës së Thesarit Tiranë rezulton me diferencë në vlerën 167,000 lekë, veprim ky në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 <i>“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”</i> , i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022. | Pika 2.3., faqe 56-67 | E lartë  | Drejtoria e Financës në Bashkinë Vorë të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me degën e thesarit llogarinë 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtje”</i> , për vlerën 167,000 lekë dhe sistemimin e saj në kontabilitet.                                                      |
| 6   | Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt <i>“Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë”</i> dhe <i>“Shërbimi i pastrimit të mbeturinave, emergjenca 90 ditë”</i> , llogaritja e fondit limit është bërë në kundërshtim me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 <i>“Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”</i> , pika 1 <i>“Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes”</i> , duke mos aplikuar formulën përkatëse                                                                                                                                                                                                | Pika 2.4., faqe 67-99 | E lartë  | Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mirëtrajnuar, si dhe të përdoren eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim  |

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Ref. në Raport        | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | për llogaritjen e banorëve rezidentë. Nga Bashkia Vorë nuk është bërë asnjë studim, në bazë të së cilit të mos merrej në konsideratë formula e dhënë në VKM-në në fjalë. Nga grupi i auditimit u konstatua se edhe zërat e tjerë të preventivit janë rritur në mënyrë fiktive, të paargumentuara dhe të pambështetura në manualët dhe metodikat në fuqi, si p.sh. larja e rrugëve ditën dhe natën jashtë qendrave të banuara, larja e konteinerëve me pajisje të posaçme, mbivendosja e pastrimit të vend-grumbullimit të mbeturinave, etj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                       |          | mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 7   | Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 77, “Kriteret për kualifikim”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve”, pika 5, VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pika 1 “Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes”, etj. | Pika 2.4., faqe 67-99 | E lartë  | Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike. |
| 8   | Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Pika 2.4., faqe 67-99 | E lartë  | Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.                                                                         |

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Ref. në Raport         | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit, etj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                        |          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| 9   | Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatuan probleme në lidhje me protokollimin e procesverbaleve, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12, 14 dhe 18.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Pika 2.4., faqe 67-99  | E lartë  | Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Vorë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë. |
| 10  | Nga auditimi, u konstatua se për lejen e ndërtimit të objektit “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik nuk pasqyrohen numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet, në bazë të legjislacionit në fuqi. Për lejen e ndërtimit të objektit “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë, në planvendosjen e miratuar nuk janë pasqyruar të dhënat e plota të parametrave të zhvillimit. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15, pika 1, germa c, “Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese”; | Pika 2.5., faqe 99-106 | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të gjithë elementët e nevojshëm në planvendosjen e paraqitur, përfshirë numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet ndërtimi i ri dhe të dhënat e sakta të treguesve të zhvillimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.                                        |
| 11  | Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objekteve. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar me VKM nr. 457, datë 29.6.2022, neni 27 ku përcaktohet ndryshimi i nenit 34, distanca minimale midis ndërtimeve, pika 3;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Pika 2.5., faqe 99-106 | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar distancat ndërmjet ndërtimeve dhe të respektohet distanca minimale për aksesin ndërmjet dy ndërtimeve që gjenden përballë njëri-tjetrit.                                                                                                     |
| 12  | Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Pika 2.5., faqe 99-    | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me                                                                                                                                                                                                                                    |

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Ref. në Raport         | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | objektit dhe kufirit të pronës sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:<br>1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;<br>2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”.                                                                                                                                                                                                                                                          | 106                    |          | kriteret ligjore dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.                                                                                                                                 |
| 13  | Nga auditimi, u konstatua se në objektin “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, lartësia e përgjithshme e ndërtimit e tejkalon lartësinë e lejuar, në mospërputhje me kondicionet urbane të përcaktuara sipas njësisë VO_UB_A2_9-1. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 20, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”, pika 1, gërma a;                                                                                                                                                                                                                      | Pika 2.5., faqe 99-106 | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në planvendosje, të cilat duhet jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse. |
| 14  | Nga auditimi, u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit. Mungon marrëveshja ndërmjet palëve për kontributin e krijimit të fondit publik të banesave sociale, në lejet e ndërtimit me objekte:<br>1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;<br>2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” dhe me Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 19. | Pika 2.5., faqe 99-106 | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.                                        |
| 15  | Nga auditimi, u konstatua se nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse për lejet e ndërtimit me objekt:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Pika 2.5., faqe 99-    | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme nga institucionet                                                                                                                                                         |

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Ref. në Raport         | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                           |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | 1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;<br>2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 3. | 106                    |          | përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje ndërtimi dhe të vijohet me miratimin e lejes së ndërtimit pas konformitetit të tyre.                      |
| 16  | Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Magazinë 1 kat dhe zyra 2 kat me mur rrethues”, miratuar me vendimin nr. 2466/5, datë 16.08.2022, me zhvillues “S.C.” ShPK, në Prezë, Vorë, nuk është konvertuar resursi i tokës nga “arë” në “truall”. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Vendimin nr. 440, datë 3.6.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 410, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës””, pika 6;                         | Pika 2.5., faqe 99-106 | E lartë  | Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse. |

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### **I. Opinion i Modifikuar mbi Pasqyrat Financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Vorë, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Vorë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde përshkruhen më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n”. Ne i kemi përmbytur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të

siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **21,948,077** lekë për shpenzimet dhe **27,512,034** lekë për të ardhurat.

**Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:**

- Llogaria nr. 202 “*Studime dhe kërkime*”, është pasqyruar më pak për vlerën 101,503,377 lekë;
- Llogaria nr. 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, është pasqyruar më shumë për vlerën 56,077,560 lekë lekë;
- Llogaria nr. 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksiione*”, është pasqyruar më pak për vlerën 547,392,330 lekë;
- Llogaria nr. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, është pasqyruar më pak për vlerën 3,658,587,665 lekë;
- Nga ana e Bashkisë Vorë është bërë pakësimi i aktiveve pa u bërë procedurat e asgjësimit të tyre.

**II. Opinion i Kundërt për përputhshmërinë:**

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Vorë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Vorë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Vorë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “*Baza për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

**Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:**

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>1</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

1. Duke pasur parasysh vështirësinë financiare të subjektit, si rezultat i shkeljes së disiplinës buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e eficiencës së shpenzimeve.
2. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “*Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë*” dhe “*Shërbimi i pastrimit të mbeturinave, emergjenca 90 ditë*”, u konstatua se llogaritja e fondit limit është bërë duke mos aplikuar formulën përkatëse për llogaritjen e banorëve rezidentë. Nga Bashkia Vorë nuk është bërë asnjë studim, në bazë të së cilit të mos merrej në konsideratë formula e dhënë në VKM-në në fjalë. Nga grupi i auditimit u konstatua se edhe zërat e tjerë të preventivit janë rritur në mënyrë fiktive, të paargumentuara dhe të pambështetura në manualet dhe metodikat në fuqi, si p.sh. larja e rrugëve ditën dhe natën jashtë qendrave të banuara, larja e kontenerëve me pajisje të posaçme, mbivendosja e pastrimit të vend-grumbullimit të mbeturinave, etj.
3. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.
4. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.202, u konstatua se në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

<sup>1</sup> ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

5. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatuan probleme në lidhje me protokollimin e procesverbaleve.

6. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan shkelje dhe mangësi të ndryshme, si më poshtë:

- Në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik nuk pasqyrohen numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet;
- Nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objekteve;
- Nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës;
- Lartësia e përgjithshme e ndërtimit e tejkalon lartësinë e lejuar;
- Mungon marrëveshja ndërmjet palëve për kontributin e krijimit të fondit publik të banesave sociale;
- Nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse;
- Nuk është konvertuar resursi i tokës nga “arë” në “truall”.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vorë:**

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 520/1, datë 20.06.2023 “Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Vorë”, i ndryshuar me shkresën nr. 520/2, datë 18.07.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Vorë”, nga data 26.06.2023 deri në datën 04.08.2023, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., Përgjegjës Grupi;
2. S.J.;
3. K.F.;
4. K.P.;
5. O.F. dhe
6. A.K., anëtarë.

### **1. Objekti i Auditimit**

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Kryetari i Bashkisë, z. B.Sh., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. S.B., Drejtor i Menaxhimit Financiar, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Vorë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
  - Ligji nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse *“Për buxhetin vjetor”* dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
  - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *“Për huamarrjen e qeverisjes vendore”*
  - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *“Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”*, i ndryshuar;
  - VKM 783 datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”*;
  - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 *“Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”*;
  - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*;
  - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”*, etj;
  - Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar;
  - Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
  - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *“Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”* ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
  - Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *“Për përgatitjen e buxhetit vendor”*;
  - Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 *“Për buxhetin e vitit 2018”*, pikat 82-91 *“Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”*,

- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

**Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**

- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

**Në fushën e prokurimeve publike:**

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:**

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;

- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

**Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

**7. Standardet e auditimit**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

**8. Metodatat e auditimit**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që

auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

#### Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

#### ▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

#### ▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

#### ▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

#### ▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### ▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### ▪ Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### ▪ Intervista

#### ▪ Raporte dhe Informacione

#### ▪ Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK

### 9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualin e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për

të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi

dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Vorë

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Vorës shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkinë Krujë, në lindje me bashkinë Kamëz, në jug me bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me bashkinë Shijak dhe në lindje me bashkinë Durrës.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Vorë ka 25,511 banorë ndërsa sipas Regjistrat Civil ka 36,230 banorë. Me një sipërfaqe prej 82.72 km<sup>2</sup>, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të censurit është 308 banorë km<sup>2</sup> ndërsa sipas Regjistrat Civil, densiteti është 438 banorë km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Vorës shtrihet në kryqëzimin kryesor rrugor të Shqipërisë ku lidhet Tirana me Durrësin dhe veriu me jugun e vendit. Për rrjedhojë, në territorin e kësaj bashkie janë vendosur një pjesë e rëndësishme e industrisë së lehtë dhe të ndërtimit ndërsa bujqësia është përqendruar në disa produkte me vlerë të lartë të shtuar si lulet. Në Bashkinë e Vorës janë të regjistruara mbi 800 biznese të mëdha.

Në ish-komunën Prezë gjendet një kala mesjetare e cila përbën në resurs të vogël turistik. Vora dhe tri njësitë përbërëse kanë parë rritje të shpejtë të popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit, gjë që ka sjellë edhe një numër të konsiderueshëm ndërtimesh jashtë planeve urbanistike dhe pa infrastrukturë.<sup>2</sup>



##### Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me Urdhërin nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësi Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2022”.

##### Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

| Emri i Njësi    | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre                                             |
|-----------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Vorë</b>     | Qyteti Vorë, Fshatrat: Vorë, Marqinet, Shargë, Gerdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar   |
| <b>Prezë</b>    | Fshatrat: Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç- Kodër, Ndërmjetës, Breg – Shkozë |
| <b>Bërxullë</b> | Fshatrat: Bërxullë, Mukaj, Domje                                                     |

##### Kuadri ligjor:

Bashkia Vorë e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Vorë është z. B.Sh. dhe Këshilli Bashkiak i Vorës përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët janë mandatuar zgjedhjet e datës 28 qershor 2023.

<sup>2</sup> Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-vore/pasaporta-e-bashkise-vore/>

## 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

**2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.**

#### **1. Mbi mjedisin e kontrollit:**

Bashkia Vorë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, referuar në Urdhër Nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”. Grupi i punës ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi është gjithë administrata e Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative. Para hartimit të kësaj rregulloreje, Bashkia Vorë ka funksionuar gjithë vitin 2022 me rregulloren e hartuar dhe miratuar me Urdhër Nr. 27, datë 20.04.2018, nr. 1776 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njesisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.

Bashkia Vorë funksionon bazuar në Kodin e Etikës, Urdhër Nr. 235, datë 30.12.2022, nr. 7555 prot., që është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vorë. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, në të cilin është mbështetur Njësia Publike për hartimin e tij.

#### **Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:**

Për vitin 2022, për një pjesë të periudhës Bashkia Vorë ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 07, datë 07.01.2021, nr. 96 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërçull për vitin 2021”, më pas duke filluar nga muaji maj i vitit 2022 e deri në fund të këtij viti, Bashkia Vorë ka funksionuar bazuar në strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërçull për vitin 2022”.

Numri i punonjësve në Bashkinë Vorë, referuar Strukturës së Detajuar duke filluar nga muaji maj 2022, ka qenë si vijon, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në administratën e Bashkisë Vorë, 404 punonjës, në Njësine Administrative Prezë 37 punonjës dhe në Njësine Administrative Bërçullë 46 punonjës. Në total numri i punonjësve për vitin 2022 ka qenë **487 punonjës**.

Referuar shkresës nr. 332 prot., datë 03.07.2023, për pozicionet e punës trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, në muajin janar 2022 kanë qenë 55 punonjës me status, 366 punonjës me kontratë pune dhe 66 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 421. Ndërsa në dhjetor 2022 kanë qenë 98 punonjës me status, 329 punonjës me kontratë pune dhe 60 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 427.

**Tabela nr. 1.** Mbi rekrutimin e punonjësve në Bashkinë Vorë

| Nr. | Viti 2022    | Np. Civil | Kontratë Pune | Nr. Përgjithshëm | Vakanca |
|-----|--------------|-----------|---------------|------------------|---------|
| 1.  | Janar 2022   | 55        | 366           | 421              | 66      |
| 2.  | Dhjetor 2022 | 98        | 329           | 427              | 60      |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Nga dosjet e përzgjedhura, për punonjësit e emëruar gjatë vitit 2022, në to është përfshirë i gjithë dokumentacioni duke filluar nga inventari i dosjes, njoftimi me email për fazën e verifikimit paraprak, testimi me shkrim i kandidatit, rezultatet e testimit me shkrim, njoftim për rezultatet e konkursit, formular i përshkrimit të punës, dokumentacioni i punonjësit, deklaratat e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, urdhër për zbatimin e aktit të emërimit etj.

Përsa i takon trajnimeve të punonjësve, në Bashkinë Vorë Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve për vitin 2022. Të vetmet trajnime që ndiqen nga stafi janë ato të planifikuara nga ASPA.

## **2. Mbi menaxhimin e riskut:**

Regjistri i Riskut për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 12, pika 3 d).

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika a).

## **3. Mbi veprimtaritë e kontrollit:**

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 55, nr. 2064 prot., datë 21.04.2022, “Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022 - 2024”, në Bashkinë Vorë, GMS është i përbërë nga 17 anëtarë.

Në Bashkinë Vorë nuk ka një urdhër ku të përcaktohet koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik, por pas intervistës me Drejtorin e Financës, detyrën si koordinator risku e ushtron znj. A.B., e cila bazuar në Urdhër Nr. 286, nr. 2332 prot., datë 16.03.2021, është e emëruar në pozicionin Specialist Risku në Sektorin e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar. Mungesa e një urdhëri specifik, që përcakton në mënyrë të qartë personin që do jetë koordinator i riskut, është veprim në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 10.

### **Vendime të GMS:**

Në Bashkinë Vorë nuk janë të dokumentuara në formë shkresore minutat e takimit për mbledhjet që ka kryer GMS për vitin 2022. Nisur nga ky fenomen, vihet re mospërgatitja e disa dokumentave si plani i veprimit për arritjen e objektivave, plani për kontrollin e brendshëm, plani vjetor i punës i Drejtorisë së Financës etj., të cilat janë rezultat i mbledhjeve që duhet të realizojë GMS dhe vendimeve që merren në to. Ky veprim është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 27, pika 1.

**Deklarata e Cilësisë për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm** për vitin 2022 në Bashkinë Vorë, është hartuar për periudhën 01.04.2022-31.12.2022 dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 1198 prot., datë 01.03.2023.

### **Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit:**

Për vitin 2022, shkresa nr. 1198 prot., datë 01.03.2023, Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Vorë, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK.

Përgjithësisht pyetësori është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi. Në çdo seksion janë analizuar parimet në të cilat mbështetet njësia publike, duke dhënë edhe përgjigjet e arsyetuara për secilën prej tyre. Disa nga parimet janë angazhimi për integritet dhe vlerat etike; Titullari/Nëpunësi Autorizues demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje; Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë; Njësia Publike demonstroi angazhim në realizimin e

kompetencave; Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale; Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve lidhur me këto objektiva; Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave; Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtime; Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli; Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë; Njësia Publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave; Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor; Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm; Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

**Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm** për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.5.

**Harta e Proceve të Punës** për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3.

**Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin** për vitin 2022, referuar shkresës me datë 28.02.2023, është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, por nuk ka numër protokolli. Ky plan është hartuar sipas formatit standard që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli IV i tij, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

**Plani për Kontrollin e Brendshëm** për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3.

**Plani i Veprimit për arritjen e objektivave** për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, Neni 8, pika 8 a).

**Gjurmët standarde të auditimit** të vitit 2022, si gjurma e zbatimit të Buxhetit, gjurma për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë dhe mbi 1.000.000 lekë pa TVSH etj., për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në Bashkinë Vorë, nuk janë hartuar dhe miratuar. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3.

**Plani vjetor i punës i Drejtorisë së Financës** për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

#### **4. Informacioni dhe komunikimi:**

Mjetet e komunikimit për Bashkinë Vorë dhe njësitë në varësi janë forma shkresore dhe email-et. Në aspektin organizativ dhe funksional, çdo drejtori raporton te Kryetari i Bashkisë Vorë nëpërmjet mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Për mënyrën e realizimit të komunikimit të brendshëm në Bashkinë Vorë, komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet sistemit elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare, brenda Bashkisë realizohet duke përdorur postën elektronike (e-mail) dhe dërgesa në institucionet e tjera bëhet në formë shkresore zyrtare, me shërbim postar. Ajo çfarë evidentohet nga praktika është se punonjësit përdorin më tepër postën elektronike personale, ndërkohë që duhet bërë e

mundur që të mund të përdorin postën elektronike të Bashkisë, për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale. Bashkia Vorë garanton për publikun transparencën e veprimtarisë së saj, ku çdo akt i Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të internetit (ëeb-it) dhe afishohet në vendet e caktuara nga Bashkia për njoftimet publike. Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Vorë, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

#### **5. Monitorimi:**

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është edhe pyetësi i vetëvlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjatë auditimit u konstatua se funksionimi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vorë për vitin 2022, nuk ka qenë i organizuar dhe plotësisht funksional, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, kjo vihet re edhe nga mospërmbushja e objektivave në mënyrë jo të plotë për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

**Titulli i gjetjes:** Në Bashkinë Vorë, për periudhën objekt auditimi, vihet re se sistemi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka funksionuar bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

**Situata:** Në Bashkinë Vorë, për vitin 2022, nuk ka pasur një urdhër specifik ku të përcaktohej koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve, për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj, nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm. Gjithashtu është konstatuar se, nuk është përgatitur harta e proceseve të punës, gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të Bashkisë Vorë. Për më tepër është evidentuar se edhe plani vjetor i punës për drejtorinë e financës, strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut, nuk janë hartuar. Përsa i takon trajnimeve të punonjësve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë, nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve.

*Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 28.07.2023*

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 8, 10, 16, 27 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pikat 3.3 dhe 3.5.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i kuartit ligjor dhe manualit për MFK.

**Shkaku:** Neglizhencë e GMS dhe strukturave përgjegjëse për funksionimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, bazuar në kuadrin ligjor përkatës dhe manualit të MFK-së.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Bashkia Vorë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masat që:

- Temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe gjithashtu të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.
- Të përcaktohet koordinatori i riskut, për të bërë të mundur përcaktimin e veprimtarive, që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të institucionit.

- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për kontrollin e brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurtisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.
- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.
- Të hartohen gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të Bashkisë Vorë.
- Të hartohet plani vjetor i punës për drejtorinë e financës dhe harta e proceseve të punës.
- Të hartohet regjistri i riskut për të ndihmuar në përcaktimin dhe identifikimin e risqeve kryesore të institucionit dhe strategjia e menaxhimit të riskut, që ndihmon për të minimizuar këto risqe.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë dhe përgatisë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, bazuar në nevojat e kualifikimit periodik të tyre.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Vorë z. B.Sh., nëpunës zbatues i autorizuar për periudhën (01.01.2022 – 02.02.2022), znj. L.S.; nëpunës zbatues i autorizuar për periudhën (02.02.2022 – 07.03.2022), znj. A.D.; nëpunës zbatues i autorizuar për periudhën (07.03.2022 - 15.08.2022), z. D.K.; dhe Drejtori i Financës aktual, nëpunës zbatues duke filluar nga (15.08.2022 – vazhdim), z. S.B..*

## **2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.**

### **2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

Bashkia Vorë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

**Për vitin 2022,** Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vorë është miratuar dhe ka funksionuar për një pjesë të periudhës së vitit me Urdhër Nr. 07, datë 07.01.2021, nr. 96 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërçall për vitin 2021”, ku struktura e NjAB ishte e përcaktuar me 1 (një) përgjegjës dhe 2 (dy) specialistë. Më pas përbërja e kësaj strukture ka ndryshuar me Urdhër Nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësive administrative Prezë dhe Bërçall për vitin 2022”, në të cilin përcaktohej se kjo njësi do përbehej nga 4 punonjës, konkretisht 1 (një) përgjegjës dhe 3 (tre) specialistë. Pas daljes së këtij urdhëri për vitin 2022, kjo strukturë ka patur realisht vetëm 2 (dy) punonjës në pozicionin specialistë, ndërkohë që në strukturë ishte planifikuar që do kishte 3 punonjës në pozicionin specialist dhe 1 punonjës si përgjegjës i kësaj njësie. Për pjesën e mbetur të vitit 2022 struktura e NjAB ka qenë e paplotësuar, si rrjedhojë e mos pasjes së një përgjegjësi dhe një specilaisti tjetër të NjAB.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Vorë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Struktura e NjAB, për vitin 2022, në Bashkinë Vorë nuk ka funksionuar siç parashkohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe bazuar në strukturën organizative të miratuar nga titullari i institucionit për këtë vit, pasi nuk ka pasur një Përgjegjës të NjAB. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, pika 3. Si rrjedhojë, rezulton se NjAB e Bashkisë Vorë për vitin 2022 ka qenë e paplotësuar dhe ka pasur vetëm 2 (dy) specialistë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 10.

Përgjegjës aktual i Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Vorë, duke nisur nga data 31.05.2023, është Znj. A.D., bazuar në Urdhër Nr. 02, 3071 prot., datë 31.05.2023 “Për ushtrimin e përkohshëm të detyrave shtesë të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”.

Përsa i takon 2 (dy) specialistëve të NjAB gjatë vitit 2022 kanë qenë, znj. V.A. e emëruar në këtë pozicion duke nisur nga data 11.08.2020, bazuar në Vendim Nr. 187, nr. 6398 prot., datë 11.08.2020, e cila ende nuk e ka marrë certifikatën e audituesit të brendshëm, por e ka ndjekur trajnimin për marrjen e certifikimit dhe ka dhënë provimin e certifikimit; dhe znj. L.M. e emëruar në këtë pozicion duke nisur nga data 06.01.2022, bazuar në Urdhër nr. 08, datë 06.01.2022, nr. 79 prot., “Për zbatim akt emërimi”, e pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Përbërja e sektorit NjAB, për vitin objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr. 2.** Përbërja e sektorit të NjAB, Bashkia Vorë

| Nr. | 01.01-31.12.2022 | Funksioni   | Arsimimi                                            | Vjetërsi në punë | Vjetërsi në auditim | Certifikimi | Trajnime të vijueshme |
|-----|------------------|-------------|-----------------------------------------------------|------------------|---------------------|-------------|-----------------------|
| 1   | -                | Përgjegjës  | -                                                   | -                | -                   | -           | -                     |
| 2   | V.A.             | Specialiste | Diplomë e Integruar në Ek. Agrare (Master Shkencor) | 25               | 2                   | Në proces   | 32                    |
| 3   | L.M.             | Specialiste | Diplomë e Integruar në Ek. Agrare (Master Shkencor) | 25               | 1                   | Po          | 32                    |

**Burimi:** Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit

Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Vorë vihet re se janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale nga dy prej punonjësve që janë pjesë e NjAB, siç janë paraqitur edhe në tabelën e mësipërme, konkretisht nga znj. V.A. (Specialiste) dhe znj. L.M. (Specialiste).

**Karta e Auditimit** është përgatitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Vorë, me shkresën nr. 2775 prot., datë 26.05.2022. Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave. Gjithashtu **Kodi i Etikës** për Audituesit e Brendshëm në Bashkinë Vorë është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në shkresën Nr. 2774 prot., datë 26.05.2022.

Në Bashkinë Vorë nuk rezulton një shkresë përcjellëse, ku të pasqyrohet dërgesa e Kartës së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 14, pika b).

**Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2022** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për vitet 2022 – 2024, me shkresën nr. 6257/2 prot., datë 20.10.2021. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Bazuar në pasqyrën nr.3, për vitin 2022 ishin planifikuar 3 (tre) angazhime auditimi, ku 2 (dy) janë të kombinuara dhe 1 (një) është përpunueshmërie. Plani vjetor për vitin 2022 i bashkangjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.

**Programi i Sigurimit të Cilësisë të Nj.A.B Vorë për vitin 2022**, është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vorë me Vendim Nr. 73, nr. 2832 prot., datë 27.05.2022. Në Bashkinë Vorë nuk ka një shkresë përcjellëse të Programit të Sigurimit të Cilësisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

**Regjistri i Riskut për vitin 2022**, është hartuar nga NjAB e Bashkisë Vorë, bazuar në

legjislacionin përkatës dhe në funksion të objektivave institucional, por nuk përmban numër protokoll. Ky regjistër përfshin disa nga risqet e identifikuar si, hartimi i programit të auditimit pa vlerësuar fushat me risk të lartë; mosrealizimi i programit të auditimit; azhurnimi në kohë me ndryshimet e shumta ligjore; nevoja për specialistë të fushës në struktura me risk të lartë; ndryshimet në legjislacion, transferimi i kompetencave të reja; hartimi i një raporti jo të saktë ose mosidentifikimi i gabimeve; rekomandime të paqarta ose të pakuptueshme për subjektin që auditohet dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve.

### **Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara**

Sipas Planit Strategjik të periudhës 2022 – 2024, shkresa nr. 6257/2 prot., datë 20.10.2021, janë planifikuar angazhimet e auditimit si vijon:

Për vitin 2022, kanë qenë të planifikuara për tu kryer angazhimet e auditimit si, Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Prokurimit Publik; Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Ndihmës Ekonomike dhe Strehimit.

Ndërkohë vihet re se ka pasur një ndryshim në planin e auditimeve për vitin 2022, ku me kërkesë të titullarit të Bashkisë Vorë, bazuar në Urdhër Nr. 27, nr. 1532 prot., datë 28.03.2022, “Për ushtrimin e kontrollit ekonomik – financiar në shoqërinë Ujësjellës – Kanalizime Vora sh.a”, është vendosur të realizohet auditimi i Ujësjellës – Kanalizime Vora sh.a dhe si rrjedhojë e këtij fakti, për vitin 2022, janë realizuar angazhimet e auditimit si vijon:

- Ujësjellës Kanalizime Vorë,
- Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Prokurimit Publik,
- Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve për vitin 2022, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, bazuar edhe te Manuali i Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi i projekt raporteve dhe raporteve përfundimtare, rezulton se nga audituesit e brendshëm në procesin e auditimit, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe formë. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Në dosjet e auditimit të vitit 2022, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon dhe në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm. Konkretisht:

**Tabela nr. 3.** Dokumentacioni i dosjeve të subjekteve të audituara nga NjAB për vitin 2022

| Subjektet e audituara                                                                                                                                                                                                               | Përmbajtja e dosjeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ujësjellës Kanalizime Vorë</li> <li>2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Licencave dhe Prokurimit Publik</li> <li>3. Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim,</li> <li>2. deklaratat e konfliktit të interesit,</li> <li>3. programi i angazhimit të auditimit,</li> <li>4. njoftimi për fillimin e angazhimit të auditimit,</li> <li>5. vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit,</li> <li>6. procesverbal takimi fillestar, projekt-axhenda,</li> <li>7. shkresë përcjellëse e projekt raportit, projekt raporti,</li> <li>8. memo,</li> <li>9. shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar, raporti përfundimtar</li> </ol> |

**Burimi:** Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit

Në të gjitha dosjet e auditimit mungon inventari i dosjes, plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve, reagimet e auditimit, procesverbali i takimit përmbyllës dhe informacioni mbi zbatimin e rekomandimeve, ndërsa në dy prej tyre mungon gjithashtu edhe vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit dhe procesverbali i takimit fillestar, projekt-axhenda. Vlerësimi i monitorimit të cilësisë për auditimet e vitit 2022, nuk rezulton si dokument në

dosjet e auditimit. Përsa i takon dosjes së përhershme të auditimit, nuk është krijuar manualisht ose elektronikisht, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

#### **Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit**

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për vitin 2022, është raportuar në mënyrë sistematike të Kryetari i Bashkisë Vorë. Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga NjAB, në bazë të Planit Vjetor. Rezulton se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhër nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

**Për vitin 2022 i janë nënshtruar procesit të auditimit** Ujësjiellës Kanalizime Vorë, i kryer me kërkesë të titullarit të Bashkisë Vorë, bazuar në Urdhër Nr. 27, nr. 1532 prot., datë 28.03.2022 “Për ushtrimin e kontrollit ekonomik – financiar në shoqërinë Ujësjiellës – Kanalizime Vora sh.a”, Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Licensave dhe Prokurimit Publik, Drejtoria e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, për të cilat janë dhënë rekomandimet të paraqitura në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 4.** Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2022

| Plan | Fakt | Rekom | Zbat. | Pa zbat. | Në proc. | Përputhsh. | Perform. | Financiar | Kombinuar | Konsulencë |
|------|------|-------|-------|----------|----------|------------|----------|-----------|-----------|------------|
| 3    | 3    | 37    | -     | -        | 37       | 1          | -        | -         | 2         | -          |

**Burimi:** Bashkia Vorë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më lart, nga 3 (tre) angazhime auditimi të planifikuara për vitin 2022, vihet re se kanë arritur të realizohen 3 (tre) angazhime auditimi, ku njëri prej tyre ka qenë i ndryshuar me urdhërin e lartpërmendur. Gjithashtu evidentohet se rekomandime të vendosura, bazuar në auditimet që janë realizuar gjatë vitit 2022, janë 37 (tridhjetë e shtatë), të cilat janë të gjitha në proces zbatimi.

**Raporti i Veprimtarisë të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, me shkresën nr. 426/1 prot., datë 10.02.2023, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 i ndryshuar. Referuar pasqyrave bashkëlidhur këtij raporti, janë vënë re pasaktësi në paraqitjen reale të numrit të rekomandimeve të lëna, nga NjAB e Bashkisë Vorë, gjatë auditimeve që janë realizuar gjatë vitit 2022.

Raporti përmban të dhëna për Burimet Njerëzore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 (pasqyra nr.1); Realizimi i planit të angazhimeve 2022 (pasqyra nr.2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit 2022 (pasqyra nr.3); Përmbledhje e parregullsive të identifikuar sipas sistemeve për vitin 2022 (pasqyra nr.4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2022 (pasqyra nr. 5); Çështje të dërguara për investigim për vitin 2022 (pasqyra nr. 6); Pyetësi i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm.

Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2022 janë realizuar 3 (tre) angazhime auditimi, nga të cilat 2 (dy) të kombinuar, ku njëri prej tyre (Ujësjiellës – Kanalizime Vora sh.a) ka qenë me kërkesë të titullarit dhe 1 (një) përputhshmërie.

Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik.

Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë paraqitur në vlerën, 32 (tridhjetë e dy) gjithsej, të cilat janë kategorizuar si vijon, 7 (shtatë) te kategoria sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve; dhe 25 (njëzet e pesë) te kategoria Të tjera. Krahësuar me totalin e

rekomandimeve që kanë rezultuar në të vërtetë nga këto 3 (tre) angazhime auditimi, evidentohet se janë dhënë 37 (tridhjetë e shtatë) rekomandime, vlerë e cila nuk përpunet me numrin total të rekomandimeve të paraqitura në pasqyrën nr.4.

Referuar pasqyrës nr. 5, janë 32 (tridhjetë e dy) rekomandime gjithsej, 32 (tridhjetë e dy) të zbatuara dhe 0 (zero) në proces zbatimi. I njëjti fenomen vlen edhe për pasqyrën nr.5, ku nuk është paraqitur në vlerë të saktë numri total i rekomandimeve të lëna, që realisht është 37 (tridhjetë e shtatë) rekomandime, të cilat janë të gjitha në proces zbatimi.

Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2022 nuk ka.

**Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë.** Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vorë, rezulton se:

a) Znj. A.D. është Përgjegjës aktual i Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Vorë, duke nisur nga data 31.05.2023, bazuar në Urdhër Nr. 02, 3071 prot., datë 31.05.2023 “Për ushtrimin e përkohshëm të detyrave shtesë të Përgjegjësit të Auditimit të Brendshëm”, me arsim të lartë, Master Shkencor Financë-Kontabilitet.

b) Znj. V.A., me arsim të lartë, Diplomë e Integruar në Ek. Agrare (Master Shkencor), Specialiste e NjAB, duke nisur nga data 11.08.2020 bazuar në Vendim Nr. 187, nr. 6398 prot., datë 11.08.2020, e cila është në proces të marrjes së certifikatës së auditimit të brendshëm.

c) Znj. L.M., me arsim të lartë, Diplomë e Integruar në Ek. Agrare (Master Shkencor), Specialiste e NjAB, me status Auditues i Brendshëm qershor 2009, nr. regjistri 00613, duke nisur nga data 06.01.2022, bazuar në Urdhër nr. 08, datë 06.01.2022, nr. 79 prot., “Për zbatim akt emërimi”.

**Titulli i gjetjes:** Në Bashkinë Vorë, për vitin 2022, vihet re se struktura e NjAB nuk ka funksionuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, pasi ka pasur vetëm dy specialistë dhe pa një Përgjegjës të NjAB. Gjithashtu është vënë re se ka pasur mangësi referuar edhe përgatitjes së dokumentacionit shkresor përkatës.

**Situata:** Në Bashkinë Vorë, për vitin 2022, struktura e NjAB nuk ka funksionuar siç parashkohet në strukturën organizative të miratuar nga titullari i institucionit për këtë vit dhe sipas specifikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Si rrjedhojë, rezulton se NjAB e Bashkisë Vorë për vitin 2022 ka qenë e paplotësuar pasi ka pasur vetëm 2 (dy) specialistë dhe nuk ka pasur një Përgjegjës.

Përsa i përket dërgesës së Kartës së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Vorë nuk rezulton një shkresë përcjellëse, ku të pasqyrohet dërgesa e saj në MFE.

Për auditimet e realizuara nga NjAB gjatë vitit 2022, është evidentuar se në dosjet e auditimit ka pasur mungesi të dokumentacionit shkresor standard, që çdo dosje e auditimit duhet të ketë, bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Përsa i takon dosjes së përhershme të auditimit, nuk është krijuar manualisht ose elektronikisht, për vitin 2022.

Referuar pasqyrave bashkëlidhur Raportit të Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, janë vënë re pasaktësi në paraqitjen reale të numrit të rekomandimeve të lëna, nga NjAB e Bashkisë Vorë, gjatë auditimeve që janë realizuar gjatë vitit 2022. Gjithashtu Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Vorë.

Trajtuar qjerësisht në Akt Konstatimin nr. 3, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 10; Neni 14, pika b); VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njesisë së

*Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik*”, pika 3; Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i kuarit ligjor dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm.

**Shkaku:** Mungesa e Përgjegjës të NjAB për të bërë të mundur organizimin dhe funksionimin e duhur të kësaj njësie.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Bashkia Vorë duhet të marrë masa që në vijimësi, Njësia e Auditit të Brendshëm:

- Të funksionojë gjithmonë sipas strukturës së përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi, me jo më pak se tre punonjës, përfshirë edhe Përgjegjës të kësaj njësie.
- Të dërgojë Kartën e Auditimit në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në MFE.
- Të sigurojë pajisjen e dosjeve të angazhimeve të auditimit, me të gjitha dokumentat standarde të punës që pasqyrojnë procesin e auditimit, që nga fillimi dhe deri në përfundim të tij. Gjithashtu të krijojë një dosje të përhershme të auditimit, sipas përcaktimeve të Manualit të AB.
- Të plotësojë në mënyrë të saktë pasqyrat që paraqesin rekomandimet e lëna nga NjAB, të cilat bashkëlidhen me Raportin e Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, që dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.
- Të përgatisë në mënyrë periodike Raportin Vjetor të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve, për auditimet e çdo viti.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vorë, z. B.Sh., nëpunës autorizues dhe Struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vorë.*

## **2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

Struktura organizative e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar për periudhën 2021-2022 është paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga informacioni dokumentar i pasqyruar edhe në tabelë, u konstatuan lëvizje të shpeshta të personelit të kësaj drejtorie veçanërisht ai në pozicionin e drejtorit, të cilat ndikojnë në performancën e aktivitetit të njesisë, duke cënuar realizimin e procedurave brenda afateve kohore dhe sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore (problematika të cilat përshkruhen në vijim).

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) me urdhër të Titullarit të institucionit, i cili për periudhën nën auditim rezultoi me Urdhër nr. 55 datë 21.04.2022 dhe shkresën nr. 2064 prot., datë 21.04.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se CMS përbëhet nga 17 anëtarë dhe se janë ngritur dhe miratuar 17 EMP për Bashkinë Vorë.

Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2022 sipas funksioneve/nën funksioneve që NNJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuar me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, është paraqitur në Aneksin B2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se ka funksione/nënfunksiione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “Në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, N/f- “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”,

“Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara”, “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”, F- “Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor”, “Shtimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të pyllëzuara” etj. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit dhe territorit që mbulon bashkia Vorë. Funksionet/nënfunksione me programe buxhetimi dhe vlerat përkatëse janë paraqitur në Aneksin B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit. Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, si dhe VKB nr. 98 datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Vorës për vitin 2022”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*). Programet afatmesme janë paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Duke bërë analizën e pagave rezultoi se pesha specifike e këtyre llogarive (600-601) të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve, është 362,109 (312,040 + 50,069) mijë lekë ose 16.2% në vitin 2022.

#### ➤ **Mbi konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit**

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vorë për PBA 2022-2024 dhe Projekt buxhetin e vitit 2022, nuk ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2022-2024 dhe Projekt buxheti vjetor 2022 nga ana e bashkisë Vorë është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun; Kjo pasi grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë informacion i dokumentuar (shkresor apo elektronik), mbi zhvillimin e konsultimeve me komunitetin: njoftim i publikuar në web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave të njoftohej komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të 3 (tre) njësive administrative: Vorë, Prezë, Bërxull; drejtoritë e shkollave, drejtoritë/sectorët e bashkisë, etj., për vlerën totale 2,221,030.3 mijë lekë.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2022 nuk ka projekte në proces si dhe kanë filluar 2 (dy) projekte, të dhënat e të cilave janë paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Nga auditimi rezultoi se janë 2 projekte të filluara në vitin 2022 të cilat janë në proces sipas edhe të dhënave të pasqyruara në tabelë;

- Për projektet e mëparshme të cilat kanë përfunduar, për arsye mos likuidimi, janë në statusin e “detyrimeve të prapambetura”<sup>3</sup>.

PBA-të dhe Buxheti vjetor për vitin 2022 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak sipas paraqitjes në Aneksin B6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

a. Rezultoi se nga Këshilli Bashkiak Vorë nuk është miratuar “*Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i Buxhetit vjetor*” për Bashkinë Vorë dhe njësisë të varësisë/administrative për vitin 2022, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*” neni 33.

b. PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2022, është miratuar me VKB nr. 99, datë 24.12.2021; Buxheti fillestar për vitin 2022 ka pësuar 9 ndryshime, i cili është miratuar sipas VKB-ve për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh në buxhet, të pasqyruara në tabelën e mësipërme dhe konkretisht: VKB nr. 24 datë 09.05.2022 “*Mbi miratimin e rishikimit të buxhetit 2022-2024*”; VKB nr. 36 datë 29.06.2022 “*Mbi miratimin e ndryshimeve në buxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Vorë*”; VKB nr. 41 datë 14.07.2022 “*Mbi miratimin e Planit të Likuidimit të detyrimeve për daljen nga gjendja e vështirë financiare për vitin 2022*”; VKB nr. 49 datë 02.09.2022 “*Mbi miratimin e ndryshimit të buxhetit të 2022-2024 të Bashkisë Vorë*”; VKB nr. 50 datë 02.09.2022 “*Mbi miratimin e ndryshimit të buxhetit të 2022-2024 të Bashkisë Vorë*”; VKB nr. 51 datë 02.09.2022 “*Mbi miratimin e rishikimit të buxhetit 2022-2024*”; VKB nr. 57 datë 02.09.2022 “*Mbi ndryshimin në buxhetin e vitit 2022 bazuar në VKM nr. 604 dt. 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi dhe VKM nr. 625 dt. 625 datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 165 datë 02.03.2016*”; VKB nr. 61 datë 03.10.2022 “*Mbi një ndryshim në buxhetin e vitit 2022*”; VKB nr. 81 datë 27.12.2022 “*Mbi miratimin e fondeve akorduar Bashkisë Vorë për vitin 2022*”, sipas VKM-ve përkatëse nr. 775, nr. 777, nr. 780, nr. 784 datë 12.12.2022”. të dhënat sipas VKB-ve përkatëse janë paraqitur në Anekset B7/1-B7/9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitulli, artikulli e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 26, 27, 28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

d. VKB-të për PBA/Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë brenda afateve ligjore.

Planifikimet sipas PBA-së me ndryshimet janë paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Të dhënat në tabelë janë për aparatet e bashkisë Vorë së bashku me njësitë administrative.

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se Bashkia Vorë ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 28.5% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022. Të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës janë 62,538,8 mijë lekë, sipas Aneksit B9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi dhe të dhënat e pasqyruara në tabelë rezultoi se shpenzimet me burim të “ardhurat” nga taksat e tarifave vendore janë planifikuar: për vitin 2022 në vlerën 723,040 mijë lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 318,267 mijë lekë ose 44%; Nga fondet e “pakushtëzuara” janë planifikuar 311,980 mijë lekë dhe shpenzuar 70.9% e atyre; si dhe nga fondet e “kushtëzuara” janë planifikuar 310,714 mijë lekë dhe shpenzuar rreth 99.9%.

- Të ardhurat për shpenzime të planifikuara bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2021 janë 730,790.3 mijë lekë.

<sup>3</sup> Informacioni i detajuar pasqyrohet te rubrika “detyrime të prapambetura”

Ndërsa buxheti fillestar për vitin 2022 është planifikuar në vlerën e 974,182 mijë lekë dhe me fondet e trashëguara nga viti 2021 prej 97,088.3 mijë lekë (të ardhurat e veta & transfertave të pakushtëzuara) arrin në vlerën e 1,071,270.3 mijë lekë, me fonde për investime nga ministrinë e linjës/FZHR prej 1,149,976 mijë lekë arrin në vlerën e (plani progresiv) 2,221,030.3 mijë lekë ose 1,149,760 mijë lekë më shumë se plani fillestar dhe realizimi i tij në vlerën e 1,611,177 mijë lekë.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Vorë për vitin 2022 (Aneksi B10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), është bërë në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Vorë.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Planit buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor. U konstatua se mungesa e hartimit të planit vjetor buxhetor 2022 që është dhe viti i parë i PBA-së, ka sjellë mungesën e pasqyrimin të detajuar të tij në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli për çdo muaj, në moszbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin B11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

U konstatua se ka një mopërputhje të vlerës së planifikimit me aktraordinin e thesarit. Kështu sipas Thesarit plani i buxhetit është 2,207,302,535 lekë, ndërsa sipas Financës 2,211,987,000 lekë, me një diferencë prej 4,684,465 lekë. Nga komunikimi u kërkuar një informacion për këtë diferencë. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar na u dha kjo përgjigje: “Në lidhje me rakordinin e planeve buxhetore me degën e thesarit Tiranë për Planin e vitit 2022: plani sipas Thesarit 2,207,302,535 lekë; plani sipas S. Financës 2,211,987,000 lekë; rezulton diferenca 4,684,465 lekë. Gjatë kontrollit të formulave të mbledhjes është pa përfshirë në shumatore vlera 3,880,850 lekë”. Mbetet e papërfshirë dhe njëherësh e pajustificuar vlera 803,615 lekë.

## **2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njëjësive vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime


lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Të ardhurat e veta + transferta e pakushtëzuar për vitin 2022, janë paraqitur në Aneksin B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga analiza e vlerave në pasqyrat e mësipërme, vërehet se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Vorë nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe si: 102 “Të moshuarit”, 105 “Papunësia” dhe 106 “Strehimi social”, 041/6 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”, 042 dhe 042/20 “Shërbimi, inspektimi i tregjeve dhe mbrojtja e konsumatorit”, 036 “Marrëdhëniet në komunitet”, 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor”, 062/1 “Programe zhvillimi”, 072/2 “Shërbimi shëndetësor” etj, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Vorë nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale. Kjo ka ardhur si rezultat i mosmarrjes së kërkesave/nevojave buxhetore të secilës njësi shpenzuese të bashkisë nga njëra anë, si edhe mungesa e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu se analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë (jo periodikisht) mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë. U konstatua se në vitin 2022 raportimi periodik 4 mujor dhe 8 mujor i realizimit të buxhetit, nuk është bërë në MFE, por rezultoi se është bërë vetëm ai vjetor.<sup>4</sup>



Grafiku i planifikimit dhe realizimit të buxhetit Bashkia Vorë

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022 rezultoi se PBA 2022-2024 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës

<sup>4</sup> Informacioni i detajuar pasqyrohet më poshtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit

nën auditim, buxheti i Bashkisë Vorë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2022, në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore””, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44. Nga pasqyra e mësipërme rezulton se janë në total 27 programe (nënfunksiione), nga të cilat për vitin 2022 janë planifikuar për tu trajtuar me fonde buxhetore vetëm 20 programe;

**Titulli i Gjetjes:** Planifikimi PBA-ve dhe Planeve vjetore me program buxhetore sipas prioriteteve vendore dhe institucionale

**Situata:** 1 Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e strukturës organizative të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, u konstatua lëvizje të shpeshta të personelit të kësaj drejtorie veçanërisht ai në pozicionin e drejtorit, të cilat ndikojnë në performancën e aktivitetit të njësisë, duke cenuar realizimin e procedurave brenda afateve kohore dhe sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore.

2. Nga auditimi rezultoi se në PBA-në 2022-2024 dhe Planin vjetor të buxhetit për vitin 2022, nuk janë shprehur qartë objektivat strategjike të bashkisë, të cilat mbështetur në PPV<sup>5</sup> dhe PZHS, bëjnë planifikime buxhetore për ato programe të cilësuar si më prioritaret me projektet përkatëse. U konstatua se në VKB nr. 99 datë 24.12.2021, PBA 2022-2024/Plani i buxhetit vjetor 2022 nuk janë paraqitur për miratim edhe projektet me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29.

3. Në Bashkinë Vorë, Këshilli Bashkiak nuk ka miratuar “Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Planit vjetor të Buxhetit 2022 për bashkinë Vorë dhe njësitë e Varësisë/Administrative” në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

4. Nga Bashkia Vorë, PBA 2022-2024 dhe Planin vjetor i buxhetit 2022 janë hartuar/miratuar sëbashku, duke mos e hartuar dhe miratuar veçmas Planin Vjetor, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

5. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime. Por nga auditimi rezultoi se VKB-të nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të Bashkisë Vorë, në moszbatim të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” neni 23, 24; “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19; si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”.

6. Planin buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor. Por u konstatua se mungesa e hartimit veçmas të planit vjetor buxhetor 2022 që është dhe viti i parë i PBA-së, ka sjellë mungesën e pasqyrimit të detajuar të tij në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli për çdo muaj, në moszbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

---

<sup>5</sup> Vendimi nr. 3 i KKT datë 17.05.2019 “Miratimi i PPV Bashkia Vorë”

7. Nga auditimi mbi aktrakordimin vjetor me Thesarin, u konstatua se ka një mopërputhje të vlerës së planifikimit të shpenzimeve. Kështu sipas Thesarit plani i buxhetit është 2,207,302,535 lekë, ndërsa sipas Financës 2,211,987,000 lekë, me një diferencë prej 4.684.465 lekë. Nga grupi i KLSH-së u kërkuar një informacion për këtë diferencë. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar na u dha kjo përgjigje: “*Në lidhje me rakordimin e planeve buxhetore me degën e thesarit Tiranë për Planin e vitit 2022: plani sipas Thesarit është 2.207.302.535 leke; plani sipas S. Financës është 2.211.987.000 lekë; rezulton diferenca 4.684.465 lekë. Gjatë kontrollit të formulave të mbledhjes është pa përfshirë në shumatore vlera 3.880.850 lekë*”. Mbetet e papërfshirë dhe njëherësh e pajustificuar vlera 803,615 lekë.

8. Bashkia Vorë nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi programit 042 “*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia*” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “*Për pyjet dhe kullotat*” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “*Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve*”, 056 “*Ndërgjegjësimi mjedisor*” si programe që lidhen ngushtë me 051- “*Menaxhimi i mbetjeve*”; 036 “*Marrëdhëniet në komunitet*”, 041 “*Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi*”; mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në Ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” nenet 23-30.

9. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2022, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës, duke mos marrë drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë, duke mos zbatuar korrektësisht kërkesat e nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 6, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma “*dh*” të nenit 32, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*” Kreu IV, nenet 11-20; ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*” neni 23, 24; “*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*” neni 13 dhe neni 19; si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “*Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë*”; Ligji nr. 9385/2005 “*Për pyjet dhe kullotat*” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në Ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “*Për buxhetin e vitit 2020*”, Aktin Normativ Nr. 15, datë 15.4.2020, Ligjit nr. 10296/2010 “*Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe Manualit MFK, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Vorë.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e vëmendjes në planifikimin e fondeve të buxhetit vendor për programet prioritare në koherencë me Planin e Zhvillimit Vendor dhe Strategjitë Kombëtare, ul efektivitetin në aktivitetin e funksioneve të bashkisë për komunitetin, në moszbatim të përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.

**Shkak:** Mungesa e një analize të detajuar nga Kryetari i bashkisë dhe e Grupit të Menaxhimit Strategjik e mos/realizimit të buxhetit në mbyllje të vitit ushtrimor dhe nxjerrja e detyrave për planifikimin e buxhetit vjetor dhe atë afatmesëm në vijim, të atyre programeve që i shërbejnë realizimit të objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi 1:** Në Bashkinë Vorë, kryetari i bashkisë, të përcjellë për njohje e miratim në Këshillin bashkiak “*Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Planit vjetor të Buxhetit*”

*për bashkinë Vorë dhe njësisë administrative*”; të krijojë një strukturë efektive të Drejtorisë së menaxhimit financiar për të rritur performancën e njësisë, që të zbatohet brenda afateve kohore e sipas standardeve ligjore çdo procedurë e aktivitetit të saj;

**Rekomandimi 2:** Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e menaxhimit financiar të marrin masa për të njoftuar brenda afateve nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore, zhvillimin e takimeve me komunitetin dhe grupet e interesit, për prezantimin e PBA-ve dhe Projekt planeve vjetore buxhetore; të paraqesin për miratim në Këshillin bashkiak sëbashku me PBA-të dhe Planin Vjetor edhe projektet e planifikuara për buxhetim me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore në çdo program; të hartojnë dhe miratojnë veçmas Planin vjetor të buxhetit; të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare kryesisht atyre të mjedisit dhe pyjeve, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### ***2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tiranë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuar nga transfertat e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2022 referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në Aneksin B13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 37% deri në 100% për vitin 2022; por gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit ndërsa niveli i realizimit në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rënie nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Vorë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2022 e zënë shpenzimet në llog. 606 “*Transferta buxhetore familjare/individë*”, e ndjekur nga llog. 230 e 231 “*Investimet*”.

#### **➤ Sipas burimeve të financimit:**

Planifikimi i treguesve të buxhetit sipas burimeve të financimit: transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike, të ardhura të veta, është paraqitur në Aneksin B14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Realizimi i treguesve të buxhetit sipas burimeve të financimit: transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike, të ardhura të veta, është paraqitur në Aneksin B15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Të dhënat në pasqyrat e realizimit të shpenzimeve nga burimi i financimit, rezultojnë se vlera totale e tij në planifikim është 1,163,702.4 mijë lekë dhe realizimi në 646,898.7 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë buxheti nga “të ardhurat e veta” në vlerën 723,041 mijë lekë në planifikim ose 62.1% ndaj vlerës totale dhe 318,266.7 mijë lekë në realizim ose 49.2% të totalit; i ndjekur nga “*Transferta e pakushtëzuar*” në vlerën e 320,614 mijë lekë në planifikim ose 27.6% dhe 221,129 mijë lekë në realizim ose 34.2% të totalit; është në vlerën 154,059 mijë lekë që përbën

15.27% të totalit; nga “*Transferta specifike/sectoriale*” në vlerën 120,047 mijë lekë ose 10.3% dhe 107,503 mijë lekë në realizim ose 16.6% të totalit.

- Ndërsa nga zërat buxhetor me burim “*Të ardhurat e veta*” në realizim janë: “*Investimet*” me 132,640.5 mijë lekë ose 48% të totalit të investimeve; “*Pagat*” në vlerën 87,387.7 mijë lekë ose 42.7% të totalit të pagave; shpenzimet operative me 56,814.5 mijë lekë ose 54% të totalit të shpenzimeve.

#### ➤ **Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore**

Nga auditimi rezulton se planifikimi i buxhetit është: për vitin 2021 është në 2,415,273 mijë lekë dhe për vitin 2022 është 2,180,804 mijë lekë ose (-)234,469 mijë lekë më pak; realizimi i Buxhetit është: për vitin 2021 në vlerën 1,726,788.6 mijë lekë; për vitin 2022 buxheti faktik është në vlerën e 1,611,778 mijë lekë ose (-)115,011 mijë lekë dhe (-)569,362.6 mijë lekë më pak se ai i planifikuar (progresivi), në masën 73% të tij, duke rezultuar edhe vlera më e lartë e mosrealizimit për 2 vitet e fundit. Pra **rezulton** se vlera e buxhetit si në planifikim ashtu edhe në realizim, vjen në rënie.

*në mijë lekë*

| Nr. | Emërtimi                  | Viti 2021 | Viti 2022 | Trendi |
|-----|---------------------------|-----------|-----------|--------|
| 1   | Shpenzimet e planifikuara | 2,415,273 | 2,180,804 | ↘      |
| 2   | Shpenzimet faktike        | 1,726,789 | 1,611,778 | ↘      |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Sa më sipër **u konstatua** se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie dhe që paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

*në mijë lekë*

| Emërtimi   | 2021      | 2022      |           | Vlera% &Trendi |                 |
|------------|-----------|-----------|-----------|----------------|-----------------|
|            | Fakt      | Plan      | Fakt      | Diferenca      | i mosrealizimit |
| Shpenzime  | 1,726,789 | 2,180,804 | 1,611,778 | 569,363        | 73% ↘           |
| Të Ardhura | 277,557   | 633,702   | 292,104   | 341,598        | 46.6% ↘         |

**Burimi:** Bashkia Vorë

- Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Vorë nuk ka financime të huaja për vitin 2022;
- Bashkia Vorë nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2022 ( as në periudhat paraardhëse);
- Bashkia Vorë nuk ka patur subvencione nga shteti.

Një pasqyrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, rezulton se vlera e të ardhurave ka trend në rritje nga viti në vit, ndërsa vlera e shpenzimeve ka trend në rënie.

*në mijë lekë*

| Nr | Emërtimi            | Viti 2021 | Viti 2022 | Trendi |
|----|---------------------|-----------|-----------|--------|
| 1  | Të ardhurat faktike | 277,557   | 292,104   | ↗      |
| 2  | Shpenzimet faktike  | 1,726,789 | 1,611,778 | ↘      |

**Burimi:** Bashkia Vorë

#### ➤ **Miratimi i buxhetit faktik:**

Bashkia Vorë me VKB nr. 30 datë 28.04.2023 ka miratuar buxhetin faktik të vitit 2022, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

#### ➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, u konstatua se nuk janë bërë raportimet 4 dhe 8 mujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por është bërë vetëm raportimi vjetor (12 mujor) sipas formateve të përcaktuara nga MFE, me shkresë nr. 2354 prot., datë 26.04.2023. Ky raport është hartuar e miratuar pas mendimeve mbi raportin e monitorimit të buxhetit 2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 5775 prot., datë 30.03.2023. Këto raporte janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në afat; Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raporti i Monitorimit të buxhetit të vitit 2022 është miratuar me VKB nr. 32 datë 28.04.2023 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me nr. 694/1prot., datë 12.05.2023.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë, Fondi i kontigjencës dhe Fondi i Emergjencës, vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme, në mijë lekë.

| Emërtimi         | Plan 2022       | Fakt 2022 |
|------------------|-----------------|-----------|
| Fond Rezervë     | 15,452.0        | 0         |
| Fond Emergjence  | 6,645.9         | 0         |
| Fond Kontigjence | 6,645.9         | 0         |
| Mbrojtja Civile  | 29,696.0        | 0         |
| <b>Totali</b>    | <b>58,439.8</b> | <b>0</b>  |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Përdorimi i këtyre fondeve realizohet me miratimin e Këshillit Bashkiak. Me VKB nr. 99 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” është miratuar Fondi Rezervë në vlerën 15,452 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës në 6,645.9 mijë lekë, që në total janë në vlerën 22,097.9 mijë lekë. Në referim të ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74 % të vlerës që duhej të planifikohej dhe se për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur; Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 6,645.9 mijë lekë dhe përfaqëson fondet që bashkia planifikon në rastet e fatkeqësive natyrore, të cilat nuk janë shpenzuar;

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga sa më lart, nga auditimi u konstatua se Bashkia Vorë për vitin 2022 fondin për emergjencat civile e ka planifikuar në vlerën e 29,696 mijë lekë nga i cili nuk ka patur shpenzime dhe është trashëguar për vitin pasardhës. Ndërsa nga të ardhurat e veta “Fondi i emergjencës” është planifikuar në vlerën 6,645.9 mijë lekë. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje jo racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, sesa masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1, që nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 38,967.3 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 9,271.3 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 76.2% të vlerës që duhej planifikuar. Së bashku me fondin e emergjencës arrin vlerën 36,341.9 mijë lekë ose (-)2,625.4 mijë lekë më pak dhe që përbën 93% të fondit që duhet të planifikonte Bashkia Vorë.

#### ➤ Realizimi i Investimeve:

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2021 dhe 2022 për bashkinë Vorë, me burim “Financimi nga të ardhurat e veta” [AV] dhe “Transferta e pakushtëzuara”, pasqyrohet në tabelën më poshtë, në mijë lekë:

| 230-231 | 2021    | 2022      |           |                             |                       |
|---------|---------|-----------|-----------|-----------------------------|-----------------------|
|         | Fakt    | Plan      | Fakt      | Diferenca ndaj planifikimit | Diferenca ndaj faktit |
|         | 145,732 | 279,395.3 | 132,640.5 | 146,754.1                   | 13,091.5              |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Nga auditimi **rezultoi** se për vitin 2022 investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit në vlerën (-)146,754.8 mijë lekë; si dhe në krahasim me vitin 2021 ka një rënie prej (-)13,091.5 mijë lekë.

Duke iu referuar të dhënave në tabelën e mëposhtme të të ardhurave të veta, rezultoi si më poshtë vijon:

| 230-231 | Burimet e Financimit            | Viti 2022        |                  | %         |
|---------|---------------------------------|------------------|------------------|-----------|
|         |                                 | Plan             | Fakt             |           |
|         | Të ardhurat e veta              | 279,395.3        | 132,460.5        | 47.4      |
|         | Transferta specifike/sectoriale | 45,609           | 38,177           | 81.5      |
|         | Transferta e pakushtëzuar       | 167,508          | 105,290          | 62.8      |
|         | <b>Totali</b>                   | <b>492,512.3</b> | <b>275,927.5</b> | <b>56</b> |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Ky **konstatim** sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

#### ➤ Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Vorë gjatë vitit 2022 nuk ka patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

#### ➤ Fondet e shpenzuara nga fondet e Rindërtimit

| Formulari Tip | Vlera e likuiduar Bashkia Vorë |                    |                    |
|---------------|--------------------------------|--------------------|--------------------|
|               | 2020                           | 2021               | 2022               |
| DS1           | 31,700,000                     | 9,720,000          | 0                  |
| DS2           | 74,900,000                     | 22,500,000         | 0                  |
| DS3           | 77,300,000                     | 20,640,000         | 0                  |
| DS4           | 0                              | 0                  | 0                  |
| DS5           | 0                              | 655,960,492        | 640,961,994        |
| <b>Totali</b> | <b>183,900,000</b>             | <b>708,820,492</b> | <b>640,961,994</b> |

**Burimi:** Komisioni i Rindërtimit/Bashkia Vorë

Përsa i përket përfuturimit të fondeve të rindërtimit, rezultoi se miratimi i tyre është bërë mbështetur në akt ekspertizat e Institutit të Ndërtimit dhe evidencave të akt konstatimeve dhe dosjeve të aplikantëve nga komisioni i menaxhimit të situatës së rindërtimit, të cilat janë

miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Kjo procedurë rezultoi konform akteve ligjore/nënligjore përkatëse.

**Titulli i Gjetjes:** Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore;

**Situata:** 10. Nga analiza e të dhënave të buxhetit u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre; kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie;

11. Nga auditimi u konstatua se nuk janë bërë raportimet 4 dhe 8 mujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por është bërë vetëm raportimi vjetor (12 mujor) sipas formateve të përcaktuara nga MFE, me shkresë nr. 2354 prot., datë 26.04.2023. Kjo në kundërshtim me nenin 48 “*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*” të Ligjit 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, Ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 dt. 30.07.2018 “*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”;

12. Me VKB nr. 99 datë 24.12.2021 “*Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm*” është miratuar Fondi Rezervë në vlerën 15,452 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës në 6,645.9 mijë lekë, që në total janë në vlerën 22,097.9 mijë lekë. Referuar ligjit nr. 9936/2008 “*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74 % të vlerës që duhej të planifikohej dhe se për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur;

13. Referuar kriterëve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “*Për mbrojtjen civile*”. Nga sa më lart, u konstatua se për vitin 2022 fondi për emergjencat civile është planifikuar në vlerën e 29,696 mijë lekë nga i cili nuk ka patur shpenzime dhe është trashëguar për vitin pasardhës; Ndërsa nga të ardhurat e veta “*Fondi i emergjencës*” është planifikuar në vlerën 6,645.9 mijë lekë. Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “*Për mbrojtjen civile*” neni 65/1, që nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 38,967.3 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 9,271.3 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 76.2% të vlerës që duhej planifikuar. Së bashku me fondin e emergjencës arrin vlerën 36,341.9 mijë lekë ose (-)2,625.4 mijë lekë më pak dhe që përbën 93% të fondit që duhet të planifikonte Bashkia Vorë për këtë zë buxhetor. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje jo racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, sesa masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

14. Nga auditimi rezultoi niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total vjen në rënie nga viti 2021 në vitin 2022; nga tabela e planifikimit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta në vitin 2022, investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit në vlerën (-)146,754.8 mijë lekë; si dhe në krahasim me vitin 2021 ky mosrealizim ka një rritje prej (-)13,091.5 mijë lekë. Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të

ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar, por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/ blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 6, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, Ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ Nr.15, datë 15.4.2020, Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1; Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak;

**Ndikimi/Efekti:** Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

**Shkak:** Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme;

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Në Bashkinë Vorë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

**Afati i zbatimit:** Menjëherë dhe në vazhdimësi

**2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

**2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura.

Me VKB nr. 41 datë 14.07.2022 “Për miratimin e Planit të likuidimit të detyrimeve të prapambetura për daljen nga gjendja e vështirë financiare për vitin 2022”, Bashkia Vorë ka

orientuar planifikimin e fondeve edhe për vitet në vijim (të PBA 2022-2024), me qëllim mos lënien jashtë buxhetimit të programit “*Likuidimi i detyrimeve të prapambetura*”<sup>6</sup>.

Planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura është paraqitur në Aneksin B16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin B17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojnë edhe vlerat e sakta të detyrimeve; gjithashtu kolona e gjendjes në fund të vitit 2021 është në vlerën e 515,591,778 lekë (investime, mallra dhe shërbime, vendime gjyqësore).

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike.

Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*”, pika 106<sup>7</sup>

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”.

- Deri në 31.12.2021 është në vlerën e 515,591,778 mijë lekë lekë, ku 420,434,701 lekë janë për “*Investimet e bashkisë*”, 87,647,687 lekë “*Për mallra dhe shërbime*” dhe 7,509,839 lekë për vendimet gjyqësore;

- Për vitin 2022 nga vlera e planifikuar e miratuar me VKB për likuidim prej 226,644,894 lekë, është paguar 224,081.767 lekë ose 98.9% e saj, duke u mbartur për tu paguar në vitin 2023. Vlera e detyrimit sipas planifikimit për vitin 2023 shkon në vlerën 143,717,416.33 lekë.

Një pasqyrim të detajuar të detyrimeve të prapambetura për periudhën deri më 31.12.2022, është paraqitur në Aneksin B18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në mënyrë analitike po pasqyrojmë detyrimet e prapambetura, vitin e krijimit, likuidimet pjesore apo të plota, vlera e detyrimit e mbartur për vitin 2023.

#### ➤ **Detyrimet me burim financimi fondet e bashkisë**

Vendimet Gjyqësore të papaguara janë paraqitur në Aneksin B19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Bashkia Vorë për zbatimin e vendimeve gjyqësore ka një vlerë detyrimi të mbartur (progresive) për vitin 2022 prej 8,298,940 lekë, nga të cilat vlera 5,948,139 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt “*Dëmshpërblim page*” për largime nga puna të punonjësve në 3 raste dhe 2,350,801 lekë për “*Dëmshpërblime të tjera*” i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore për 3 raste; ndërsa vlera prej 2,268,510 lekë e paguar për “shpronësim publik” dhe “dëmshpërblim demi” vlerësohet si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmit etj.

Pra vlerat e paguara vitet e mëparshme për “dëmshpërblim page”, “shpronësime”, “dëmshpërblime” etj dhe vlera 2,268,510 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 nga Bashkia Vorë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Çështjet gjyqësore “në proces” të nisura në periudhat e mëparshme janë paraqitur në Aneksin B20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se: nga 24 çështje në total, 6 çështje janë me objekt “shpërblim demi” ose “përmbushje detyrimi”, ndërsa 18 çështje janë për vendimet “largim nga puna” dhe kanë si objekt të padisë “shpërblim page” për ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune me “Kod Pune” dhe “shpërblim page & kthim në

<sup>6</sup> Sic është përmendur edhe më lart, në PBA 2022-2024, nuk është planifikuar fond në buxhet për programin detyrime të prapambetura.

<sup>7</sup> Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA.

punë” për ata punonjës që kanë qenë me statusin e nëpunësit civil. Vlera e pretenduar me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës, në rast se do të jetë në favor të paditësit, do të paguhet nga buxheti i Bashkisë Vorë, e cila do të sjellë rritje të vlerës së detyrimit të prapambetur të akumuluar. Në mënyrë të përmblledhur proceset gjyqësore me status “në proces” pasqyrohen në tabelën mëposhtë:

| Emërtimi i objektit të padisë | Numri i çështjeve | Viti i krijimit | Statusi        |
|-------------------------------|-------------------|-----------------|----------------|
| Shpërblim dëmi                | 4                 | 2018/2020       | Në proces/Apel |
| Përmbushje detyrimi           | 2                 | 2018/2020       | -/-            |
| Shpërblim page                | 18                | 2018/2020/2021  | -/-            |

**Konstatim:** Likuiditeti i detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në raport me vlerën e detyrimit është i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, pasi shoqërohet me vendime të reja për procese gjyqësore të nisura më parë.

Detyrime për Investimet (Të ardhurat e bashkisë) janë paraqitur në Aneksin B21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se janë 63 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Vorë me 73 fatura në total të palikujduara, vlera e të cilave është trashëguar për tu likujduar në vitin 2023 sipas planit të likujdimeve të miratuar me VKB nr. 21/2022; **u konstatua** se për likujdimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, bashkia Vorë nuk ka respektuar radhën për likujdimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13; Detyrime për Mallra dhe Shërbime (Të ardhurat e bashkisë) janë paraqitur në Aneksin B22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vorë është debitore “për mallra e shërbime” ndaj 14 subjekteve me 39 fatura në vlerë totale 81,789,394.80 lekë; **u konstatua** se likujdimi i faturave të prapambetura për mallra e shërbime të kryera ndër vite, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 50 datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

➤ **Programimi i fondeve për faturat e palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore:**

Nga auditimi i PBA 2022-2024/Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar në kohë fondi për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”. Nga auditimi i likuiditeteve rezulton se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2022 për pamundësi likuiditeti të “Investime” dhe “mallra e shërbime”, kjo për arsye se nga bashkia Vorë në vitet paraardhëse nuk janë bërë planifikime të përllogaritura në mënyrë që të bëhet e mundur likuidimi i çdo fature shërbimi apo mallrash brenda vitit ushtrimor.

Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2022 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare është paraqitur në Aneksin B23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga informacioni i paraqitur grupit të auditimit dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Vorë është në vështirësi financiare, e cila është e trashëguar nga vitet paraardhëse.

**Titulli i gjetjes:** Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime:

**Situata: 15.a** Bashkia Vorë për zbatimin e vendimeve gjyqësore ka një vlerë detyrimi të mbartur (progresive) për vitin 2022 prej 8,298,940 lekë, nga të cilat vlera 5,948,139 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt “Dëmshpërblim page” për largime nga puna të punonjësve në 3 raste dhe 2,350,801 lekë për “Dëmshpërblime të tjera” i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore për 3 raste; ndërsa vlera prej 2,268,510 lekë e paguar për “shpronësim

publik” dhe “dëmshpërblim demi” vlerësohet si *konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmit* etj. Pra vlerat e paguara vitet e mëparshme për “Dëmshpërblim page”, “Shpronësime”, “Dëmshpërblime” etj dhe vlera 2,268,510 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 nga Bashkia Vorë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, ***konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.***

**15.b** Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e çështjeve gjyqësore të cilat janë në “Proces”, rezulton se: nga **24** çështje në total, **6** çështje janë me objekt “Shpërblim demi” ose “Përmbushje detyrimi”, ndërsa **18** çështje janë për vendimet “largim nga puna” dhe kanë si objekt të padisë “Shpërblim page” për ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune me “Kod Pune” dhe “Shpërblim page & kthim në punë” për ata punonjës që kanë qenë me statusin e nëpunësit civil. Vlera e pretenduar e paditësve me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës, është e konsiderueshme dhe riskon rritjen e vlerës së detyrimit të prapambetur të akumuluar.

**16.** Nga auditimi i PBA 2022-2024/Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “Planifikim për detyrimet e prapambetura”; kjo ka sjellë që likuiditeti i detyrimeve të prapambetura nga ana e bashkisë Vorë në raport me vlerën e detyrimit, të jetë i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, kjo pasi shoqërohet edhe me lindjen e detyrimeve të reja për vendime të reja për procese gjyqësore të nisura më parë dhe rrisin pamundësinë për pagesa nga mungesa e fondeve.

**17.a.** Nga auditimi rezultoi se janë **63** subjekte kreditore ndaj Bashkisë Vorë si “Detyrime për investime” me **73** fatura në total të palikujduara, vlera 325,018,779.94 lekë është trashëguar për tu likujduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve të miratuar me VKB nr. 21/2022; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, Bashkia Vorë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

**17.b** Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vorë është debitore “Për mallra e shërbime” ndaj 14 subjekteve me 39 fatura në vlerë totale 81,789,394.80 lekë; u **konstatua** se likuidimi i faturave të prapambetura për mallra e shërbime të kryera ndër vite, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 50 datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 6, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, Ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ nr. 15, datë 15.4.2020; VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”; Udhëzimit nr. 5 datë 27/02/2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak”.

**Ndikimi/Efekti:** Mosplanifikimi në PBA dhe Planet vjetore të buxhetit fonde për programin 04960 “Planifikim për detyrimet e prapambetura” si dhe mosrespektimi i radhës së kreditorëve për likuidim sipas radhës brenda llojit, të periudhës së krijimit të detyrimit, sjell lindjen e detyrimeve të reja dhe shtimin e vlerës të atyre të krijuara në periudha të mëparshme, duke e çuar në vështirësi financiare bashkinë dhe si pasojë uljen e performancës së shërbimeve të saj ndaj komunitetit;

**Shkakuj:** Moszbatimi i akteve ligjore/nënligjore në fuqi lidhur me hartimin e PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit mbi nevojat e komunitetit dhe të realizimit faktik të buxheteve paraardhëse, etj;

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi 1:** Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

**Rekomandimi 2:** Kryetari i Bashkisë, Grupi I Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Inovacionit të marrin masa dhe të analizojnë rastet e punonjësve të larguar nga puna, të nxjerrin personat përgjegjës me qëllim mospërsëritjen e tyre në në ardhmen, duke parandaluar kështu efektet negative në buxhetin e bashkisë.

**2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 7, datë 07.01.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2021” dhe VKB nr. 67 DTTë 18.05.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Ardhurave dhe Tarifave [DTT], e cila sipas strukturës së vitit 2022 është e përbërë nga 3 sektorë dhe në total ka 14 punonjës; Struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave përbëhet: Drejtori (1), Sektori i Planifikimit dhe Vlerësimit të Taksave me 1 përgjegjës dhe 2 specialistë; Sektori i Biznesit me 1 përgjegjës, 3 specialistë dhe 2 punonjës për mbledhjen e taksave (1 me kontratë); Sektori Familjar 1 përgjegjës, 3 specialistë ku njëri prej tyre realizon edhe mbledhjen e taksave për bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre përgjatë Autostradës.

Struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave - [DTT] për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në fillim të çdo viti grupi i specialistëve, bëjnë verifikime në terren për pajisjen e subjekteve me tabela, për ndryshime të Vorëve ku ushtrohet biznes etj. Informacioni i mbledhur përpunohet nga 2 specialistë të sektorit të biznesit, të cilët mbështetur te paketa fiskale e vitit ushtrimor, bëjnë rillogallitjen e taksave dhe tarifave për çdo biznes. Kjo procedurë bëhet në 15 ditëshin e dytë të muajit Shkurt. **Konstatohet** se edhe pse struktura e DTT Bashkia Vorë është e plotë në numër dhe aktiviteti i saj është i planifikuar dhe i organizuar, nga auditimi rezultoi se ka probleme në vjeljen e të ardhurave dhe për pasojë nuk ka patur efektivitet në realizimin e të ardhurave, pasi evidentohet një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor). Kjo sipas grupit të auditimit ka si burim mosplotësimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë 3 prej punonjësve të kësaj strukture dhe pozicioni i “specilist verifikimi” i mbetur vakant që prej vitit 2020 për arsye transferimi në Drejtorinë e Bujqësisë. Referuar fushës së veprimtarisë së DTT, detyrave dhe përgjegjësisë që ka, personeli përbërës i saj duhet të ketë profil financiar-ekonomik.

Paketa fiskale e miratuar nga KB dhe PBA 2022-2024 ka patur një planifikim të tillë: për vitin 2022 në vlerën 633,702,522 lekë, parashikimi për vitin 2023 në vlerë 665,387,648 lekë;

parashikimi për vitin 2024 në vlerën 698,657,030 lekë. Realizimi i tyre për vitin 2022ka qenë 323,921 mijë lekë.

- Gjithashtu **konstatohet** se referuar strukturës organizative të DTT Bashkia Vorë, janë evidentuar lëvizje të stafit; Drejtori i saj ndonëse me formimin e duhur arsimor, nuk ka rezultuar me zgjidhjen e problematikave të trashëguara ndër vite, uljen e borxhit tatimor të njësisë; personeli specialist me formim IT në strukturën e DTT, me një rindarje të detyrave brenda strukturës së saj, ka sjellë mungesën e implementimit të një Sistemi për administrimin e informacionit tatimor të Bashkisë Vorë, e krijimit të një regjistri të plotë elektronik të subjekteve taksapaguese si dhe në mosevidentimin në kohë reale të subjekteve (ose vonesa në evidentimin e tyre), mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mosdeklarime si dhe vonesë në arkëtimin e të ardhurave, kjo në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në RSH*” me ndryshime, si dhe Rregulloren e Brendshme. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi Nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit për të punësuar personel që plotësojnë kriteret e veçanta/profilin arsimor, për krijimin e një strukture të DTT-të me ndarje të qartë të detyrave dhe gjithpërfshirëse mbështetur në fushën e veprimtarisë, detyrave dhe përgjegjësi që ka DTT, mungesën e planifikimit efektiv për trajnime të punonjësve në përgjithësi dhe atyre të DTT-së në veçanti, për të kuptuar në kohë rëndësishme dhe nevojën imediate për implementimin e programeve kompjuterike, si pjesë e rëndësishme infrastrukture për të maksimizuar vjeljen e taksave dhe miradministrimin e tyre.

- DTT Bashkia Vorë informacionin tatimor e përpunon në paketën Microsoft Office 2013 - programi excel. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor, ka sjellë si pasojë që nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave (DTT), nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjokat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, neni 29, pika 1.

- Nga DTT është në proces verifikimi, përditësimi dhe plotësimi i dokumentacionit të dosjeve të subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “*Për arkivat*” neni 24, neni 9; Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “*Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*” kapitulli II, neni 21, 27 (konstatuar kjo edhe nga auditimi i mëparshëm).

#### ➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

**Për vitin 2022**, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 98, datë 24.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 2049/2 prot., datë 31.12.2021. Nga të dhënat e **pasqyrës përmbledhëse** më poshtë, shihet se për vitin 2021të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në masën 83.5%;ndërsa për vitin 2022 janë realizuar në masën 87.9%. Pra ka patur një rritje prej 4.4%.

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, në mungesë të një databaze të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, me një informacion të plotë të tyre në mungesë edhe të një Sistemi IT, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit, kjo ka çuar në mos llogaritje të tatimit, por për 2 vite 2021 e 2022 është vjelë respektivisht 3,134 mijë lekë dhe 716 mijë lekë. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë dhe në vitin 2022 ka mundur të realizojë vjeljen e taksës në vlerën 9,502 mijë lekë ose 1,102 mijë lekë më shumë se planifikimi.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë;

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Vorë, nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Nga ana e DTT na u komunikua se me UK Vorë nuk ka bashkëpunim për të marrë mbi vete rolin e agjentit tatimor. Në këto kushte deri në fund të vitit 2022 Akt rakordimet me agjentët tatimorë UK Vorë dhe ASHK rezultojnë të mos jenë mbajtur;

- Gjithashtu akt rakordime me DRSHTRR nuk janë mbajtur, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve dhe gjendjes në thesar, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nga ana e Bashkisë Vorë nuk është konfirmuar baza e të dhënave statistikore mbi të cilën janë bërë llogaritjet dhe është vlerësuar niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime të cilat janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117, UMF Nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2021/2022 është paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 është në vlerën 633,702,522 lekë ose 30,176,311 lekë më shumë se planifikimi i tyre në vitin 2021; realizmi i të ardhurave në vitin 2022 është 323,921,045 lekë ose 44,407,746 lekë më shumë se realizimi i tyre në vitin 2021 ose 4.8% më shumë; Realizimin më të lartë për të dy vitet radhazi e kanë të ardhurat nga taksat vendore; realizimin më ulët e kanë të ardhurat nga tarifatat.

#### ➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

**Konstatohet** se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 214 dhe me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Vorë e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Tiranë”, për llogari të Bashkisë Vorë. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. **U konstatua** se rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nuk janë kryer, por informacioni përftohet nëpërmjet rakordimeve mujore me Degën e Thesarit.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Tiranë”.

Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Vorë e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qëndrore, brënda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. **U konstatua** se nuk bëhen rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për efekt të tatimit mbi

fitimin e biznesit të vogël, por nga ana e DRT Tiranë çdo muaj nëpërmjet shkresave zyrtare, vihet në dijeni Bashkia Vorë.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) tani ASHK Vendore Tiranë”, por rakordimet nuk bëhen drejtpërdrejt, por nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë.

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ASHK Vendore Tiranë, për taksën e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer;

4. Bashkia Vorë nuk vjel Rentë minerare, pasi nuk ka subjekte të regjistruar për aktivitete shfrytëzimi të vendburimeve me minerale të ndryshme brenda territorit të Bashkisë Vorë. Kjo verifikuar edhe nga Regjistri i lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore)<sup>8</sup>.

#### ➤ **Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore**

Bashkia Vorë deri në 31.12.2022 nuk ka sipërfaqe bujqësore të dhëna me qira. Sipërfaqja e tokës bujqësore e regjistruar është paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Referuar dokumentacionit shkresor të vënë në dispozicion nga DAMMT, rezultoi se kjo drejtori ka dërguar çdo vit Këshillit të Qarkut Tiranë, Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore në Bashkinë Vorë për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vorë nuk ka dhënë toka bujqësore, sipërfaqe pyjore dhe kullosore me qira personave fizikë, juridikë apo individëve.

Bashkia Vorë ka patur të regjistruar sipërfaqet e tokave bujqësore, pyjore e kullosore, regjistrat e të cilave janë dorëzuar në ASHK me shkresën nr. 1422/1prot., datë 09.03.2021 në përgjigje të kërkesës që kjo e fundit i ka dërguar zyrtarisht Bashkisë Vorë me nr. 1323 prot., datë 15.02.2021, në bazë të ligjit 20/2020. Informacioni dokumentar është shoqëruar me një përmbledhëse të detajuar mbi: nr. e regjistrat, zona kadastrale, njësia administrative/fshati, nr i fletëve, hartat kadastrale.

#### ➤ **Detyrimet e familjarëve**

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marradhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave për qytetin dhe Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, dhe në rastet e mosmarrjes në dorëzim nga debitori, posta i kthen në bashki. Për këto raste DTT angazhon punonjësit e saj për t'i dorëzuar tek debitorët dorazi, me qëllim edhe ndërgjegjësimin e tyre (nuk përjashtohen rastet edhe të komunikimit verbal). Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim,

<sup>8</sup> <http://ëëë.akbn.gov.al/rregjistri-i-lejeve-minerare-aktive/>

gjelbërim, pastrim) Bashkia Vorë nuk ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor. Kjo ka ardhur si rezultat i neglizhencës nga ana e DTT.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumenti i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitore për debitorët familjarë është në vlerën **275,768,705 lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **65,711,729 lekë**; për vitin 2022 sipas rakordimit me DTT-në detyrimi (për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është **24,831,031 lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është 227,045 mijë lekë; Vlera prej **275,768,705 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë**, nga mosarkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, DTTë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2022 janë paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se ka një rritje të numrit të debitorëve të biznesit të madh me 31 dhe vlera e debisë me 31,581,536 lekë; ka një rritje të numrit të debitorëve të biznesit të vogël me 80 dhe vlera e debisë me 8,972,767 lekë; rritje të numrit të debitorëve familjarë ku krahas atyre ekzistues janë shtuar debitorë të rinj duke e rritur vlerën e debisë në total me 25,157,426 lekë; **konstatohet** se ka një rritje të numrit të debitorëve për taksën e ndërtesës e cila deri në 31.12.2022 është në vlerën progresive 26,940,901 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarië së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si edhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mosmarrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimin vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur edhe numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar;

#### ➤ **Taksa e tokës bujqësore:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022 është prej 7,875 mijë lekë dhe është arritur të vilet 5,751 mijë lekë ose 73% e tij;

Pritshmëria vjetore për taksën e tokës është paraqitur në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Detyrimi i pavjelë nga taksa e tokës bujqësore deri në 31.12.2022 është si në tabelën më poshtë:

| Nr. | Njësitë Administrative | Nr. i Familjeve | Vlera 31.12.2022 |
|-----|------------------------|-----------------|------------------|
| 1   | Vorë                   | 210             | 408,720          |
| 2   | Prezë                  | 405             | 735,265          |
| 3   | Bërçull                | 498             | 782,252          |
|     | <b>Totali</b>          | <b>1,113</b>    | <b>1,926,237</b> |

**Burimi:** Bashkia Vorë

Pra **konstatohet** se realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 2,124,000 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 73%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e debisë është për 1113 familjet debitore prej 1,926,237 lekë, e cila është e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet për taksat e tarifatmbajnë përgjegjësi:

- Z. R.M., Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Taksave;

- Z. A.L. me pozicion përgjegjës Sektorit i Biznesit;
- Znj. K.O. me pozicion përgjegjës i Sektorit të taksa e tarifa Familjare;

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

- Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2022 në Bashkinë Vorë, është si më poshtë:

| Nr    | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Të Reja | Mbyllur Aktiviteti | Gjendja në fund të Vitit |
|-------|----------------|------|-------------------|---------------------|--------------------|--------------------------|
| 1     | Biznesi vogël  | 2022 | 865               | 203                 | 82                 | 986                      |
| 2     | Biznesi i madh | 2022 | 676               | 76                  | 35                 | 717                      |
| (1+2) | Gjithsej       | 2022 | 1541              | 279                 | 117                | 1703                     |

**Burimi:** Bashkia Vorë

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezultoi se Bashkia Vorë e ka mbyllur vitin 2021 me **1541** biznese aktive në total, prej të cilëve 865 janë biznes i vogël dhe 676 janë biznes i madh; janë në total **279** regjistrime të reja nga të cilat 203 janë regjistrim për herë të parë si biznes i vogël dhe 76 si biznes i madh;

- Kanë mbyllur aktivitetin gjithsej **117** biznese prej të cilëve 82 janë biznes i vogël dhe 35 janë biznes i madh.

- Bashkia Vorë në fund të vitit 2022 ka të regjistruar në total **1703** biznese, prej të cilëve 986 janë biznes i vogël dhe 717 janë biznes i madh.

Pra rezultoi me një rritje të numrit të bizneseve prej **162** në total, prej të cilëve 121 janë biznes i vogël dhe 41 janë biznes i madh.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Vorë, ndonëse numri i regjistrimeve të bizneseve të reja (të përhershme dhe sezonale) ka ardhur në rritje dhe rezultoi më i lartë se i atyre të mbyllura, përsëri mbetet i lartë relativisht numri i bizneseve të mbyllura (**117**). Për këtë nga ana e Bashkisë Vorë, Koordinatorit i Riskut, GMS, DTT, nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që vilen nga aktiviteti i tyre; Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, njoftimet mbi detyrimet dhe pagesat bëhen me shërbim postar ose dorazi, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që u kërkuar për auditim, rezultoi se informacionet e vëna në dispozicion, nuk janë analizuar si në total edhe për çdo zë tatimor nga ana e DTT/ Bashkia Vorë.

- Një përmbledhje të debisë së vitit 2022 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

|               | KATEGORIA E SUBJEKTIT | DEBIA             |
|---------------|-----------------------|-------------------|
| <b>A</b>      | Biznesi i Vogël       | 8,972,767         |
| <b>B</b>      | Biznesi i Madh        | 31,907,931        |
| <b>C</b>      | Kategoria Familjare   | 24,831,031        |
| <b>TOTALI</b> |                       | <b>65,711,729</b> |

**Burimi:** DTT/Bashkia Vorë

Referuar të dhënave nga DTT, ndarja e debisë për vitin 2022 sipas njësive administrative është paraqitur në Aneksin A8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku konstatohet se numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Vorë me 183 (122+61) debitorë, NJA Prezë me 77 (43+34) debitorë dhe NJA Bërshull me 63 (54+9) debitorë. Në total për 323 debitorë vlera e debisë progresive bashkë me penalitetin është 47,012,803 lekë, e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave/Bashkia Vorë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016. Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> për Bashkinë Vorë. Llogaritja e vlerës është (Sip. Objektivit\* 32,105 \* 0.5 %). Grupi auditues kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit regjistrin e plotë të përfituesve nga legalizimet dhe që janë të detyruar të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas akteve ligjore. Ky regjistër është përpiluar nga informacioni shkresor që ASHK Drejtoria Vendore Tiranë dhe ajo e Përgjithshme në periudha një mujore i kanë dërguar Bashkisë Vorë, listën e qytetarëve/subjekteve, të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit.

Numri i personave që kanë përfituar leje legalizimi nga procedurat e aplikuara te ALUIZNI, të klasifikuara për çdo vit dhe për çdo Njësi Administrative është paraqitur në Aneksin A9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit. Numrin më të lartë të përfituesve e ka NJA Vorë me 701 leje; ndërsa numrin më të ulët e ka NJA Prezë; Rezulton se deri më 31.12.2022 numri total i përfituesve nga procesi i legalizimit është **1431** me vlerën e detyrimit 82,403,794.20 lekë.

**U konstatua** se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Vorë/DTT dhe ASHK, por Bashkia Vorë mjaftohet vetëm me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK. Ky informacion duhet të përmbajë të gjithë parametrat mbi të cilët llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, rezultoi se numri i debitorëve ka ardhur në rënie në total dhe për çdo njësi administrative, por **konstatohet** se numri total i debitorëve të krijuar nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për periudhën 01.01.2018 deri në 31.12.2022 është i lartë 600 debitorë në vlerën totale të debisë 42,885,729.1 lekë. (Aneksi A10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit) Kjo vlerë konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.

Nga auditimi **u konstatua** gjithashtu se DPKZHT/Bashkia Vorë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të dhënat që përmban Vendimi për lejen e legalizimit: numrin e Zonës kadastrale, numrin e pasurisë, numrin e Vendimit, datën e miratimit, sipërfaqen etj; por kjo drejtori informacionin e plotëson nga Vendimi i ardhur nga ASHK, në momentin e paraqitjes së kërkesës së debitorit për pajisjen e tij me faturën e detyrimit. Kjo sjell mungesën e informacionit paraprak mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Informacioni i vënë në dispozicion nga regjistri elektronik i DPKZHT/Bashkia Vorë, i detajuar për çdo njësi administrative, është paraqitur në Aneksin A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Të ardhurat nga TNI për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit

**U konstatua** gjithashtu se Bashkia Vorë për periudhën ushtrimore ka njoftuar subjektet debitorë, por nuk i është drejtuar zyrtarisht edhe ASHK, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës, pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Vorë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, pika 2/1.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

G.D. me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit;

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se detyrimet e papaguara ndër vite (progresive) nga 346 subjektet e biznesit të madh e biznesit të vogël dhe subjektet juridike (përshirë ato shtetërore e publike), janë në total 40,215,142 lekë bashkë me penalitetet, ku për biznesin e vogël janë 295 subjekte ose 85 % e numrit total në vlerën e 28,124,416 lekë dhe përbiznesin e madh janë 51 subjekte ose 15% e numrit total në vlerën 12,090,726 lekë. (Aneksi A13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit).

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se vetëm për vitin 2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 323 subjekte në vlerën totale të detyrimit 47,012,803 lekë; vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë.

Për subjektet debitoare janë marrë masat mëposhtme: njoftim për detyrimet e papaguara; Aplikimi i penaliteteve dhe shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë me nr. 312 prot., datë 18.11.2022.

Njoftimi i subjekteve debitoare kryhet me anë të shërbimit postar, por edhe nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve.

- Nga auditimi **rezultoi** se nga gjendja totale debisë për subjektet fizik/jurik-biznesi i vogël dhe biznesi i madh, 50 % e shumës totale të debisë e zë vlera e debisë së subjekteve D., O., C.P., **u konstatua** se ndaj të cilave nuk janë marrë të gjitha masat administrative të parashikuara në ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”. Kështu Subjekti City Park taksat vjetore i llogariten në vlerën 12,699,779 lekë; nga viti 2015 deri në 31.12.2021 detyrimi progresiv është në vlerën 107,216,355 lekë, penaliteti 25,042,455 lekë dhe detyrimi në total që ky subjekt ka në Bashkinë Vorë arrin në vlerën 144,958,588 lekë.

- Vlera totale e detyrimit për të gjitha subjektet debitoare nga viti 2011 deri më 31.12.2022 arrin në 224,822,145 lekë.

- Lidhur me debitorët objektet ku ushtrojnë aktivitetin e tyre janë dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, rezultoi se nga ana e DTT Bashkia Vorë u është bërë kërkesë subjekteve të dëmtuara për të mbyllur (pezulluar) NIPT-in; Nga të dhënat e tabelës konstatohet se: janë **2** debitorë të biznesit të madh me detyrim progresiv 4,597,089 lekë; janë **68** biznese, objekti ku kanë zhvilluar aktivitetin është dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019; nga këto janë **9** biznese debitoare me vlerën totale të debisë deri më 31.12.2022 prej 479,308 lekë; deri më 31.12.2021 janë **7** biznese debitoare me vlerë të debisë 343,015 lekë dhe gjatë vitit 2022 ky numër është rritur me **2** debitorë të rinj në vlerë totale të debisë për vitin 2022 me 136,293 lekë. Vlera 5,076,397 (4,597,089+479,308) lekë është e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë dhe me mundësi të vogël për tu arkëtuar.

- Nga të dhënat në tabelë rezulton se janë 56 debitorë familjarë , vendbanimet e të cilëve janë shembur nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019. **Konstatohet** se nga ana e DTT Bashkia Vorë nuk janë përlllogaritur veçmas detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që kanë për të paguar familjet debitoare për periudhën para dhe pas tërmetit. Titullari i bashkisë dhe GMS nuk kanë bërë analizë të situatës mbi vijimësinë e statusit të debisë së këtij grupi debitorësh.

- Referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, gjendja e debitorëve është paraqitur në Aneksin A9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Sa me sipër arrihet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Vorë, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal**, bazuar në nenin 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- Z. R.M. me detyrë Drejtor Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Znj. M.D. me detyrë përgjegjës Sektorit i Planifikimit dhe vlerësimit të taksave;
- Znj. K.O. me detyrë përgjegjës Sektorit i taksa e tarifa Familjare;
- Z. A.L. me detyrë përgjegjës i Sektorit të biznesit;

#### ➤ **Tarifa parkimi**

Kjo tarifë u vilet poseduesve të automjeteve të ndryshme të cilët parkojnë në vende publike. Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj tarife është DTTV bazuar në kontratat që lidh me subjektet apo individët që janë të interesuar për vend parkimi. Sipas VKB nr. 98 datë 24.12.2021 niveli i kësaj tarife është 10 lekë/ora. **U konstatua** se nga ana e DTTV Vorë nuk është lidhur asnjë kontratë, ndonëse në vendet publike të territorit të kësaj bashkie parkojnë automjete të cilat u përkasin subjekteve publikë, privatë /juridikë e fizikë etj. Nga ana e DTTV na u dha kjo përgjigje: *Bashkia Vorë nuk ka lidhur kontrata për vendparkim gjatë vitit 2022. Duke qenë në proces rindërtimi nuk ka pasur kërkesa për vendparkime.*

#### ➤ **Burimi i krijimit të të ardhurave jotatimore,**

##### **Nga gjocat e IMTV**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Vorë, u kërkuar informacion i detajuar për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, nga IMTV/Bashkia Vorë (dhe jo vetëm). Gjatë periudhës objekt auditimi IMTV-ja ka ushtruar funksionin publik duke u bazuar në ligjin nr. 183/2014, datë 24/2014 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga veprimet e kundërligjshme” sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji. IMTV-ja e Bashkisë Vorë, ka bashkëpunuar rregullisht me Zyrën e Urbanistikës, me Policinë Bashkiake, me Zyrën e Shërbimeve, me IKMT Qendrore në Tiranë.<sup>9</sup>

Nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2019 deri në 31.12.2022 nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vorë, janë 8 gjoba të vendosura prej 2018 deri në 2021 në vlerën 2,650,000 lekë dhe 7 gjoba të vendosura në vitin 2022 në vlerën 3,050,000 lekë.

U konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vorë janë vendosur **23** gjoba me vlerën në total 5,100,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë **114** gjoba në vlerën **41,000,000 lekë**, nga të cilat rezultojnë të likuiduara **31** gjoba në vlerën 4,650,000 lekë; për gjocat e papaguara (të papranuara) janë bërë kërkesat në gjykatë për tu shpallur titull ekzekutiv. Për **2** objektet e dëmtuara nga tërmeti grupit të auditimit nuk iu vu ndonjë dokument në dispozicion mbi procedurën që do vijohet për vlerën debitore të tyre; Pra vlera prej 36,350,000 lekë konsiderohet e ardhur e mundur në buxhetin e Bashkisë Vorë.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 16, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenin 15 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Nga Drejtoria Juridike dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

<sup>9</sup> Informacion i detajuar mbi masat administrative (gjoba) të IMTV, janë të përshkruara në Akt Konstatimin nr. 5, “mbi aktivitetin e IMTV Bashkia Vorë”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Z. J.K. me detyrë Kryeinspektor i IMTV

➤ **Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste**

Nga DTT /Bashkia Vorë për shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura, është aplikuar edhe lidhja e Akt marrëveshjeve për pagesë me këste nga ana e debitorëve. Situata e detyrimeve për subjektet të cilat kanë lidhur Akt marrëveshje me Bashkinë Vorë, pasqyrohet në Aneksin A10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku vërehet se debia totale për **9** subjektet ka qenë në vlerën 6,176,424 lekë, nga e cila është paguar 30% e saj në vlerën 1,055,294 lekë; nga 9 subjektet kanë likuiduar detyrimin **3** subjekte debitoare në vlerën 141,131 lekë. Rezulton se deri në 31.12.2022 vlera e debisë për **6** subjekte është **3,200,000** lekë dhe se pagesat nga ana e subjekteve janë kryer konform aktmarrëveshjeve.

➤ **Nga Qira Trualli/të tjera**

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor dhe statistikor (tabelar) rezultoi se janë lidhur kontrata qiraje me 4 subjekte, për afate të ndryshme kohore, nga të cilat 3 subjekte kanë paguar detyrimin kontraktor, ndërsa **1** subjekt "V.A." Sha nuk ka paguar detyrimin i cili deri në 31.12.2022 është në vlerën progresive prej **21,343 \$**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksa dhe Tarifave Vendore [DTT], dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB konstatohet se në Bashkinë Vorë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 22 subjekte. Nga auditimi rezulton se Bashkia Vorë sipas Akt Konstatimin të mbajtura nga inspektimet në terren, ka verifikuar subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren (me foto të bashkangjitura) dhe që rezultojnë aktiv në QKB. gjendja për subjektet është:

1. K.O.- mbyllur
2. G.C.G. -**2** pika, të papajisur me autorizim
3. K.2. – i papajisur me autorizim
4. K.-**1** pik i papajisur me autorizim
5. I.O.- i papajisur me autorizim
6. S.P. shpk, nuk e ka ushtruar aktivitetin, por ka funksionuar vetëm shërbimi i barkafe;
7. S.O., nuk ka autorizim pasi nuk është për konsumatorët fundor.

- Në total rezultojnë 22 subjekte, që në mënyrë të detajuar sipas problematikës janë paraqitur në Aneksin A11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga dokumentacioni i venë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Vorë për vitin ushtrimor 2022/2023 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të pajisura me autorizim, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, **u konstatua** se këto 14 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe gjatë vitit 2022 kanë paguar pjesërisht detyrimet në vlerën 1,800,000 lekë total; janë 5 subjekte të papajisura me autorizim të cilat nuk kanë paguar detyrimin dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre; deri në 31.12.2022 është e papaguar vlera 3,200,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë;

Lidhur me subjektet të cilat kanë detyrime, nga ana e DTT na u bë me dije se gjatë vitit 2022 i është dërguar për bllokim të llogarive bankare të subjekteve debitoare, gjithë bankave të nivelit të dytë. Thëksojmë se nga ana e DTT kjo është e vetmja masë që është marrë ndaj këtyre subjekteve debitoare, me të cilat nuk është arritur të lidhet Akt Marrëveshje. Përfundim bën

vetëm subjekti Veliaj Petrol – 2 pika tregëtimi; Gjithashtu nga DTT nuk na u vu në dispozicion asnjë procesverbal/akt konstatim/akt verifikim i përpiluar për subjektet të cilat nuk janë të pajisuara me autorizim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. R.M., Drejtor i DTT.

### ➤ Përjashtimet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

#### Taksa mbi Ndërtesën

Referuar VKB nr. 98 DTTë 24.12.2021 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vorë 2022", janë miratuar 11 kategori që përfitojnë lehtësira dhe përjashtime nga taksa mbi ndërtesën. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e Takave e Tarifave Vendore Vorë [DTTV].

Nga auditimi rezultoi se janë 509 përfitues, të cilët nuk paguajnë taksën mbi ndërtesën. (lista e detajuar në aneksin e Akt Konstatimit). Nga verifikimi me zgjedhje rastësore të dosjes së disa përfituesve rezultoi se ishin dorëzuar dokumentacioni konform kërkesave të përcaktuara në VKB. **U konstatua** se nga ana e DTT Vendore Vorë nuk është vendosur vlera e taksës për çdo përfitues dhe rrjedhimisht nuk është llogaritur vlera totale e saj, si një përfitim financiar i komunitetit.

#### Taksa mbi Tokën bujqësore

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira dhe përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore ata posedues toke për 5 vitet e para nga çasti i mjelljes së tokës me vreshtari dhe dru frutorë. Struktura përgjegjëse është DTT Vendore Vorë. Nga kjo Drejtori na u konfirmua se nuk ka asnjë përfitues për taksën e tokës bujqësore;

#### Taksa e Kalimit të të drejtës së pronësisë

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira dhe përjashtohen nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme 3 kategori. Kjo taksë vilet nga ASHK, në rolin e agentit tatimor e cili përfiton një komision prej 3% të shumës së arkëtuar. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Vorë [DTTV]. Nga kjo Drejtori nuk u dha informacion nëse ka përfitues, pasi edhe më lart është shprehur mungesa e akt rakordimeve me ASHK.

#### Tarifa e Pastrimit

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira nga Tarifa e pastrimit 5 kategori sociale me 4 nivele pagesash. Kjo tarifë vilet nga Sektori i taksave dhe tarifave për familjarë/DTT Vendore Vorë [STT/DTTV] Nga kjo drejtori për vitin 2022 na u dha informacioni si në tabelë:

| Kategoria                       | Tarifa (në lekë) | Numri i përfituesve | Vlera totale për çdo kategori |
|---------------------------------|------------------|---------------------|-------------------------------|
| Familje me ndihmë sociale       | 0                | 52                  | 0                             |
| Invalidë                        | 0                | 348                 | 0                             |
| Familje emigrantësh             | 2,400            | 565                 | 1,356,000                     |
| Familje pensionistësh           | 1,000            | 165                 | 165,000                       |
| Familje me Kryefamiljare (grua) | 1,000            | 1                   | 1,000                         |
| <b>Totali</b>                   |                  | <b>1,131</b>        | <b>1,522,000</b>              |

**Burimi:** STT/Bashkia Vorë

Nga sa më sipër u **konstatua** se STT/Bashkia Vorë nuk ka pasqyruar një informacion të plotë për përfituesit, duke mos dhënë vlerën e tarifës së plotë që duhet të paguanin këta përfitues në rast se nuk do të klasifikoheshin në kategoritë përfituese të mospagesës /lehtësira të tarifës së pastrimit. Kjo për të analizuar efektin financiar që ka në buxhetin e bashkisë nga njëra anë dhe atë social për komunitetin nga ana tjetër.

#### Tarifa e shitjes së Tokës bujqësore

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira nga Tarifa e shitjes së tokës bujqësore për këto raste: kalimi nga një fermer i regjistruar te një person fizik a juridik që kryen

aktivitet bujqësor; brenda lidhjes gjinore familjare, kur dhurohet apo hiqet dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar. Kjo tarifë vilet nga Drejtoria e Administrimit, menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës [DAMMT]. *Nuk u vu në dispozicion Informacion.*

#### **Tarifa e Çertifikatës së përdorimit**

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira nga Tarifa e Çertifikatës së përdorimit - niveli “a” – [150 lekë/m<sup>2</sup> për të gjithë sipërfaqen e pronës që do të konvertohet nga tokë arë në truall], të gjitha Agrobizneset që do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Vorë, duke e vlerësuar si një stimul për investime në prodhime bujqësore e blegtorale. Kjo tarifë vilet nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit [DPKZHT]. *Nuk u vu në dispozicion Informacion.*

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vorë për periudhën 2011-2022 në vlerën totale (progresive) **358,204,434.1 (+)lekë:**

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve për vitin 2022 në vlerën **25,157,426 lekë** dhe në vlerën progressive **56,604,067 lekë.**
2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit për vitin 2022 në vlerën **47,012,803 lekë** dhe vlera progresive **219,164,638 lekë;**
3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit nëninfrastrukturë për vitin 2022 është 4,422,770.2 lekë dhe për periudhën 2018-2022 në vlerën progresive **42,885,729.1 lekë.**
4. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **3,200,000 lekë.**
5. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMTV për periudhën 2019-2022 në vlerën **36,350,000 lekë**

**Titulli i gjetjes:** Mbi të ardhurën e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë nga mospagesa e plotë e tarifës së autorizimit nga subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse, në vlerën 2,221,083 lekë.

**Situata:** Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse u konstatua:

1. Subjekti “K.” SHPK, me NUIS J.....P, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2019-2024, periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 1,100,000 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë;
2. Subjekti “G.C.G.” SHPK, me NUIS K.....T, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2021-2026 periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 778,917 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë dhe 321,083 lekë e ardhur e munguar.
3. Subjekti “K.” SHPK, me NUIS L.....J, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj. Ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2018-2023 periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 200,000 lekë e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë dhe 900,000 lekë e ardhur e munguar.
4. Subjekti “L.B.” SHPK, me NUIS J6.....M, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ky subjekt është pajisur me autorizim për periudhën 2020-2025, periudhë e mbuluar me autorizim për 5 vite në vlerën 100,000 lekë, e arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë dhe 1,000,000 lekë e ardhur e munguar.

Nga auditimi, u konstatua se referuar dokumentacionit nga shqyrtimi i dosjeve përkatëse të subjekteve, autorizimi për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre është dhënë për një

periudhë 5 vjeçare sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar. Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, u konstatua se nga subjektet që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregtimit të hidrokarbureve ka një efekt financiar me vlerë totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 15, neni 20, pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vorë.

**Shkak:** Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Vorë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa paguar plotësisht tarifën për pajisjen me autorizimin e tregtimit të hidrokarbureve, për vlerën totale 2,221,083 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.

**2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

**2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

**2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

**2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës**

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (i shfuqizuar), Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2022, konkretisht:

**Pasqyrat Financiare të vitit 2022.**

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Bashkia Vorë ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2022, mbështetur në UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

*Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Vorë me NIPT K51713032C;
  - Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
  - Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.03.2023;
  - Përgatitur nga z. S.B.,
  - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1738, datë 28.03.2023 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Vorë z. B.Sh..
    - Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Tiranë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Vorë, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Tiranë.

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

Llogaritja e materialitetit është paraqitur në Aneksin PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Aktivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Vorë është paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

**1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 5,263,913,452 lekë.**
- Aktivet 6,078,370,510 lekë
- Pasivet 814,457,058 lekë
- Aktivet neto 5,263,913,452 lekë.

**I. Aktivet Afatshkurtra**

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **1,210,2023,043 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **428,758,417 lekë;**
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **23,065,128 lekë;**
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **345,511,941 lekë.**
- Llogaria e Klasës 4 “Te tjera aktive afatshkurtra” në shumën **412,867,557 lekë.**

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”,** përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 428,758,417 lekë, e cila rakordon me rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr. 466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

Llogaria nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 147,697,079 lekë. Referuar të dhënave të marra nga sistemi i Thesarit rezulton se teprica e llogarisë 520 e pasyruar në pasqyrën e pozicionit financiar nuk përputhet me të dhënat e Thesarit, konkretisht: Teprica debitore e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 428,758,417 lekë ndërsa sipas të dhënave të Thesarit kjo tepricë paraqitet në vlerën 501,932,273 lekë. Pra ka një diferencë prej 73,173,856 lekë.

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të parakorduara.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, janë paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vorë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 23,065,128, lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,794,988 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 20,270,140 lekë.

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (1,224,367) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (1,224,367) lekë.

- Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 2,794,988 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

- Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 9,952,678 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre, përsa i përket llogarive të klasës 3, është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Titullari i Bashkisë Vorë e madhe ka nxjerrë Urdhërin e inventarizimit nr. 179 datë 13.10.2022, ku janë përcaktuar Grupet për inventarizimin të objekteve të inventarit llogaria 327 dhe 218. Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” janë paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në bilancin e vitit 2022 me tepricë debitore 302,988,134 lekë. Kjo llogari ka pësuar rritje nga viti 2021 në vlerën 165,668,462.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur e detajuar në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Kjo llogari është e analizuar në pasqyra të veçanta sipas subjekteve debitore.

Lista e debitorëve të taksave dhe tarifave i është dërguar drejtorisë së financës nga ana e drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore me shkresën nr. 26, datë 28.03.2023. Kontabilizimi i tyre është bërë mbështetur në Urdhërin nr. 45, datë 31.03.2023 “Për regjistrimin në kontabilitet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022”.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 26,650,257 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të

Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 42,523,807 lekë, në përputhje me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Kapitulli III, pika 32. Vlera prej 42,523,807 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar sipas paraqitjes në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 412,867,557 lekë.

Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila përbëhet nga vlera 412,867,557 lekë për detyrime të prapambetura, si më poshtë:

| Përshkrimi                                     | Vlera              |
|------------------------------------------------|--------------------|
| Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore | 5,961,950          |
| Detyrime të prapambetura për mirëmbajtjen      | 81,886,827         |
| Detyrime të prapambetura për investime         | 327,018,780        |
| <b>Totali</b>                                  | <b>412,867,557</b> |

Përpunuar nga grupi i Kllsh-së.

#### **AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)**

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 98,503,377 lekë në fund të vitit 2021 dhe në vitit 2022 në vlerën 101,503,377 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 101,503,377 lekë, si më poshtë:

| Nr. | llogaria | Përshkrimi       | Viti 2021  | Shtesa    | Pakësime | Viti 2022   |
|-----|----------|------------------|------------|-----------|----------|-------------|
| 1   | 202      | Të mbartura      | 98,503,377 | 3,000,000 |          | 101,503,377 |
|     |          | <b>Shuma 202</b> | 98,503,377 | 3,000,000 |          | 101,503,377 |

**Burimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

**U konstatua:** Nga auditimi i kësaj llogarie rezulton se amortizimi në vitet ushtrimore nuk është bërë, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36.

**Titulli i Gjetjes:** KLSH konstatoi se llogaria 202, paraqitet në mbyllje në vlerën 98,503,377 lekë në fund të vitit 2021 dhe në vitit 2022 në vlerën 101,503,377 lekë. Diferenca e vitit ushtrimor 2022 me atë paraardhës prej 3,000,000 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15% e zbritur nga vlera e mbetur gjëndje në fund të vitit 2021 si edhe shtesat e krijuara gjatë vitit 2022. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 101,503,377 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

**Situata:** Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 98,503,377 lekë në fund të vitit 2021 dhe në vitit 2022 në vlerën 101,503,377 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2022 llogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 101,503,377 lekë.

Analitiku i llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”

| Nr.              | llogaria | Përshkrimi  | Viti 2021  | Shtesa    | Pakësime | Viti 2022   |
|------------------|----------|-------------|------------|-----------|----------|-------------|
| 1                | 202      | Të mbartura | 98,503,377 | 3,000,000 |          | 101,503,377 |
| <b>Shuma 202</b> |          |             | 98,503,377 | 3,000,000 |          | 101,503,377 |

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 28.07.2023

**Kriteri:** UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2, Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël”.

**Ndikimi:** Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:** Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vorë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimit sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

## **AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)**

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”.

AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 4,644,704,948 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 4,419,552,966 lekë, me një rritje të AAM-ve në shumën 136,273,164 lekë. Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale” janë paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 5,034,117,446 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 4,785,055,293 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

- Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë neto 103,355,126 lekë, në vitet ushtrimore 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën neto 103,355,126 lekë, pra nuk ka pësuar ndryshime.

Në mënyrë analitike llogaria nr. 210 “Toka, troje, terrene” është paraqitur në Aneksin PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Llogaria nr. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet me vlerë neto 49,692,984 lekë, në vitet ushtrimore 2022 dhe 2021, pra nuk ka pësuar ndryshime. Në mënyrë analitike llogaria nr. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur në Aneksin PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin dhe administrimin e Aktiveve Afatgjata Materiale llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”.

**Situata:** Llogaria nr. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 507,675,819 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 498,175,819 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 547,392,330 dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 537,392,330 lekë. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është rritur me vlerën 10,000,000 lekë. Tabela e detajuar e llogarisë nr. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në Aneksin PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

U konstatua se në mënyrë analitike në llogarinë nr. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në fund të vitit 2022 janë regjistruar aktive me vlerë totale 714,568,714 lekë ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 547,392,330 lekë. Pra, diferenca prej 167,176,384 lekë është paraqitur në mënyrë analitike në regjistrat e aktiveve më shumë se sa në pasqyrat financiare në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe pika 30.

**Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 28.07.2023**

**Kriteri:** UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe pika 30.

**Shkak:** Vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë; kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa nëpërmjet strukturave për të përgatitur dosjet me dokumentacionin e duhur, ndërsa Drejtoria e Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme si dhe të kryejë kontabilizimin në mënyrë të saktë të llogarisë nr. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, duke kryer dhe rakordimin me regjistrat e aktiveve për vlerën 167,176,384 lekë.

- Llogaria nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 3,865,253,858 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën neto prej 3,658,587,665 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 4,175,632,822 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet me koston historike 3,958,089,461 lekë.

Në mënyrë analitike llogaria nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është paraqitur në Aneksin PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Aktivet e regjistruara si Ujësjiellës, në mënyrë analitike në fund të vitit 2022 për vlerën 996,663,226 lekë, janë paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Aktivet e regjistruara si Rrugë, në mënyrë analitike në fund të vitit 2022 për vlerën 996,663,226 lekë, janë paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në mënyrë analitike në llogarinë nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në fund të vitit 2022 janë regjistruar aktive me vlerë totale 4,137,982,916 lekë ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 4,175,682,822 lekë. Pra, diferenca prej 37,649,906 lekë nuk është paraqitur në mënyrë analitike në regjistrat e aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe pika 30.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e administrimin e Aktiveve Afatgjata Materiale llogaria nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

**Situata:** Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 3,865,253,858 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën neto prej 3,658,587,665 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 4,175,632,822 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet me koston historike 3,958,089,461 lekë.

- Aktive të regjistruara si Ujësjiellës, në mënyrë analitike në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 996,663,226 lekë.

- Aktive të regjistruara si Rrugë, në mënyrë analitike në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 996,663,226 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 28.07.2023

**Kriteri:** UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe pika 30.

**Shkaku:** Vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të bëjë kontabilizimin në mënyrë të duhur të llogarisë nr. 213 si dhe të rakordojë në mënyrë analitike me regjistrat e aktiveve.

- Llogaria nr. 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 26,949,687 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 39,322,779 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 39,322,779 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 39,322,779 lekë. Llogaria nr. 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune” është paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Llogaria nr. 215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 29,831,644 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 25,356,897 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar me vitin paraardhës në koston historike 34,541,960 lekë. Llogaria nr. 215 “Mjete transporti” është paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

- Llogaria nr. 218 “Inventar ekonomik”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 66,420,577 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 43,976,812 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 84,179,445 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 62,600,653 lekë. Gjatë vitit ushtrimor kemi pasur shtesa në llogari të materialeve në vlerën 25,218,684 lekë dhe pakësime në vlerën 3,699,892. Pakësimi vjen nga nxjerrjet jashtë përdorimi të cilat janë kontabilizuar pa u bërë asgjësi i aseteve që i përkasin kësaj llogarie.

- Gjendja e llogarisë nr. 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Vorë në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën (389,412,498) lekë.

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre” është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

**U konstatua se:** Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve nuk është bërë në të gjitha rastet sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, pika 36. Nuk është llogaritur amortizimi për aktivet që i përkasin llogarisë 202.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për cdo grup aktivesh. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2021 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej (425,071,008) lekë, duke debituar llogarinë nr. 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e

ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive nr. 2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 39,716,511 lekë, llogarisë nr. 2194 “Amortizim makineri dhe pajisje” në vlerën 12,373,092 lekë, llogarisë nr. 2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 9,185,063 lekë, llogarisë nr. 2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 17,758,868 lekë. Gjatë vitit 2022 është bërë pakësim i llogarisë 218.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2022.**

Në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Vorë. **U konstatua se** Nga ana e Bashkisë Vorë është bërë pakësimi i aktiveve pa u bërë procedurat e asgjësimit të tyre në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Titulli i gjetjes:** Nga ana e Bashkisë Vorë është bërë pakësimi i aktiveve pa u bërë procedurat e asgjësimit të tyre.

**Situata:** Është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vorë nr. 179 datë 13.10.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të objekteve të inventarit (llogaria 327) dhe inventarit ekonomik (llogaria 218)”. Bashkia Vorë nuk ka ngritur Komisionin e inventarizimit për aktivet afatgjata materiale në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga ana e Bashkisë Vorë është ngritur komisioni i vlerësimit me Urdhërin nr. 216, datë 12.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve (llog. 218 dhe llog. 327)”. Mbështetur në këtë urdhër komisioni ka mbajtur relacion për vlerësimin e aktiveve të bashkisë Vorë (llogaria 218 dhe llogaria 327). Bashkia Vorë ka ngritur komisione për asgjësimin e objekteve të inventarit (llogaria 327) dhe inventarit ekonomik (llogaria 218), por nuk janë kryer procedurat e asgjësimit të aktiveve nga ana e Bashkisë Vorë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 28.07.2023

**Kriteri:** UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Shkak:** Mosngritja e komisioneve të inventarizimit.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa nëpërmjet strukturave përkatëse për shqyrtimin e procedurave të asgjësimit të aktiveve si dhe ngritjen e komisioneve të inventarizimit për menaxhimin e aktiveve të Bashkisë Vorë.

### **➤ PASIVET (DETYRIMET)**

**Pasivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Vorë** është paraqitur në Aneksin PF17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

#### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vorë më 31.12.2022, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor 2022 është në vlerën 2,015,346 lekë.

Detyrimet për furnitorët gjatë vitit 2022 janë paraqitur në mënyrë analitike në Aneksin PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 412,867,557 lekë. Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr. 486

“Shpenzime të ardhshme” e cila përbëhet nga vlera 412,867,557 lekë për detyrime të prapambetura.

Detyrimet e prapambetura:

| Përshkrimi                                     | Vlera              |
|------------------------------------------------|--------------------|
| Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore | 5,961,950          |
| Detyrime të prapambetura për mirëmbajtjen      | 81,886,827         |
| Detyrime të prapambetura për investime         | 327,018,780        |
| <b>Totali</b>                                  | <b>412,867,557</b> |

Përpunuar nga grupi i Klsh-së.

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Vorë, paraqitet në vlerën 15,773,375 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor cila rakordon me vlerën sipas listëpagesave të muajit Dhjetor 2022.

- Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 608,291 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

- Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatsisht në vlerat 3,068,708 dhe 2,058,087 lekë.

U konstatua se: Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet në vlerën kontabël prej 56,077,560 lekë, vlerë kjo e cila është e parakorduar me degën e thesarit Tiranë.

Mbështetur në akt-rakordimet me thesarin gjatë vitit 2022 kjo llogari është shtuar me 13,378,561 lekë nga ngurtësimet e garancive të punimit të vitit, me 945,000 nga taksa e pullës dhe është pakësuar me 9,728,795 lekë nga likuidimet e garancive të punimit. Prandaj, teprica kreditore e kësaj llogarie mbështetur në të dhënat e thesarit në fund të vitit 2022 është 55,910,560.4 lekë.

Diferenca midis vlerës së llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” ndërmjet Bashkisë Vorë dhe Degës së Thesarit Tiranë është 167,000 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022.

**Titulli i gjetjes:** Mosrakordim i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

**Situata:** Llogaria nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet në vlerën kontabël prej 56,077,560 lekë, vlerë kjo e cila është e parakorduar me degën e thesarit Tiranë.

Mbështetur në akt-rakordimet me thesarin gjatë vitit 2022 kjo llogari është shtuar me 13,378,561 lekë nga ngurtësimet e garancive të punimit të vitit, me 945,000 nga taksa e pullës dhe është pakësuar me 9,728,795 lekë nga likuidimet e garancive të punimit. Prandaj, teprica kreditore e kësaj llogarie mbështetur në të dhënat e thesarit në fund të vitit 2022 është 55,910,560.4 lekë.

Diferenca midis vlerës së llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” ndërmjet Bashkisë Vorë dhe Degës së Thesarit Tiranë është 167,000 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 28.07.2023

**Kriteri:** UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022.

**Shkak:** Mos pasqyrim i saktë i llogarisë.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës, Bashkia Vorë të marrë masa të menjëhershme për rakordimin me degën e thesarit për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

➤ **Formati nr. 2 “Pasqyra e Performancës Financiare”**

Paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara për vitet ushtrimore 2022 dhe 2021 sipas aneksit PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2022 (grant) paraqiten në shumën prej 1,307,392,617 lekë. Të ardhurat e realizuara nga Bashkia Vorë për vitin 2022 janë 322,974,845 lekë nga të cilat: Të ardhurat tatimore në vlerën 255,068,594 lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën 67,906,251 lekë, sipas aktit të rakordimit me degën e Thesarit Tiranë.

**Auditimi i zonave të llogarisë:**

a) Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601)

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe drejtoria e financës në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet u konstatua se:

- Është hartuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Vorë dhe nuk ka pasur ndryshime në vitin 2022.

- Për vitin 2022 janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse, të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore nga Prefektura e Qarkut Tiranë.

- Organika për vitin 2022 ka funksionuar me 487 punonjës punonjës nga këto për administratën e aparatit të Bashkisë 404 punonjës, NJA Berxull 46 punonjës dhe NJA Prezë 37 punonjës.

| Emërtimi            | Plan       | Fakt       |
|---------------------|------------|------------|
| Aparati i bashkisë. | 404        | 343        |
| NJA Berxull         | 46         | 42         |
| NJA Prezë           | 37         | 34         |
| <b>Gjithsej:</b>    | <b>487</b> | <b>419</b> |

- Për të gjithë periudhën e audituar janë respektuar struktura dhe organika.

- Nga të punësuarit 75 janë të me statusin e nëpunësit civil, marrdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me Ligjin nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 344 punonjës janë me kontratë pune, marrdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

- Përcaktimi i nivelit të pagave është bërë në përputhje me kërkesat e VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 177 datë 08.03.2017. Në hartimin e këtyre strukturave janë zbatuar kriteret e klasifikimit të vendeve të punës për organet e qeverisjes vendore në lidhjen nr. 5, duke përshtatur dhe respektuar kufijtë e niveleve të pagave në përputhje me kategorinë e kësaj njësie vendore (20,000-50,000 mbas zbatimit të Reformës Teritoriale). Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Aparatin Qendror të e Shërbimit Informativ të Shtetit jepet nga pasqyra në vijim:

- Është mbajtur dhe përditësuar libri i pagave dhe ditari i pagave.

- Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listëpagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i

financës dhe titullari. Në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për paga rezultoi se listëpagesat nuk janë nënshkruar nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kundërshtim me UMF nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 69.

- Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në listëpagesat e muajit shtator të vitit 2022, rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejt sipas tabelës së pagave si dhe kanë përputhje me nivelin e arsimit. Nga ky sondazh u verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesa e tyre, ku rezultoi se ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 5 të VKM të pagave dhe sipas kategorisë 3 së kësaj njësie vendore. Gjithashtu listëpagesat janë të shoqëruara dhe në përputhje me listëprezencat përkatëse.

- Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

- Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat.

- Janë respektuar drejt dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës. Nuk ka në asnjë rast pagese për orë jashtë orarit.

- Nga verifikimi rezultoi se në çdo rast shpenzimet e paraqitura në llogarinë 606 janë të mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse dhe të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues.

- U auditua krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë për periudhën 2022, nga u konstatua se është respektuar kufiri në masën prej 5% mbi fondin e pagave sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Këto fonde janë përdorur vetëm për raste dalje në pension si dhe raste fatkeqësisht në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

### **Mallra dhe shërbime (llogaria 602)**

#### *Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë*

Mbajtja e kontabilitetit të ardhurave është bërë nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar nga specialisti i financës që mbulon kontabilizimin e të ardhurave të realizuar nëpërmjet arkës dhe me bankës. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas mandat-arkëtimeve të arkës dhe të bankës. Kontabilizimi i të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7 sipas llojeve të ardhurave. Për të ardhurat e arkëtuara nëpërmjet Arkës evidentohen në librin e arkës sipas mandat arkëtimeve dhe kryqëzohen me fatura për arkëtim të lëshuar nga Sektori i Tatim Taksave. Sektori i Tatim taksave evidenton dhe regjistron të gjithë llojet e të ardhurave të kryera nëpërmjet Bankës dhe Arkës e cila finalizohet me akt-rakordimin me Thesarin Dega Tiranë për të ardhurat, të cilat nga verifikimi me zgjedhje për muajin shtator 2022 rakordonin me ditarin e të ardhurave. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk është kryer rakordim mujor dhe progresiv për të ardhurat me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe me Degën e Thesarit me anë të ekstrakteve të bankës vetëm në muajin dhjetor 2022 që korrespondon me mbylljen e vitit ushtrimor. Pasqyrimi i të ardhurave në bilanc bëhet me artikull kontabël nga jashtë.

Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar administrohen dhe kontabilizohen letra me vlerë pullat e Gjendjes Civile, vlera e të cilave është kontabilizuar në llogarinë 466 “Kreditorë të ndryshëm”, gjendja në bilanc e së cilës paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 945,000 lekë por nuk është rakorduar për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Tatimeve Tiranë.

#### *Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të vitit ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

## **2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve**

### **2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### **2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

**Titulli i gjetjes:** Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë konstatuar probleme në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, trajtimin e ankesave, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK.

**Situata:** Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar si vijon:

Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Vorë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, si dhe procedura e zhvilluar në vitin 2021, por e paaudituar, janë paraqitur në Aneksin P1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Vorë (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën më poshtë:

| <b>Procedura 01.01.2022-31.12.2022</b> | <b>Nr.</b> | <b>Vlera e Fondit Limit</b> | <b>Vlera e Kontraktuar</b> |
|----------------------------------------|------------|-----------------------------|----------------------------|
| <b>Gjithsej</b>                        | <b>21</b>  | <b>427,732,602</b>          | <b>412,327,133</b>         |
| - E hapur ndërkombëtare                | 1          | 273,460,221                 | 266,880,371                |
| - Të hapura                            | 4          | 106,752,179                 | 100,507,332                |
| - Të hapura të thjeshtuara             | 5          | 18,102,366                  | 16,814,763                 |
| - Negociim pa shpallje                 | 1          | 22,966,804                  | 22,330,674                 |
| - Blerje të vogla                      | 10         | 6,451,032                   | 5,793,993                  |

| Procedura 01.01.2022-31.12.2022         | Nr. | Vlera e Fondit Limit | Vlera e Kontraktuar |
|-----------------------------------------|-----|----------------------|---------------------|
| <b>Sipas objekteve</b>                  |     |                      |                     |
| - Objekte në fushën e investimeve       | 8   | 110,888,913          | 104,606,605         |
| - Objekte në fushën e shërbimeve/blerje | 13  | 316,843,689          | 307,720,528         |

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Vorë

Për vitin ushtrimor 2022, nga Bashkia Vorë, referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve ka kryer gjithsej 21 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 427,732,602 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 412,327,133 lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 15,405,470 lekë pa TVSH ose 3.6%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë 8 procedura me fond limit 110,888,913 lekë pa TVSh ose 76.8% e kontratave të lidhura dhe në fushën e shërbimeve/blerje janë 13 procedura me fond limit 307,720,528 lekë pa TVSh.

Krahas sa më sipër, në Bashkinë Vorë gjatë periudhës objekt auditimi janë zhvilluar edhe tre procedura prokurimi të përsheptuara, në lidhje me rindërtimin. Është audituar edhe një procedurë e zhvilluar në vitin 2021, e cila nuk është audituar nga KLSH në auditimet e mëparshme, si më poshtë:

| Nr.           | Objekti i procedurës së Prokurimit                                                                   | Lloji i procedurës   | Fondi limit        | Vlera e kontratës  |
|---------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------|--------------------|
| 1             | Rindertimi i shkolles se mesme Isa Boletini, Bashkia Vorë                                            | E kufizuar           | 279,218,916        | 279,000,000        |
| 2             | Mbikqyrje per objektin "Rindertimi i Shkolles së Mesme Isa Boletini, Vorë"                           | E hapur e thjeshtuar | 2,939,621          | 2,591,305          |
| 3             | Rindertimi i Shkolles 9 vjecare Picar                                                                | E kufizuar           | 137,930,944        | 137,820,000        |
| 4             | Mbikqyrje te punimeve per objektin "Rindertimi i Shkolles 9 vjecare Picar" Bashkia Vore              | E hapur e thjeshtuar | 1,357,277          | 1,078,423          |
| 5             | Prishje dhe transportim te inerteve te gjeneruara ne kuader te procesit te rindertimit, Bashkia Vore | E kufizuar           | 9,771,389          | 9,612,958          |
| <b>Totali</b> |                                                                                                      |                      | <b>431,218,147</b> | <b>430,102,686</b> |
| 1             | Sistemim Asfaltim rrugeve Kodra e Miut dhe Rindertimi Fshatit Marqinet 2, Bashkia Vore               | E hapur              | 66,665,754         | 53,030,003         |

**Burimi:** Hartuar nga grupi i KLSH-së, sipas të dhënave të Bashkisë Vorë

Ulja nga fondi limit për procedurat e rindërtimit është 1,115,461 lekë pa TVSh ose 0.26%.

Në total, procedurat e vitit 2022 (përfshirë procedurat e rindërtimit) dhe procedura e paaudituar gjatë vitit 2021, kanë pasur vlerën e fondit limit 925,616,503 lekë pa TVSh dhe vlerën e kontratave 895,459,822 lekë pa TVSh. Ulja totale nga fondi limit për të gjitha procedurat e është 30,156,681 lekë pa TVSh ose 3.26%.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, nga 27 procedura me fond limit 925,616,503 lekë pa TVSh janë vlerësuar për auditim 6 procedura me fond limit 870,118,598 lekë pa TVSh ose 94% e fondit limit dhe vlerë të kontratave 844,140,879 lekë pa TVSh, nga ku janë konstatuar shkelje të LPP dhe akteve nënligjore në të gjitha procedurat e audituara, konkretisht: në 2 procedura ka pasur mbivlerësim të fondit limit, me pasoja negative në buxhetin e Bashkisë Vorë, në të gjitha procedurat e audituara, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës dhe në 5 procedura (me përjashtim të procedurës “me negociim pa shpallje” për pastrimin emergjent), OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 2, neni 77, pika 4, neni 82, pika 2 dhe pika 5, germa a), neni 89, pika 1, neni 92, pika 3, neni 98, pika 1, germa a) dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pikat 1 dhe 3, neni 74, pika 3, germa gj), neni 79, pika 3 dhe neni 82, pika 2.

Në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatuan probleme në lidhje me protokollimin e procesverbaleve, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, nenet 12, 14 dhe 18.

Në procedurat e prokurimit me objekt “*Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë*” dhe “*Shërbimi i pastrimit të mbeturinave, emergjenca 90 ditë*”, u konstatua se llogaritja e fondit limit është bërë në kundërshtim me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve*”, pika 1 “*Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes*”, duke mos aplikuar formulën përkatëse për llogaritjen e banorëve rezidentë. Gjithashtu, nga Bashkia Vorë nuk është bërë asnjë studim, në bazë të së cilit të mos merrej në konsideratë formula e dhënë në VKM-në nr. 319, datë 31.05.2018. Nga grupi i auditimit u konstatua se edhe zërat e tjerë të preventivit janë rritur në mënyrë fiktive, si p.sh. larja e rrugëve ditën dhe natën jashtë qendrave të banuara, larja e konteinerëve me pajisje të posaçme, mbivendosja e pastrimit të vend-grumbullimit të mbeturinave, etj.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat d) dhe dh), neni 3 “*Parime të përgjithshme*”, pikat 1 dhe 2, neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”, pika 3, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, neni 98 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2, neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, paragrafi i fundit, VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinitorit të projektit dhe të koordinitorit për realizimin e punimeve*”, pika 5, VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve*”, pika 1 “*Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes*”, etj.

**Shkaku:** Mosvlerësimi i drejtë i kriterëve, kriterë jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kriterëve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

**Ndikimi/Efekti:** Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST për vlerën totale të fondit limit 870,118,598 lekë pa TVSh ose 94% e fondit limit dhe vlerë të kontratave 844,140,879 lekë pa TVSh.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mirëtrajnuar, si dhe të përdoren eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Vorë dhe

jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

**2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.**

| <b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë”</b> |                                                                                                                                       |                                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 3639 datë 04.07.2022                                                                               | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 3639, datë 04.07.2022                                                                  | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 3639/1, datë 04.07.2022                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E hapur, shërbime, mbi kufirin e lartë monetar”                                       | 1. A.I., Kryetar<br>2. A.P., Anëtar<br>3. G.D., Anëtar                                                                                | 1. T.F., Kryetar<br>2. A.M., Anëtar<br>3. E.D., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>273,460,221 lekë                                                                                   | 6. Oferta fituese: OE “A.I.G.C.” shpk me ofertë<br>266,880,371 lekë pa tvsh, me kontratë nr. 21/2,<br>datë 06.01.2023, me afat 3 vite | 7. Diferenca me fondin limit:<br>6,579,851 lekë pa tvsh                                                   |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>Data e zhvillimit: 04.08.2022                                                                 | 9. Burimi Financimit: Buxheti Bashkise                                                                                                | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 5 OE<br>b) Skualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 2 OE |
| 11. Ankimime AK:<br>“A.I.G.C.” datë: 24.08.2022<br>“R.” date: 25.08.2022                                                       | 12. Përgjigje ankesës nga AK:<br>Datë: 03.10.2022<br>Datë: 05.10.2022                                                                 | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:<br>Vendim nr. 1093/2022 datë:<br>10.11.2022                                |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike:**

Me shkresën nr. 3547 prot., datë 29.06.2022, nga Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Shërbimeve të Infrastrukturës në Bashkinë Vorë është kërkuar fillimi i procedurës së prokurimit për objektin “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë”. Në kërkesë janë bashkëlidhur Specifikimet Teknike në gjuhën shqipe dhe angleze, meqënëse vlera e fondit limit është mbi kufirin e lartë monetar për shërbimet.

Me urdhërin nr. 3547/1, datë 29.06.2022 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike”, është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga R.M., kryetar, me detyrë Drejtor në DTTV, A.K., anëtar, me detyrë Përgjegjës në DMMI dhe E.S., anëtar, me detyrë specialist në DMMI.

Në procesverbalin për hartimin e fondit limit dhe specifikimet teknike, thuhet se llogaritja e kostos për shërbimin e pastrimit është bërë sipas VKM-së nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

Me procesverbalin nr. 3547/2, datë 29.06.2022, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ka specifikuar zërat dhe vlerat si më poshtë:

| <b>Nr.</b>    | <b>Emërtimi i shërbimit</b>                                                | <b>Vlera</b>      |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| 1             | Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe te tregjeve          | 43,579,168        |
| 2             | Larja dhe Dizinfektimi i konteniereve                                      | 6,871,059         |
| 3             | Mirëmbajtja e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te | 25,409,318        |
| 4             | Fshirja e rugeve dhe trotuarve me krahe                                    | 8,708,688         |
| 5             | Larja e rugeve ditën njehere ne dite (parashikuar per 10 muaj te vitit)    | 4,443,024         |
| 6             | Larja e rugeve naten njehere ne dite (parashikuar per 8 muaj te vitit)     | 2,142,150         |
| <b>Totali</b> |                                                                            | <b>91,153,407</b> |

Nga krahasimi i zërave në tabelën e mësipërme, me përcaktimet në VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, u konstatua se mënyra e hartimit të fondit limit për këtë procedurë prokurimi, nuk përputhet me përcaktimet me pikën 1 “Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes” të VKM-së në fjalë.

Sa më sipër, asnjë nga elementet në bazë të së cilëve është përlllogaritur fondi limit, nuk është sipas kërkesave ligjore.

**Në lidhje me Specifikimet Teknike, u konstatua se:**

Në ST, grupi i punës është shprehur se “Bashkia Vorë ka një popullsi prej 39,069 banorë”. Ky përcaktim është bërë në bazë të regjistrit të gjendjes civile, pa marrë në konsideratë VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pikën 1.1., ku përcaktohet formula e llogaritjes së numrit të banorëve rezidentë, si elementi kryesor për llogaritjen e sasisë së mbeturinave.

Sipas kësaj formule, (Banorë rezidentë aktivë = [Census + (Regjistri i gjendjes civile – Census) \* 30%]), popullsia e cila duhet të merrej për bazë për vitin 2022, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit, për prokurimin me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë”, duhet të ishte 29,956 banorë dhe jo 39,000, sa është marrë për bazë nga grupi i punës.

Rrjedhimisht, duke ndjekur të njëjtën logjikë, sasia e mbeturinave do të ishte 30 ton në ditë dhe jo 39, ndërsa numri i konteinerëve duhet të ishte 257 konteinerë/kazanë. Pra, shoqëria e pastrimit duhet të përpunonte 257 konteinerë/kazanë dhe jo 334, sa është përcaktuar në Specifikimet Teknike dhe në preventiv.

**Zëri nr. 1,** “Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe të tregjeve”, duhej të ishte llogaritur:  $257 \text{ kazanë} * 357.47 \text{ çmimi/njësi} * 365 \text{ ditë në vit} = 33,532,473 \text{ lekë}$  dhe jo 43,579,168 lekë, sa është sipas preventivit, duke shkaktuar një mbivlerësim të preventivit për 10,046,695 lekë në vit, në total 30,140,085 lekë, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik.

**Zëri nr. 2,** “Larja dhe Dizinfektimi i konteniereve”, nuk parashikohet në VKM-në nr. 319 dhe krahas kësaj, nga AK Bashkia Vorë nuk duhet të ishte kërkuar domosdoshmërisht mënyra e larjes me automjete të posaçme, ndërkohë që mund të ishin studiuar edhe alternativa të tjera më ekonomike. Ky zë i preventivit nuk është i argumentuar siç duhet në ST.

**Zëri nr. 3,** “Mirembajtja e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe të”, është i mbivendosur, pasi pastrimi i vendgrumbullimit të mbeturinave është pjesë e pastrimit të përgjithshëm të rrugëve dhe trotuareve, po ashtu edhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore. Largimi i mbetjeve ndërtimore dhe mbeturinave nga bujqësia nuk është pjesë e largimit të mbeturinave shtëpiake apo nga biznesi dhe nuk kryhet si pjesë e pastrimit të përditshëm. Ndërtimet, bujqësia, blegtoaria dhe mbetjet prej tyre trajtohen me legjislacion dhe procedura të posaçme, është detyrim i personave të cilët i shkaktojnë dhe nga pushteti vendor trajtohen nëpërmjet ndërmarrjes të mirëmbajtjes së rrugëve ose shërbimeve publike. Sa më sipër, ky zë është i paargumentuar dhe i mbivlerësuar, përveç nënçerit për desinfektimin e vendgrumbullimit të mbeturinave.

**Zëri nr. 4,** “Fshirja e rrugeve dhe trotuarve me krahe”, nuk është llogaritur bazuar në metodologjinë përkatëse, pasi nuk mund dhe nuk duhet që të bëhet çdo ditë fshirja me krahë e të gjithë sipërfaqes së rrugëve dhe trotuareve, përfshirë rrugët lidhëse ndërmjet qendrave të banuara. Nga AK mund të kërkohej pastrimi i përditshëm vetëm në ato rrugë të cilat janë më të frekuentuara dhe rrjedhimisht kanë riskun e ngarkesës më të shpeshtë me mbeturina. Sa më sipër, ky zë është i paargumentuar dhe i mbivlerësuar për pjesën e rrugëve lidhëse ndërmjet qendrave të banuara.

**Zëri nr. 5,** “*Larja e rrugëve ditën njëherë në ditë (parashikuar për 10 muaj të vitit)*”, nuk është llogaritur bazuar në metodologjinë përkatëse, pasi nuk mund dhe nuk duhet që të bëhet çdo ditë fshirja me krahë e të gjithë sipërfaqes së rrugëve dhe trotuareve.

**Zëri nr. 6,** “*Larja e rrugëve natën njëherë në ditë (parashikuar për 8 muaj të vitit)*”, nuk është llogaritur bazuar në metodologjinë përkatëse, pasi nuk mund dhe nuk duhet që të bëhet çdo ditë fshirja me krahë e të gjithë sipërfaqes së rrugëve dhe trotuareve.

Në lidhje me zërat 5 dhe 6, konstatohet se nga AK mund të kërkohet pastrimi i përditshëm vetëm në ato rrugë të cilat janë më të frekuentuara dhe rrjedhimisht kanë riskun e ngarkesës më të shpeshtë me mbeturina. Nuk shpjegohet dhe nuk është e mbështetur në asnjë metodologji larja dhe pastrimi i rrugëve ndërmjet qendrave të banuara. Sa më sipër, ky zë është i paargumentuar dhe i mbivlerësuar për pjesën e rrugëve lidhëse ndërmjet qendrave të banuara. Në pikën 1.3., është përcaktuar që mbeturinat do të grumbullohen një herë në ditë. Një pjesë e konsiderueshme e Bashkisë Vorë është zonë rurale, (pavarësisht se në ST është konsideruar si zonë me karakter urban) dhe nga grupi i auditimit nuk u konstatua të ishte realizuar asnjë matje në terren apo të jenë përdorur të dhënat nga studimet zyrtare si Strategjia Kombëtare e Mbetjeve apo Plani Kombëtar i Mbetjeve.

Për sa më sipër, nuk është argumentuar nevoja e largimit të mbeturinave çdo ditë. Meqenëse një pjesë e territorit ka biznese dhe është e urbanizuar, nga grupi i punës duhet të ishte specifikuar dhe ndarë se në cilat zona mbeturinat duhet të largoheshin një herë në ditë dhe në cilat zona një herë në dy apo në tre ditë, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve*”, pika 1.1., Tabela 1 [TC1], rreshti K.

Po kështu edhe lloji dhe numri i kamionëve të kërkuar nuk është i argumentuar sipas kësaj VKM-je. Në ST është kërkuar një kamion rezervë, i cili sipas VKM-së 319, datë 31.5.2018, pika 1.2., Tabela 2 [TC2], rreshti D, rekomandohet që të kërkohet vetëm për NJQV me një popullsi mbi 50,000 banorë.

Për hartimin e fondit limit jo në përputhje me përcaktimet ligjore/nënligjore, mban përgjegjësi komisioni i përcaktimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga: R.M., kryetar, me detyrë Drejtor në DTTV, A.K., anëtar, me detyrë Përgjegjës në DMMI dhe E.S., anëtar, me detyrë specialist në DMMI.

#### **Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Dokumentacioni në dosje nuk është numërtuar, nuk është inventarizuar dhe procesverbalet janë të paprotokolluara, në mospërputhje me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

- Procesverbali për hartimin e Specifikimeve Teknike mban datën 04.07.2022 dhe është nënshkruar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, A.I., A.P. dhe G.D., në zbatim të urdhërit nr. 3547/1, datë 29.06.2022 “*Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike*”.

- Në nënpikën 2.2.1., është kërkuar që OE të paraqesin “*...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontrates...*”

Kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa a.

- Në nënpikën 2.3.1., kërkohet që OE të ketë “*....dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës...*”.

Ky kriter është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”, pika 3.

- Në nënpikën 2.3.7., kërkohet që OE të ketë “...të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” ...të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit....”.

Kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve”, pika 5.

- Në nënpikën 2.3.9., kërkohet që OE të ketë “...per produktin dezinfektues te kontenieneve duhet te paraqese autorizim prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, shoqëruar me kontrate ose dokument angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit....”.

Duke pasur parasysh që sasia e detergjentit të nevojshëm nuk është e konsiderueshme dhe mund të gjendet në çdo pikë shitjeje detergjentësh, me pakicë apo shumicë, nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet si selektive dhe ndikon në përzgjedhjen e OE fitues.

Sa më sipër është në kundërshtim me LPP, neni 2 “Qëllimi”, pika d) dhe neni 3, “Parime të përgjithshme”, pika 2.

- Në nënpikën 2.3.10., kërkohet që OE të disponojë “....Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se 3 (tre) copë. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 deri 4 ton jo më pak se 1 (një) copë; Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 0.5 deri 1.5 ton jo më pak se 1 (një) copë; Makinë transportuese kamioncine per transportin e mbetjeve te vëllimshme me kapacitet mbajtës 2 der 4 ton veteshkarkuese jo me pak se 1 (një) copë; Makinë teknologjike me paisje te vecante per larjen e kontenieneve 1 (një) copë; Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës 7 deri ne 8 ton, jo më pak se 1 (një) copë;....”.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pika 1.2., “Përllogaritja e nevojës për investime kapitale [blloku 2]”, paragrafi “Tipi i kamionit për grumbullimin e mbetjeve (tonë) dhe çmimi (lekë).”.

Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pikat 1 dhe 2.

Përgjegjësia për vendosjen e kriterëve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe Komisionit për hartimin e Fondit limit dhe Specifikimeve Teknike.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me nr. REF-35239-07-04-2022 “Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë” me fond limit 273,460,221 lekë pa TVSh (91,153,407 lekë pa TVSh për 1 vit), me kohëzgjatje të kontratës 3 vjet ose 36 muaj, u konstatua se:

Në datën 04.08.2022 janë hapur ofertat, nga ku është konstatuar pjesëmarrja e pesë OE ofertues, sipas tabelës më poshtë. Procesverbali i hapjes së ofertave është i paprotokolluar.

| Nr. | OE pjesmarrës | O. Ekonomike   | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-----|---------------|----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | A.I.G.C.      | 266,880,370.50 | Skualifikuar nga AK, pasi:<br>1. Drejtuesi Teknik i deklaruar Zj. E.C. është deklaruar Drejtuese Teknike edhe në Procedurën me Objekt “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë” sipas Vendimit të KPP 474/2022 dhe sipas Buletinit Javor seksioni i Kontratave të Nënshkruara. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike...<br>2. Në bazë të vetë deklarimit të Operatorit Ekonomik, KVO ka bërë verifikimet në adresën e Deklaruar dhe mjetet e deklaruar nuk ndodheshin në atë Adresë. Nëpërmjet deklarimit të datës 04.08.2022 të paraqitur ky Operator ka deklaruar se mjetet e paraqitura ndodheshin në adresën, Rr. “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga. Për verifikimin e mësipërm është mbajtur edhe Proces Verballi përkatës nga ana e KVO. |

|   |                     |                |                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---|---------------------|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   |                     |                | 3. <i>Mjeti Makinë teknologjike</i> me paisje të vecantë për larjen e kontenierëve e deklaruar nga Operatori Ekonomik nuk është sipas specifikimeve të kërkuara në DST. Nga fotot e paraqitura në SPE ky mjet nuk ka paisjen e ngritjes dhe larjes së kazanëve.         |
| 2 | B.O.E C. & A.E.K&Co | 239,981,138    | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>“Operatori Ekonomik skualifikohet pasi nuk ka mundur të plotësojë pikën 2.3.10 sipas kriterëve të vecanta në DST.<br>Konkretisht: Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për disponimin e mjeteve si Leje qarkullimi etj. |
| 3 | E.K.                | 273,395,778.6  | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për disponimin e mjeteve si Leje qarkullimi etj.<br>Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për dezinfektimin e kontenierëve.                                                         |
| 4 | B.O.E K. & V.R.     | 270,866,703    | <b>Kualifikuar</b>                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 5 | R.                  | 240,582,685.20 | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për disponimin e mjeteve si Leje qarkullimi etj.                                                                                                                                   |

Në datën 15.08.2022, nga KVO është bërë verifikimi i automjeteve të deklaruar për BOE K. & V.R. në Gramsh dhe në Fushë Kuqe, ku janë mbajtur procesverbalet përkatëse të paprotokolluara, nëpërmjet të cilave mjetet janë konstatuar në përputhje me kërkesat në DT. Në datën 16.08.2022, nga KVO është bërë verifikimi i automjeteve të deklaruar për OE A.I.G.C. në Tiranë, ku është mbajtur procesverbali përkatës i paprotokolluar, ku KVO shprehet se në adresën e deklaruar nuk u gjenden mjetet e deklaruar.

Në datën 16.08.2022 është mbajtur procesverbal (i paprotokolluar), për klasifikimin e ofertave, nëpërmjet të cilit është shpallur fitues BOE K. & V.R., për vlerën e ofruar 270,866,703 lekë pa TVSh. Publikimi i fituesit është bërë në buletin nr. 114, datë 22.08.2022, faqe 237-239/448. Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi qëndron skualifikimi i B.O.E C. & A.E.K & Co, me ofertën ekonomike në vlerën 239,981,138 lekë pa TVSh, pasi nuk ka pasur në dispozicion mjetet e kërkuara, por ka pretenduar se do t’i blinte nëq shpallje fitues. Ofertat e tjera duhet të ishin kualifikuar, pasi i plotësonin Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9.

Nga auditimi, u konstatua se nga KVO nuk është vepruar në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim, pasi verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në formularin e vetëdeklarimit dhe verifikimi në terren duhet të kishte filluar me O.E R., i cili ka dhënë ofertën ekonomikisht më të favorshme, në vlerën 240,582,685.20 lekë pa TVSh dhe pasi të ftohej për të lidhur kontratën, nëse ky ofertues do të kishte pasur mangësi në dokumentacion ose mospërputhje me deklaratimet e bëra në Formularin e vetëdeklarimit, duhet të vazhdohej me ofertuesin e rradhës, i cili kishte ofertën e dytë ekonomikisht më të favorshme. Skualifikimi pa të drejtë i OE me oferta ekonomikisht më të favorshme dhe kualifikimi i OE A.I.G.C., i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorim të fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën 266,880,371 lekë.

Duke skualifikuar OE me ofertat ekonomike më të favorshme dhe duke kualifikuar OE me vlerat më të larta dhe duke shmangur verifikimin e dokumentacionit dhe duke mos u dhënë të drejtën ligjore të gjithë OE të paraqesin sqarimet përkatëse sipas vetëdeklarimeve të kryera, AK ka vepruar në kundërshtim me Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, si më poshtë:

Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh); Neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5; Neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; Neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KVO, i përbërë nga T.F., Kryetar; A.M., Anëtar dhe E.D., Anëtar.

**Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave:**

Në datën 24.08.2022, nga OE A.I.G.C. është paraqitur në AK ankesa e protokolluar me nr. 4538, nëpërmjet së cilës OE ankohet për skualifikimin dhe paraqet bazën ligjore së bashku me argumentet mbështetëse.

Në datën 24.08.2022, nga OE R. është paraqitur në AK një ankesë e nënshkruar në formë elektronike, nëpërmjet së cilës OE ankohet për skualifikimin dhe paraqet bazën ligjore së bashku me argumentet mbështetëse.

Me urdhërin nr. 161, me nr. 4807/1 prot., datë 31.08.2022, nga titullari i AK është krijuar komisioni për shqyrtimin e ankesave, i përbërë nga D.G., kryetare; D.S. dhe A.S. anëtarë.

Me vendimin e titullarit nr. 4807, datë 31.08.2022, është pezulluar procedura e prokurimit për shqyrtimin e ankesave.

Me shkresën nr. 4807/2 prot., datë 03.10.2022, nga KShA është kthyer përgjigje për ankesën e OE A.I.G.C., e cila është refuzuar.

Me shkresën nr. 5584 prot., datë 05.10.2022, nga KShA është kthyer përgjigje për ankesën e OE R., e cila është refuzuar.

Nga auditimi, bazuar në LPP dhe aktet nënligjore të cituara më sipër, u konstatua se KShA i ka refuzuar pa të drejtë ankesat e OE A.I.G.C. ShPK dhe R. ShPK, pavarësisht se ankesat e këtyre OE nuk janë paraqitur në kontekstin e përcaktimeve specifike për Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KShA, e përbërë nga D.G., kryetare; D.S., Anëtare dhe A.S. Anëtar.

**Rivlerësimi i ofertave:**

Në datën 14.11.2022, me nr. 6483, është protokolluar në Bashkinë Vorë vendimi i KPP nr. 1093/2022, me nr. 1851/5 Prot., i dërguar në Bashkinë Vorë me shkresën nr. 1851/6 Prot., datë 10.11.2022, ku KPP ka vendosur rrëzimin e vendimit të KVO-së në Bashkinë Vorë për skualifikimin e OE A.I.G.C. ShPK dhe R. ShPK dhe kualifikimin e tyre.

Nga titullari i AK Bashkia Vorë ka dalë Urdhëri nr. 204, me nr 6539 prot., datë 15.11.2022 “Për zbatimin e vendimit të KPP”, drejtuar KVO-së.

Me shkresën nr. 6738 prot., datë 23.11.2022, nga Bashkia Vorë i është kërkuar KPP-së heqja e pezullimit të procedurës në SPE.

Me shkresën nr. 7082 prot., datë 12.12.2022, nga KVO i është kërkuar OE R. njoftim për verifikimin e mjeteve të deklaruara në vendndodhje.

Nga verifikimi në librin e dorëzimit të shkresave, u konstatua se njoftimi në fjalë i është dërguar OE R. me postë në datën 13.12.2022.

Kjo shkresë nuk është e firmosur nga titullari dhe është e pavulosur, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale për arkivat”, neni 12, dhe neni 14.

Përgjegjësia për protokollimin pa nënshkrimin e titullarit dhe pa vulën e institucionit është e punonjësës së protokollit.

Në datën 19.12.2022, nga KVO është mbajtur procesverbal i paprotokolluar për verifikimin në terren të mjeteve të deklaruara nga OE R., ku KVO shprehet se “nuk patën mundësi të hyjnë në ambientet e këtij OE”.

Në datën 20.12.2022, nga KVO është mbajtur procesverbal i paprotokolluar për verifikimin në terren të mjeteve të deklaruara nga OE A.I.G.C., ku KVO shprehet se “mjetet e deklaruara ndodheshin në adresën përkatëse”.

Në datën 20.12.2022, është mbajtur procesverbal për rimarrje vendimi për klasifikimin e ofertave, ku KVO ka skualifikuar OE, klasifikimi i së cilës është sipas tabelës më poshtë:

| Nr. | OE pjesmarrës | O. Ekonomike   | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës |
|-----|---------------|----------------|-----------------------------------------------------------------|
| 1   | A.I.G.C.      | 266,880,370.50 | Kualifikuar dhe shpallur fitues                                 |

|   |                     |                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|---|---------------------|----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2 | B.O.E C. & A.E.K&Co | 239,981,138    | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>“Operatori Ekonomik skualifikohet pasi nuk ka mundur te plotesoj piken 2.3.10 sipas kriterëve te vecanta ne DST.<br>Konkretisht: Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per disponimin e mjeteve si Leje qarkullimi etj.                                                                                   |
| 3 | E.K.                | 273,395,778.6  | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per disponimin e mjeteve si Leje qarkullimi etj.<br>Nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi per dezinfektimin e konteniereve.                                                                                                                                          |
| 4 | B.O.E K. & V.R.     | 270,866,703    | <b>Kualifikuar</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 5 | R.                  | 240,582,685.20 | <b>Skualifikuar pasi:</b><br>“Pas njoftimit te bere ne SPE per verifikimin e mjeteve te Operatorit Ekonomik ne mbeshtetje te kushteve te vecanta te DST, KVO ka ushtruar ne adresat e deklaruar nga Operatori Ekonomik dhe e ka pasur te pamundur hyrjen ne kantieret perkatese. Duke mos verifikuar mjetet e deklaruar KVO vendosi refuzimin e ofertes. |

Me shkresën nr. 3639/6, datë 22.12.2022, është formulari i njoftimit të fituesit, ku është shpallur fitues OE A.I.G.C..

Duke pasur parasysh se Vendimet e KPP-së janë të natyrës përgjithësuese, si dhe duke pasur parasysh që të gjithë OE pjesëmarrës janë skualifikuar për të njëjtën arsye si OE ankesat e të cilëve ka marrë në konsideratë KPP-ja, nga ana e KVO-së duhet të ishte bërë rivlerësimi i të gjitha ofertave të paraqitura, duke i kualifikuar të gjitha dhe më pas të ftohej B.O.E C. & A.E.K & Co, i cili kishte ofertën ekonomikisht më të favorshme dhe pasi të verifikohet dokumentacioni i këtij ofertuesi, nqs i plotësonte të gjitha kriteret të shpallë fitues ose të skualifikohet dhe të vazhdohej me OE R., i cili ka paraqitur ofertën e dytë ekonomikisht më të favorshme, e kështu me rradhë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE A.I.G.C., u konstatua se:

- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës për vetëdeklarimet, në lidhje me Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit, në mospërputhje me LPP, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6;
- Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2. të DT, ku përcaktohet se OE “*duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB për grumbullim dhe transportim të mjetëve urbane (kodi III.2.B)*”, pasi licenca e paraqitur është për “*Transportim të mjetëve jo të rrezikshme*”;
- Ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike vetëm për dy kontrata, ndërkohë që nga verifikimi në internet<sup>10</sup>, u konstatu se ushtron veprimtari në disa bashki;
- Nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore, në kundërshtim me LPP, neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2;
- Certifikata “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë*” e punonjës Enkeleda Celi, nuk është nga shoqëri e akredituar për trajnimin dhe certifikimin e personelit.
- Autorizimi dhe certifikata nga prodhuesi i kimikateve për desinfektim nuk janë origjinale apo kopje të noterizuara. Vetëm përkthimi është i noterizuar, por jo dokumenti, në kundërshtim me LPP, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pika 5, gerrat a dhe b.

#### **Konkluzion:**

Sa më sipër, konstatohet se nga KVO është vepruar në mospërputhje me LPP, në të njëjtën mënyrë me vlerësimin e ofertave në procesverbalin e datës 16.08.2022.

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9 dhe më pas të

<sup>10</sup> [https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf\\_id/](https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/)

vazhdohet me ftesat për lidhjen e kontratës, duke filluar nga OE me ofertën më të ulët, ku t'u kërkohej OE të paraqesnin dokumentacionin sipas vetëdeklarimeve.

Nga auditimi, u konstatua se nga KVO nuk është vepruar në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim, pasi verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në formularin e vetëdeklarimit dhe verifikimi në terren duhet të kishte filluar me O.E R., i cili ka dhënë ofertën ekonomikisht më të favorshme, në vlerën 240,582,685.20 lekë pa TVSh dhe pasi të ftohej për të lidhur kontratën, nëse ky ofertues do të kishte pasur mangësi në dokumentacion ose mospërputhje me deklaratimet e bëra në Formularin e vetëdeklarimit, duhet të vazhdohej me ofertuesin e rradhës, i cili kishte ofertën e dytë ekonomikisht më të favorshme.

Skualifikimi pa të drejtë i OE me oferta ekonomikisht më të favorshme dhe kualifikimi i OE A.I.G.C. me ofertën e paraqitur në vlerën 266,880,370.50 lekë pa TVSh, i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorim të fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 266,880,371 lekë.

Sa më sipër, grupi i auditimit konkludon se kjo procedurë auditimi duhet të ishte anuluar, të rishikohej preventivi, kriteret e kualifikimit, vlerësimi i ofertave dhe të rishpallej për tenderim. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1 dhe neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KVO, i përbërë nga T.F., Kryetar; A.M., Anëtar dhe E.D., Anëtar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **266,880,371 lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

| <b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit të mbeturinave, emergjenca 90 ditë”</b> |                                                                                                                       |                                                                                                           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 4981, datë 08.09.2022                                                                   | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 4981, datë 08.09.2022                                                  | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 4981/1, datë 08.09.2022                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E Kufizuar”                                                                | 1. A.I., Kryetar<br>2. A.P., Anëtar<br>3. G.D., Anëtar                                                                | 1. T.F., Kryetar<br>2. A.M., Anëtar<br>3. E.D., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>22,966,804 lekë                                                                         | 6. Oferta fituese: OE “K. ShPK” me ofertë<br>22,330,674 lekë pa tvsh, me kontratë datë<br>16.09.2022, me afat 90 ditë | 7. Diferenca me fondin limit:<br>110,944 lekë pa tvsh                                                     |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>12.09.2022                                                                         | 9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkisë                                                                              | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 1 OE<br>b) Skualifikuar 1 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK: Jo                                                                                                 | 12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo                                                                                      | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:                                                                            |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike:**

Me shkresën nr. 4981 prot., datë 11.08.2022, nga Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Shërbimeve të Infrastrukturës në Bashkinë Vorë është kërkuar fillimi i procedurës së prokurimit për pastrimin dhe largimin e mbeturinave për Bashkinë Vorë, për nevoja emergjente.

Me nr. 4981/1 prot., datë 30.08.2022, është mbajtur PV për argumentimin e nevojës për kryerjen e këtij prokurimi.

Me urdhërin nr. 4981/3, datë 02.09.2022 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike”, është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga S.B., kryetar, me detyrë Drejtor në DMF, A.K., anëtar, me detyrë Përgjegjës në DMMI dhe E.S., anëtar, me detyrë specialist në DMMI.

Me nr. 4981/4 prot., datë 02.09.2022, është mbajtur PV nga komisioni për hartimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, nga ku konstatohet e njëjta problematikë në përlllogaritje dhe në zërat e punëve, si për rastin e mësipërm.

Në procesverbalin për hartimin e fondit limit dhe specifikimet teknike, thuhet se llogaritja e kostos për shërbimin e pastrimit është bërë sipas VKM-së nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.

**Zëri nr. 1,** “Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe te tregjeve”, duhej të ishte llogaritur:  $257 \text{ kazanë} * 357.47 \text{ çmimi/njësi} * 90 \text{ ditë} = 8,268,281 \text{ lekë}$  dhe jo 10,745,548 lekë, sa është sipas preventivit, duke shkaktuar një mbivlerësim të preventivit për 2,477,267 lekë, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik.

Me procesverbalin nr. 3547/2, datë 29.06.2022, komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ka specifikuar zërat dhe vlerat si më poshtë:

| Nr.           | Emërtimi i shërbimit                                                       | Vlera             |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| 1             | Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe te tregjeve          | 10,745,548        |
| 2             | Larja dhe Dizinfektimi i konteniereve                                      | 1,694,234         |
| 3             | Mirëmbajtja e VGM gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te | 6,265,311         |
| 4             | Fshirja e rugeve dhe trotuarve me krahe                                    | 2,147,348         |
| 5             | Larja e rugeve ditën njëhere në ditë (parashikuar për 10 muaj të vitit)    | 1,311,056         |
| 6             | Larja e rugeve natën njëhere në ditë (parashikuar për 8 muaj të vitit)     | 803,306           |
| <b>Totali</b> |                                                                            | <b>22,966,804</b> |

Për hartimin e fondit limit jo në përputhje me përcaktimet ligjore/nënligjore, mban përgjegjësi komisioni i përcaktimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga: S.B., kryetar, me detyrë Drejtor në DMF, A.K., anëtar, me detyrë Përgjegjës në DMMI dhe E.S., anëtar, me detyrë specialist në DMMI.

**Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Procesverbalet janë të paprotokolluara, në mospërputhje me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

- Procesverbali për hartimin e Specifikimeve Teknike mban datën 08.09.2022 dhe është nënshkruar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, A.I., A.P. dhe G.D., në zbatim të urdhërit nr. 4981/3, datë 02.09.2022 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike”.

- Në nënpikën 2.2.1., është kërkuar që OE të paraqesin “...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontrates...”

Kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa a.

- Në nënpikën 2.3.1., kërkohet që OE të ketë “....dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates , në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës...”.

Ky kriter është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3.

- Në nënpikën 2.3.3., kërkohet që OE të disponojë “....Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se 3 (tre) copë. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 deri 4 ton jo më pak se 1 (nje) copë; Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 0.5 deri 1.5 ton jo më pak se 1 (nje) copë; Makinë transportuese kamioncine per transportin e mbetjeve te vellisshme me kapacitet mbajtes 2 der 4 ton veteshkarkuese jo me pak se 1 (një) copë; Makinë teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve 1 (nje) copë; Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes 7 deri ne 8 ton, jo më pak se 1 (një) copë;....”.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pika 1.2., “Përllogaritja e nevojës për investime kapitale [blloku 2]”, paragrafi “Tipi i kamionit për grumbullimin e mbetjeve (tonë) dhe çmimi (lekë).”.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pikat 1 dhe 2.

Përgjegjësia për vendosjen e kritereve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe Komisionit për hartimin e Fondit limit dhe Specifikimeve Teknike.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbimi i pastrimit të mbeturinave emergjencia 90 ditë” me fond limit 22,966,804 lekë pa TVSh, me kohëzgjatje të kontratës 90 ditë, u konstatua se:

Me PV nr. 4981/2, datë 08.09.2022, është argumentuar për zgjedhja e OE për dërgimin e ftesave në SME.

Në SME, nga AK Bashkia Vorë i është dërguar ftesë 5 OE, si më poshtë:

L.; A.G.C.; D.; K. dhe E.K..

Me PV datë 12.09.2022, pa numër protokoll janë hapur ofertat, nga ku është konstatuar pjesëmarrja e një OE ofertues, K. Shpk, në vlerën 22,330,674 lekë pa TVSh.

Raporti përmbledhë është me nr. 4981/3 prot., datë 12.09.2022, nga ku konstatohet se fitues është shpallur OE K. Shpk, me ofertë në vlerën 22,330,674 lekë pa TVSh.

Kontrata është lidhur me nr. 4981/6, datë 16.09.2022, për periudhën 90 ditë.

Dokumentacioni teknik i OE K. SHPK nuk është ngarkuar në SPE.

Duke qenë se OE K. ka qenë shoqëria e cila ka kryer edhe më përpara pastrimin në Bashkinë Vorë dhe dokumentacioni i këtij OE është i njohur nga personeli i Bashkisë Vorë, duke pasur parasysh kriteret minimale të vendosura dhe përcaktimin në LPP, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 3.

Nga grupi i auditimit nuk u auditua dokumentacioni i OE K. ShPK për këtë procedurë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **22,330,674 lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

| <b>3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindertimi i shkolles se mesme Isa Boletini, Bashkia Vore”</b> |                                                                                                                                                    |                                                                                                           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 6885, datë 01.12.2022                                                                     | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 6885, datë 01.12.2022                                                                               | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 6885/1, datë 01.12.2022                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E kufizuar”                                                                  | 1. A.I., Kryetar<br>2. A.P., Anëtar<br>3. G.D., Anëtar                                                                                             | 1. T.F., Kryetar<br>2. A.M., Anëtar<br>3. E.D., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>279,218,916 lekë                                                                          | 6. Oferta fituese: OE “K.K.” me ofertë<br>279,000,000 lekë pa tvsh, me kontratë datë<br>16.01.2023, me afat 1 muaj projektim dhe 12<br>muaj zbatim | 7. Diferenca me fondin limit:<br>218,916 lekë pa tvsh                                                     |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>Faza 1: 12.12.2022<br>Faza 2: 06.01.2023                                             | 9. Burimi Financimit: Buxheti i shtetit                                                                                                            | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 5 OE<br>b) Skualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 2 OE |
| 11. Ankimime AK: Jo                                                                                                   | 12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo                                                                                                                   | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:                                                                            |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit:**

- Me urdhërin nr. 6850/1 prot., datë 30.11.2022, nga titullari i Bashkisë Vorë është ngritur Komisioni për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga A.K., me detyrë Përgjegjës në DMMI, kryetar; A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT dhe S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT, anëtarë.
- Nga verifikimi i projekt idesë të dorëzuar në AK, u konstatua se ky dokument është hartuar nga shoqëria E.S. ShPK.
- Me procesverbalin nr. 6850/2 prot., datë 30.11.2022, nga Komisioni për llogaritjen e fondit limit është përcaktuar vlera e investimit në shumën 272,281,410 lekë pa TVSH.
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKM-në nr. 500, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të një objekti arsimor në Bashkinë Vorë dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese”.
- Për llogaritjen e fondit limit nuk japet asnjë e dhënë në lidhje me metodologjinë e përdorur, llogaritjet, nevojën, etj., në mospërputhje me LPP, neni 34, “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, pikat 1, 3 dhe 6, si dhe Rregullat e PP, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”, pikat 1, 4 dhe 7.
- Me procesverbalin datë 01.12.2022, nga Njësia e prokurimit janë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.
- Në datën 07.12.2022, APP ka njoftuar AK Bashkia Vorë për ndryshimin e disa prej kriterëve të kualifikimit, pasi nuk janë të argumentuara dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të LPP.
- Me shkresën nr. 6885/3, datë 07.12.2022 është njoftuar ndryshimi i DT, pa bërë ndryshimin e afatit, në kundërshtim me LPP, neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit”, pika 2, paragrafi i tretë.
- Me shkresën datë 07.12.2022 është bërë ndryshimi i DT, pa bërë argumentet teknike sipas sugjerimit të APP-së.

Nga auditimi, u konstatua se procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk janë protokolluar, në mospërputhje me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

Përgjegjësia për hartimin e fondit limit është e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga A.K., me detyrë Përgjegjës në DMMI, kryetar; A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT dhe S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT, anëtarë.

#### **Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Në pikën 2.2.3., kërkohet që OE “*duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022....prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB*”. Ky kriter nuk i përmbush dispozitat e LPP dhe Rregullave të prokurimit publik, pasi AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2.

- Në nënpikën 2.3.1., gerrat a dhe b, kërkohet që OE të ketë “*....punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*” dhe “*punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*”.

Sa më sipër, duke e ndryshuar nga “*më e madhe*” në “*më e vogël*”, bie në kundërshtim literalisht të drejtpërdrejtë me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39, “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 5, gerrat a dhe b.

- Në nënpikën 2.3.3., është kërkuar që në licencën e projektimit të përfshihet kategoria “*Projektues Konstruktor, germa c) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se ky zë është specifik dhe nuk ka lidhje me natyrën e punës që prokurohet;

- Nuk është kërkuar disponimi i shoferëve apo manovratorëve, sipas listës së makinerive të kërkuara.

- Nga grupi i auditimit, nuk gjenden të argumentuara makineritë e mëposhtme:

- 2 copë kamionçina deri 2.5 ton, pasi edhe mjete me kapacitet më të madh mund të kryenin të njëjtat funksione dhe nuk ka pse të kërkohej në mënyrë specifike këto mjete;
- 3 copë betoniere 500 litra, pasi vëllimet e betonit janë të mëdha dhe për të arritur cilësinë dhe markën e nevojshme, betoni duhet të furnizohej i parapregatitur;
- 1 copë pajisje nivelimi betoni me laser me gjerësi shtrimi nga 1 deri në 2.4 m, pasi sipërfaqet janë shumë herë më të mëdha dhe kjo pajisje nuk është e mjaftueshme;
- 3 copë gazogjen dhe 2 copë elektrosaldatriçe, pasi nuk justifikohen me vëllimin e punimeve të parashikuara;
- 2 copë autobotë uji, të cilët nuk nevojiten, pasi nuk ka lagje rrugësh dhe trualli ko do të ndërtohet shkolla ka furnizim me ujë për nevojat e ndërtimit;
- 1 copë ekskavator me zinxhirë, pasi nuk ka terrene të vështira apo zona me lagështirë të madhe, të cilat do të bënin të pamundur ecjen e makinerive me goma.
- Nga grupi i auditimit, gjykohet e nevojshme se duhet të ishte kërkuar disponimi i një greideri me qëllim nivelimin e terrenit përpara fillimit të ndërtimit.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për vendosjen e kriterëve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe z. E.S., me detyrë Drejtor në DPKZHT, të cilët kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit për hartimin e projektit.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Në datën 12.12.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli në lidhje me Fazën 1, “Paraqitja e kërkesave dhe dokumentacionit nga OE”, si më poshtë:

1. BOE A.G. & N.C.2.;
2. BOE R.C. & U. & N. & S.L.S.;
3. K.K.;
4. S.;
5. E..

Në datën 23.12.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli për klasifikimin e ofertave, ku kualifikohen BOE R.C. & U. & N. & S.L.S. dhe OE K.K..

Për vlerësimin dhe arsyet e kualifikimit/skualifikimit të OE nuk është mbajtur PV i posaçëm, por të dhënat janë në sistemin SPE.

Me shkresën nr. 6885/5 datë 30.12.2022 është dërguar Ftesa për ofertë BOE R.C. & U. & N. & S.L.S. dhe OE K.K., të cilat janë kualifikuar në fazën e parë.

Me nr. 59 prot., datë 06.01.2023, ora 09:25, është dorëzuar oferta e OE K.K. në vlerën 279,000,000 lekë.

Me nr. 60 prot., datë 06.01.2023, ora 09:25, është dorëzuar oferta e BOE R.C. & U. & N. & S.L.S. në vlerën 279,150,000 lekë.

Me shkresën nr. 57/1 prot., datë 06.01.2022 është dokumentuar hapja e ofertave dhe me PV datë 09.01.2023 është njoftuar klasifikimi, ku është shpallur fituese oferta e OE K.K. në vlerën 279,000,000 lekë.

Me nr. 57/3 prot., datë 10.01.2023 nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, nga ku u konstatua se nuk është dhënë asnjë detaj në lidhje me vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e OE në Fazën 1.

Detajet e vlerësimit të dokumentacionit u audituan në SPE, nga ku u konstatua se vlerësimi i ofertuesve të sipërpërmendur është bërë sipas tabelës më poshtë:

| Nr. | OE pjesmarrës               | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-----|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | BOE A.G. & N.C. 2012        | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Mungon dokumentacioni provues për makinerite dhe pajisjet nga shoqëria N.C.<br>Mungon pajisja niveluese me laser për betonin                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 2   | BOE R.C. & U. & N. & S.L.S. | Kualifikuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 3   | K.K.                        | Kualifikuar dhe shpallur fitues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 4   | S.                          | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Nuk disponon mjet 3.5-5 ton sipas kriterëve të vecanta të DST.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 5   | E.                          | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Nuk disponon mjet 3.5-5 ton sipas kriterëve të vecanta të DST.<br>Operatori Ekonomik nuk ka mundur të paraqesë një vertetim se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike kjo në kundërshtim me Nenin 26 pika 6 të VKM 285 datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.<br>Vertetimi i paraqitur ka të paguar Muajin Shtator kur duhej muaji Tetor pasi është maturuar dhe ky muaj.<br>Nuk ka paraqitur paisje dhe makineri për të plotësuar piken 2.3.12 |

Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 99, “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”, germa b) dhe ç), si dhe Rregullat e PP, neni 84 “Raporti përmbledhës”, pika 2. Kontrata është lidhur me nr. 57/6 prot., datë 16.01.2023, me afat 1 muaj projektim dhe 12 muaj zbatim.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE K.K., u konstatua se:

- Në dokumentacionin e paraqitur, ndodhet licenca e projektimit dhe një deklaratë noteriale me shoqërinë I.D., e cila ka marrë përsipër projektimin. Nga verifikimi i licencës së projektimit, u konstatua se licenca e paraqitur nuk i plotëson kriteret, pasi mungon zëri “1. Projektues Arkitekt, b-Qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; **objekte arsimore**”. Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.
- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës për vetëdeklarimet, në lidhje me Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit, në mospërputhje me LPP, neni 82 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6;

- Nuk plotësohet nënpika 2.3.5. për disponimin e stafit inxhinierik, pasi kontratat e punës të një pjese të inxhinierëve janë me shoqërinë I.D. dhe jo me OE pjesëmarrës, siç kërkohet në DT. Këto licenca do të ishin të vlefshme në rastin e një BOE. Licenca e paraqitur për arkitektin nuk i plotëson kriteret e kërkuara në DT, në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, lidhja 4, ku kërkohet që arkitekti të jetë diplomuar para vitit 1971. Megjithatë në DT lejohet nënkontraktimi, nuk disponohet asnjë marrëveshje e tillë, sipas kriterëve të përcaktuara në LPP dhe DT, ku krahas të tjerave duhet të specifikohet edhe përqindja e nënkontraktimit. Gjithashtu, nuk ka as marrëveshje për BOE.

- Nga auditimi, u konstatua se OE “K.K.” ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për Bashkinë Tiranë, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Durrës dhe Krujë, ku gjatë vitit 2022 ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Durrës, me AK Autoritetin Portual Durrës, për tenderin me objekt “Zbatimi i projektit për zyrat modulare për agjensitë doganore”, i cili është zhvilluar në datën 12.07.2021, me afat 6 muaj<sup>11</sup>, por punimet kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2022 dhe në Bashkinë Krujë është shpallur fitues (BOE me OE B.C.) për objektin “Shembja e njësisë individuale të banimit të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve të dala prej tyre në Bashkinë Krujë, në kuadër të procesit të rindërtimit”, i cili ka pasur afatin e punimeve 150 ditë dhe në kohën e këtij prokurimi nuk është përfunduar.

- Deklarata datë 12.12.2022, e nënshkruar nga administratori i shoqërisë ofertuese se “makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi”, rezulton të jetë e pasaktë, pasi mjetet fadromë me goma, me targë AHMT07 dhe kamionçinë 1 T, me targë AA071XJ, etj., janë deklaruar se janë të angazhuara në Bashkinë Krujë.

- Deklarata për përmbushjen e kriterëve teknike rezulton të jetë e pasaktë, pasi nuk disponohet licencë për projektimin e objekteve arsimore.

- Certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, janë të lëshuara nga shoqëria S., e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me DT, pika 2.3.6.<sup>12</sup>

- Punonjësit e paraqitur nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesa dhe certifikatat e kualifikimit të tyre nuk janë nga shoqëri të licencuara apo akredituara për trajnimin e punonjësve ose janë nga shoqëri të cilat janë të licencuara dhe akredituara vetëm për certifikimin mbi sigurimin teknik të punonjësve të cilët punojnë me pajisjet dhe instalimet elektrike.

- Për kamionçinat me targë AA071XJ dhe TR6358T, me kapacitet mbajtës deri në 2.5 ton, nuk disponohet leja e transportit;

- Kamioni me targë AA280MS me kapacitet mbajtës 24 ton, në pronësi të shoqërisë N.B., nuk ka kontratë qeraje dhe leja e transportit është për transport vetjak.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithatë disponohen fatura, deklarata zhdoganimit, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre. Gjithashtu, disa deklarata doganore dhe fatura blerjeje të origjinës, janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer, në kundërshtim me LPP dhe DST.

<sup>11</sup> <https://openprocurement.al/en/pcompany/vieë/id/7766>

<sup>12</sup> <http://dpa.gov.al/en/accredited-bodies/>

### **Konkluzion:**

Për sa më sipër OE K.K. ShPK nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Grupi i auditimit konkludon se kjo procedurë auditimi duhet të ishte anuluar, të rishikoheshin kriteret e kualifikimit, vlerësimi i ofertave dhe të rishpallej për tenderim.

Duke shpallur fitues OE K.K. ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 279,218,916 lekë pa TVSh.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh); neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2; neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5; neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a); VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KVO, i përbërë nga T.F., Kryetar; A.M., Anëtar dhe E.D., Anëtar.

Trajtuar qjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **279,000,000 lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

| <b>4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemin Asfaltim i rrugeve Hashnjet, Hakeve dhe Tafeve, Nj. Adm, Berxulle”</b> |                                                                                                                   |                                                                                                           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 4801, datë 31.08.2022                                                                                      | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 4801, datë 31.08.2022                                              | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 4801/1, datë 31.08.2022                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E Hapur”                                                                                      | 1. A.I., Kryetar<br>2. A.P., Anëtar<br>3. G.D., Anëtar                                                            | 1. T.F., Kryetar<br>2. A.M., Anëtar<br>3. E.D., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>89,875,959 lekë                                                                                            | 6. Oferta fituese: OE “B.N.” me ofertë<br>85,079,831 lekë pa tvsh, me kontratë datë<br>03.11.2022, me afat 8 muaj | 7. Diferenca me fondin limit:<br>4,796,128 lekë pa tvsh                                                   |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>16.09.2022                                                                                            | 9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise                                                                          | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE<br>b) Skualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK: Jo                                                                                                                    | 12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo                                                                                  | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:                                                                            |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit:**

- Me shkresën nr. 4765 prot., datë 31.08.2022, nga Drejtoria e mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes së infrastrukturës është kërkuar nisja e procedurave të prokurimit për objektin “Sistemin Asfaltim i rrugeve Hashnjet, Hakeve dhe Tafeve, Nj. Adm, Berxulle”, me vlerën 89,875,989

lekë pa TVSh. Preventivat për këtë objekt janë marrë në bazë të projektit të hartuar nga shoqëria “A.S.”.

- Me urdhërin nr. 4765/1 prot., datë 31.08.2022, nga titullari i Bashkisë Vorë është ngritur Komisioni për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe A.K., me detyrë Përgjegjës në DMMI anëtarë.
- Me procesverbalin nr. 4765/2 prot., datë 31.08.2022, nga Komisioni për llogaritjen e fondit limit është përcaktuar vlera e investimit në shumën 89,875,959 lekë pa TVSh.
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKB-në nr. 99, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.
- Me procesverbalin datë 31.08.2022, nga Njësia e prokurimit janë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.
- Me shkresën nr. 4801/3, datë 07.09.2022 është njoftuar ndryshimi i DT.
- Në datën 07.09.2022 është hartuar shtojca për ndryshimin e kriterëve të veçanta, pa numër protokolli.

Nga auditimi, u konstatua se procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk janë protokolluar, në mospërputhje me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

#### **Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Në pikën 2.2.2., është kërkuar që “vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet...”. Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 2, germa b.
- Në pikën 2.2.3., është kërkuar “Vertetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 në të gjitha adresat ku operatori/operatorët ekonomik ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave perkatese të ekstraktit të QKR-se.”.

Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në pikën 2.3.1., është kërkuar “a) punë e ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet....; b) punë e ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, ...është jo më e vogël se vlera e dyfishit të fondit limit të kontratës që prokurohet....”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Kriteri i vendosur në pikën 2.3.10, se “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B shoqëruar me aktin e miratimit”, nuk është i argumentuar, pasi materialet e përftuara nga gjurmimet nuk i përmbushin kriteret për t’u konsideruar si mbetje që kanë ndikim në mjedis.
- Kontrata me një laborator për testimin e betonit nuk është e argumentuar. Testimi i betonit mund të bëhet në çfarëdolloj laborator, si dhe është detyrë e mbikëqyrësit dhe e kolaudatorit.

- Kamion me vinç dhe një autovinç me kapacitet mbajtes 16 ton nuk janë të argumentuar dhe nuk mbështeten në preventiv apo ST.
- Kulla e ndriçimit nuk është e argumentuar dhe nuk mbështetet në preventiv apo ST.
- Gjeneratori mbi 50 KVA nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në preventiv apo ST.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për vendosjen e kriterëve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe z. E.S., me detyrë Drejtor në DPKZHT, të cilët kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit për hartimin e projektit.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Nga Procesverbali mbi hapjen e ofertave, datë 16.09.2022, u konstatua pjesëmarrja e katër Operatorëve Ekonomikë.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, datë 23.09.2022, u konstatua se janë skualifikuar tre dhe është kualifikuar një Operator Ekonomik. Është shpallur fituese oferta e OE “B.N.” SHPK, me vlerë oferte 85,079,831.3 lekë pa TVSh.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 4801/4 prot., datë 03.10.2022, i miratuar nga Titullari i AK Bashkia Vorë. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 4801/6 prot., datë 03.11.2022. Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

| Nr. | OE pjesmarrës     | O. Ekonomike | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-----|-------------------|--------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | B.N.              | 85,079,831.3 | Kualifikuar dhe shpallur fitues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 2   | B.O.E “B. & T.    | 80,000,100   | <u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u><br>Operatori Ekonomik skualifikohet pasi duke u bazuar ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, KREU XI, Neni 88, pika 3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, nga ndarja e punimeve të bashkimit të operatorëve Operatori Ekonomik T. ka 52.66% të realizimit të punimeve ndërsa B. 47.33% të realizimit të punimeve. Nga ky fakt bie ndesh fuqia punëtore me përqindjen e realizimit të punimeve të deklaruar nga Operatorët Ekonomik. Operatori Ekonomik T. sh.p.k nuk ka aritur të përmbushë fuqinë punëtore ne raport me përqindjen e mare përsiper. |
| 3   | B.O.E E.H. & D.O. | 75,435,140   | <u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u><br>Operatori Ekonomik skualifikohet pasi referuar preventivit të marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton se Operatori Ekonomik E.H. ka marrë përsiper të kryejë 51% të të gjithë zërave të preventivit. Referuar formularit të vetëdeklarimit figuron se nuk ka deklaruar të gjithë inxhinierët e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor ne DST, pasi ka marrë përsipër Punime te preventivit për të cilat eshte e dosmsdoshme disponimi i inxhinierëve përkatës. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje, nga ndarja e punimeve.                                                                                                                            |
| 4   | B.O.E L.C. & N.   | 56,896,762   | <u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u><br>Operatori Ekonomik skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.5 ku Autoriteti Kontraktor ka kërkuar 3 Teknik Ndertimi dhe 1 Teknik Topograf. Operatori Ekonomik ka deklaruar dy Teknik ndërtimi dhe mungon Teknik Topograf.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9.

Nga auditimi, u konstatua se nga KVO nuk është vepruar në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim, pasi verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në formularin e vetëdeklarimit duhet të kishte filluar me BOE L.C. & N., i cili ka dhënë ofertën ekonomikisht më të favorshme, në vlerën 56,896,762 lekë pa TVSh dhe pasi të ftohej për të lidhur kontratën, nëse ky ofertues do të kishte pasur mangësi në dokumentacion ose mospërputhje me deklaratimet e bëra në Formularin e vetëdeklarimit, duhet të vazhdohej me ofertuesin e radhës, i cili kishte ofertën e dytë ekonomikisht më të favorshme. Skualifikimi pa të drejtë i OE me oferta

ekonomikisht më të favorshme dhe kualifikimi i OE B.N., për Ofertën ekonomike 85,079,831.3 lekë pa TVSh, i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorim në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik të fondeve publike në vlerën 89,875,959 lekë. Mangësitë e konstatuara nga KVO për B.O.E L.C. & N. duhet të ishin konsideruar “të vogla”, në kuptimin e LPP, neni 92, pika 3.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE B.N. në SPE, u konstatua se:

- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës për vetëdeklarimet, në lidhje me Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit, në mospërputhje me LPP, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6;
- OE B.N., nuk e ka objekt të aktivitetit ndërtimin e rrugëve;
- OE B.N. nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore.
- OE B.N. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për dy kontrata, ndërkohë që nga ekstrakti historik, u konstatua se ushtron veprimtari edhe në Tiranë dhe Rrogozhinë, për të cilat nuk ka vërtetuar shlyerjen e energjisë elektrike.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.3. për disponimin e stafit inxhinierik, pasi për inxhinierin gjeodet N.N., i cili është shtetas maqedonas nuk është paraqitur leja e punës dhe leja e qëndrimit në Shqipëri apo të dhëna nëse disponon dyshetësi.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.4. për “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*”, pasi certifikata e znj. U.S. nuk është nga institucion i licencuar dhe akredituar për trajnimin dhe certifikimin e personelit.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.5., pasi punonjësit e paraqitur nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesa dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik të tyre nuk janë nga shoqëri të licencuara apo akredituara për trajnimin e punonjësve ose janë nga shoqëri të cilat janë të licencuara dhe akredituara vetëm për certifikimin mbi sigurimin teknik të punonjësve të cilët punojnë me pajisjet dhe instalimet elektrike.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.9., pasi certifikatat ISO 9001:2015, ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015, janë të lëshuara nga shoqëritë L. dhe K., të cilat nuk janë të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për akreditimin e shoqërive të certifikimit.<sup>13</sup>
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.10., pasi leja mjedisore me kod III.2.B është për grumbullim dhe transport të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetjeve nga ndërtimet, sipas aktit të miratimit) dhe jo për mbetje që kanë ndikim në mjedis, sipas kërkesës në DT.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.12., pasi mjeti me targë AA180MB nuk është autobitumatriçe, por autobot. Dokumentacioni teknik për makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj dhe i papërkthyer, në mospërputhje me LPP, duke bërë të pamundur verifikimin e kapaciteteve sipas kërkesave në DT. Në DT kërkohet një kamion me vinç dhe një autovinç me kapacitet mbajtës 16 ton, ndërkohë që vërtetohet disponimi vetëm i një mjeti, me targë AA946HL. Nuk është paraqitur dokumentacion për miniekskavator me goma dhe miniekskavator me peshë 3-5 ton. Kamioni me targë EL2085C, me kapacitet 20 ton dhe kamionçinat me targë AA208SA dhe AA209SA, me kapacitet mbi 1 ton, të marrë me qera nga shoqëria Blerimi ShPK, lejen e transportit e kanë vetëm për llogari të vet, jo për transport për të tretë.

### **Konkluzion:**

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9 dhe më pas të vazhdohet me ftesat për lidhjen e kontratës, duke filluar nga OE me ofertën më të ulët, ku t'u

<sup>13</sup> <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

kërkohej OE të paraqesnin dokumentacionin sipas vetëdeklarimeve.

Skualifikimi pa të drejtë i OE me oferta ekonomike 85,079,831.3 lekë pa TVSh, i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorimin e fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për këtë vlerë.

Sa më sipër, grupi i auditimit konkludon se kjo procedurë auditimi duhet të ishte anuluar, të rishikohej preventivi, kriteret e kualifikimit, vlerësimi i ofertave dhe të rishpallej për tenderim. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh); neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2; neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5; neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a); VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KVO, i përbërë nga T.F., Kryetar; A.M., Anëtar dhe E.D., Anëtar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **85,079,831 lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

| <b>5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim, Asfaltim Rrugeve Kodra e Miut dhe Rindertimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vore”</b> |                                                                                                                              |                                                                                                           |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 8619, datë 16.12.2021                                                                                                  | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 8619, datë 16.12.2021                                                         | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 8619/1, datë 16.12.2021                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E Hapur”                                                                                                  | 1. A.V., Kryetar<br>2. S.C., Anëtar<br>3. R.B., Anëtar                                                                       | 1. R.M., Kryetar<br>2. A.P., Anëtar<br>3. D.B., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>66,665,754 lekë                                                                                                        | 6. Oferta fituese: B.O.E “B.I.” & “L.K.” shpk me ofertë 53,030,003 lekë pa tvsh, me kontratë datë 22.02.2022, me afat 6 muaj | 7. Diferenca me fondin limit:<br>13,635,751 lekë pa tvsh                                                  |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>21.01.2022                                                                                                        | 9. Burimi Financimit: Buxheti i Bashkise                                                                                     | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE<br>b) Skualifikuar 2 OE,<br>c) Kualifikuar 2 OE |
| 11. Ankimime AK: Jo                                                                                                                                | 12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo                                                                                             | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:                                                                            |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit:**

- Me shkresën nr. 7294 prot., datë 19.10.2021, i është kërkuar Institutit të Ndërtimit kryerja e Oponencës Teknike, në vijim të së cilës është lidhur marrëveshja përkatëse. Oponenca Teknike është dërguar nga IN me shkresën nr. 1784 prot., datë 26.11.2021 dhe është protokolluar në Bashkinë Vorë me nr. 7294/2 prot., datë 01.12.2021.

- Me shkresën nr. 8618 prot., datë 16.12.2021, nga Drejtoria e mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes së infrastrukturës është kërkuar nisja e procedurave të prokurimit për objektin “*Sistemim, Asfaltim Rrugeve Kodra e Miut dhe Rindertimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vore*”, me vlerën 66,665,754 lekë pa TVSh. Preventivat për këtë objekt janë marrë në bazë të projektit të hartuar nga shoqëria “A.S.”.
- Me urdhërin nr. 8618/1 prot., datë 16.12.2021, nga titullari i Bashkisë Vorë është ngritur Komisioni për hartimin e Specifikimeve Teknike, i përbërë nga A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.K., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe E.S., me detyrë Përgjegjës në DMMI anëtarë.
- Me procesverbalin nr. 8618/2 prot., datë 16.12.2021, nga Komisioni për hartimin e Specifikimeve Teknike është përcaktuar edhe vlera e investimit në shumën 66,665,754 lekë pa TVSh, sipas projektit të realizuar nga shoqëria “A.S.”. Nga auditimi u konstatua se nuk ka urdhër të posaçëm për hartimin dhe llogaritjen e fondit limit.
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKB-në nr. 27, datë 24.03.2021 “*Për rishikimin e buxhetit të vitt 2021*”.
- Me procesverbalin datë 16.12.2021, nga Njësia e prokurimit janë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.
- Me shkresën nr. 180, datë 11.01.2022 është njoftuar ndryshimi i DT.
- Në datën 11.01.2022 është hartuar shtojca për ndryshimin e kriterëve të veçanta, pa numër protokolli.

Nga auditimi, u konstatua se procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk janë protokolluar, në mospërputhje me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

#### **Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Në pikën 2.2.2., është kërkuar që “*vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet...*”.
- Duke qenë se vlera e fondit limit të kësaj procedure është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar, kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa b.
- Në pikën 2.3.1., është kërkuar “*a) punë e ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet....; b) punë e ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, ....është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet ....*”.
- Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39, “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 5.
- Kriteri i vendosur në pikën 2.3.3., për disponimin e një inxhinieri ndërtimi të profilit gjeoteknik është i tepërt, i paargumentuar dhe diskriminues, pasi pikërisht ky kriter ka skualifikuar dy OE, nga të cilët edhe ofertën ekonomike më të favorshme.
  - Kriteri i vendosur në pikën 2.3.4., për sigurimin e shërbimit mjekësor duke disponuar një mjek të punësuar ose të kontraktuar nga jashtë është i tepërt, i papërshtatshëm dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 “*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*”, pika 1.
  - Kriteri i vendosur në pikën 2.3.4/b., “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier i pajisur me certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të vërtetuar me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kontratë pune të vlefshme, diplomë, i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit*”, është i tepërt dhe i paargumentuar.

- Kriteri i vendosur në pikën 2.3.9., se “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B shoqëruar me aktin e miratimit”, nuk është i argumentuar, pasi materialet e përfuara nga gërmimet nuk i përmbushin kriteret për t’u konsideruar si mbetje që kanë ndikim në mjedis.
- Kriteri i vendosur në pikën 2.3.10., për pajisjen e “liçensës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, e lëshuar nga QKL, Kodi III.2.A (1+2)” ose “punësimi i të paktën një ekspert mjedisi i pajisur me certifikaten e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë, të paktën 3 muajt fundit”, është i tepërt dhe i paargumentuar.
- Kriteri i vendosur në pikën 2.3.11., për kontratë me një laborator për testimin e betonit, asfaltit dhe bitumit nuk është e argumentuar. Testimi i betonit mund të bëhet në çfarëdoqj laborator, si dhe është detyrë e mbikëqyrësit dhe e kolaudatorit.
- Autovinçi me kapacitet mbajtes mbi 5 ton dhe një kamion me vinç nuk janë të argumentuar dhe nuk mbështetet në preventiv apo ST.
- Kulla e ndriçimit nuk është e argumentuar dhe nuk mbështetet në preventiv apo ST.
- Gjeneratori mbi 50 KVA nuk është i argumentuar dhe nuk mbështetet në preventiv apo ST.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për vendosjen e kriterëve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.K., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe E.S., me detyrë Përgjegjës në DMMI anëtarë, të cilët kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit për hartimin e projektit.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Hapja e ofertave është pasqyruar direkt në sistem, nga ku konstatua se nga KVO është vepruar jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në LPP dhe në Rregullat për prokurimin publik, pasi janë skualifikuar ofertat e dy OE, konkretisht BOE D.O. & “E.C.C.”, me ofertë në vlerën 46,685,274.25 lekë dhe OE B., me ofertë në vlerën 55,124,521 lekë.

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9 dhe më pas të vazhdohet me ftesat për lidhjen e kontratës, duke filluar nga OE me ofertën më të ulët, ku t’u kërkohej OE të paraqesnin dokumentacionin sipas vetëdeklarimeve.

Nga Procesverbali mbi vlerësimin e ofertave, datë 23.09.2022, u konstatua se janë skualifikuar dy dhe janë kualifikuar dy Operatorë Ekonomikë. Është shpallur fituese oferta e BOE “B.I.” & “L.K.”, me vlerë oferte 53,030,003 lekë pa TVSh.

Raporti përmbledhës është hartuar me nr. 831 prot., datë 07.02.2022, i miratuar nga Titullari i AK Bashkia Vorë. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr. 831/2 prot., datë 22.02.2022.

Të dhënat për kualifikimin/skualifikimin e Operatrëve Ekonomikë, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

| Nr. | OE pjesmarrës   | O. Ekonomike  | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----|-----------------|---------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | D.O. & “E.C.C.” | 46,685,274.25 | <p><u>Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:</u><br/> Kualifikuar dhe shpallur fitues<br/> Operatori ekonomik ofertues nuk përmbush pikat:<br/> - 2.3.3 Inxhenieri i paraqitur nga ofertuesi në formularin e vetëdeklarimit nuk plotëson kushtet e kërkuara sipas DST, konkretisht është kërkuar inxh. Gjeoteknik në dokumentat e bashkangjitur paraqitet Inxh. Gjeologjik me Bachelor Gjeoinformatike.<br/> - 2.3.4. Pika a. Operatori ekonomik nuk deklaron/disponon mjet të përgjithshëm sipas DST, (Në zbatim të VKM Nr.108, datë 9.2.2011), ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015.<br/> - 2.3.8. Pika D. Operatori ekonomik nuk disponon certifikaten ISO 39001 : 2012 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë” e vlefshme, ose ekuivalent.</p> |

|   |                       |            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---|-----------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2 | B.O.E “B.I.” & “L.K.” | 53,030,003 | Kualifikuar dhe shpallur fitues                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 3 | H.                    | 65,187,570 | Kualifikuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 4 | B.                    | 55,124,521 | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Operatori ekonomik nuk ploteson pikat:<br>- 2.3.3. Operatori ekonomik nuk disponon Inxh. Gjeoteknik sipas kërkeses në DST.<br>- 2.3.12. Operatori ekonomik në mjetet e deklaruar autobetonieria me targë KR 8702 A certifikata për transport mallrash rezultoi e skaduar. |

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

Nga auditimi, u konstatua se nga KVO nuk është vepruar në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim, pasi verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në formularin e vetëdeklarimit duhet të kishte filluar me BOE D.O. & E.C.C., i cili ka dhënë ofertën ekonomikisht më të favorshme, në vlerën 46,685,274.25 lekë pa TVSh dhe pasi të ftohej për të lidhur kontratën, nëse ky ofertues do të kishte pasur mangësi në dokumentacion ose mospërputhje me deklaratimet e bëra në Formularin e vetëdeklarimit, duhet të vazhdohej me ofertuesin e rradhës, i cili kishte ofertën e dytë ekonomikisht më të favorshme.

Skualifikimi pa të drejtë i OE me ofertë ekonomikisht më të favorshme dhe kualifikimi i B.O.E “B.I.” & “L.K.”, për Ofertën ekonomike 53,030,003 lekë pa TVSh, i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorim në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik të fondeve publike në vlerën 53,030,003 lekë.

BOE D.O. & “E.C.C.”, i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të favorshme në vlerën 46,685,274.25 lekë pa TVSh, duhet të ishte shpallur fitues dhe është skualifikuar pa të drejtë, pasi mangësitë e konstatuara nga KVO janë të vogla dhe nuk çenojnë realizimin e kontratës, përfshirë faktin që kërkesa për mjek të përgjithshëm nuk ka mbështetje ligjore.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “B.I.” & “L.K.”, u konstatua:

- OE B.I. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për dy kontrata, ndërkohë që nga deklarimi i pagesës së taksave vendore dhe nga verifikimet në internet, u konstatua se gjatë vitit 2021 ka ushtruar veprimtari në bashkitë Dropull, Tiranë, Durrës, Përmet, Elbasan dhe Kukës. OE L.K. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për tre kontrata, ndërkohë që nga deklarimi i pagesës së taksave vendore dhe nga verifikimet në internet, u konstatua se gjatë vitit 2021 ka ushtruar veprimtari në bashkitë Librazhd, Tiranë, Skrapar, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Kamëz, Kukës, Vlorë, Krujë, Lushnjë dhe Patos. Nga sa më sipër, nuk vërtetohet shlyerja e energjisë elektrike në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit.

- Nuk përmbushet pika 2.2.3. e DT, pasi OE B.I. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për bashkitë Tepelenë, Dropull, Kukës, Përmet, Vorë dhe Tiranë, ndërkohë që nga verifikimet në internet, gjatë vitit 2021 ka ushtruar veprimtari edhe në bashkitë Durrës dhe Elbasan, për të cilat nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e pagesave.<sup>14</sup> OE L.K. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për bashkitë Librazhd, Tiranë, Skrapar, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Kamëz, Kukës, Vlorë, Krujë, Lushnjë dhe Patos, ndërkohë që nga verifikimet në internet, gjatë vitit 2021 ka ushtruar veprimtari edhe në bashkinë Berat, për të cilën nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e pagesave.<sup>15</sup>

- Nuk përmbushet pika 2.3.8., ku kërkohet që “*Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kontratës*”.

<sup>14</sup> [https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/8/year/2019/perf\\_id/BE-ISSH.P.K](https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/8/year/2019/perf_id/BE-ISSH.P.K)

<sup>15</sup> [https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/3/year/2019/perf\\_id/LEONKONSTRUKSION](https://spending.data.al/en/treasury/list/faqe/3/year/2019/perf_id/LEONKONSTRUKSION)

Konkretisht, certifikata EN-ISO 14001-2015 e OE B.I. përfundon në datën 11.02.2022 dhe certifikata ISO 45001:2018 përfundon në datën 15.05.2022.

- Nuk plotësohet nënpika 2.3.5., pasi punonjësit e paraqitur nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesa dhe dëshmitë e kualifikimit të tyre nuk janë nga shoqëri të licencuara apo akredituara për trajnimin e punonjësve ose janë nga shoqëri të cilat janë të licencuara dhe akredituara vetëm për certifikimin mbi sigurimin teknik të punonjësve të cilët punojnë me pajisjet dhe instalimet elektrike.

- Nuk plotësohet nënpika 2.3.9., pasi leja mjedisore me kod III.2.B është për grumbullim dhe transport të mbetjeve urbane (sipas aktit të miratimit) dhe jo për mbetje që kanë ndikim në mjedis, sipas kërkesës në DT.

- Nuk plotësohet nënpika 2.3.12., pasi mjeti me targë AA095VO, i marrë me qera nga shoqëria Kastrati, nuk është autobot uji, por cisternë për transportin e mallrave të rrezikshme, e vërtetuar nga certifikata përkatëse bashkëlidhur.

- Disa nga makineritë teknologjike, nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”.

Gjithashtu, dokumentacioni shoqërues i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer, në mospërputhje me LPP, duke bërë të pamundur verifikimin e kapaciteteve sipas kërkesave në DT.

- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimi, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

#### **Konkluzion:**

Nga KVO, për këtë procedurë prokurimi duhet të ishin kualifikuar të gjitha ofertat, sepse të gjitha kanë plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Pranimit, të cilat nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat konsiderohen të përmbushura me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9 dhe më pas të vazhdohet me ftesat për lidhjen e kontratës, duke filluar nga OE me ofertën më të ulët, ku t’u kërkohej OE të paraqesnin dokumentacionin sipas vetëdeklarimeve.

Skualifikimi pa të drejtë i BOE D.O. & “E.C.C.” me ofertë ekonomike më të favorshme dhe kualifikimi i BOE “B.I.” & “L.K.” për Ofertën ekonomike 53,030,003 lekë pa TVSh, i ka shkaktuar AK Bashkia Vorë përdorimin e fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për këtë vlerë.

Sa më sipër, grupi i auditimit konkludon se kontrata e sipërmarrjes për këtë procedurë auditimi duhet të ishte lidhur me BOE D.O. & “E.C.C.”, e cila ka paraqitur Ofertën ekonomike më të favorshme.

Sa më sipër, grupi i auditimit konkludon se kjo procedurë auditimi duhet të ishte anuluar, të rishikohej preventivi, kriteret e kualifikimit, vlerësimi i ofertave dhe të rishpallej për tenderim. Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat d) dhe dh); neni 3 “*Parime të përgjithshme*”, pikat 1 dhe 2; neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2; Neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5; neni 87 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1; neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3; neni 98 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, pika nr. 1, germa a); VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6; neni 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1; neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. G.P. dhe KVO, i përbërë nga R.M., Kryetar, A.P. dhe D.B. Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën **53,030,003 lekë** pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

| <b>6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rindertimi i shkolles 9 vjecare Picar”</b> |                                                                                                                                                     |                                                                                                           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi:<br>Nr. 3483, datë 27.06.2021                                                 | 2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:<br>Nr. 3483, datë 27.06.2021                                                                                | 3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:<br>Nr. 8619/1, datë 16.12.2021                                          |
| 4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“E Kufizuar”                                              | 1. A.I., Kryetar<br>2. G.D., Anëtar<br>3. E.D., Anëtar                                                                                              | 1. T.F., Kryetar<br>2. A.M., Anëtar<br>3. A.P., Anëtar                                                    |
| 5. Fondi Limit (pa Tvsh)<br>137,930,944 lekë                                                      | 6. Oferta fituese: BOE “Z. shpk & A.M.” me ofertë 137,820,000 lekë pa tvsh, me kontratë datë 13.09.2022, me afat 1 muaj projektim dhe 9 muaj zbatim | 7. Diferenca me fondin limit:<br>110,944 lekë pa tvsh                                                     |
| 8. Data e hapjes së tenderit:<br>Faza 1: 15.07.2022<br>Faza 2: 10.08.2022                         | 9. Burimi Financimit: Buxheti i Shtetit                                                                                                             | 10. Operatorët Ekonomikë<br>a) Pjesëmarrës në tender 5 OE<br>b) Skualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 2 OE |
| 11. Ankimime AK: Jo                                                                               | 12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo                                                                                                                    | 13. Përgjigje Ankesës nga KPP:                                                                            |

**Titulli i gjetjes:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Situata: Llogaritja e fondit limit:**

- Me urdhërin nr. 3407/1 prot., datë 03.06.2022, nga titullari i Bashkisë Vorë është ngritur Komisioni për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe D.K., me detyrë Përgjegjës në DMF, anëtarë.
- Me procesverbalin nr. 3407/2 prot., datë 23.06.2022, nga Komisioni për llogaritjen e fondit limit është përcaktuar vlera e investimit në shumën 137,930,944 lekë pa TVSh.
- Projekt ideja është hartuar nga specialistët e DPKZHT Bashkia Vorë dhe Detyra e Projektimit është nënshkruar nga ish titullari i Bashkisë Vorë, G.P..
- Fondi për këtë investim është akorduar me VKM-në nr. 99, datë 04.02.2022 “Për miratimin e fondit për rindërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e shkollës 9 vjeçare Picar, Bashkia Vorë, ....dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese”.
- Për llogaritjen e fondit limit nuk japet asnjë e dhënë në lidhje me metodologjinë e përdorur, llogaritjet, nevojën, etj., në mospërputhje me LPP, neni 34, “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, pikat 1, 3 dhe 6, si dhe Rregullat e PP, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”, pikat 1, 4 dhe 7.
- Me procesverbalin datë 27.06.2022, nga Njësia e prokurimit janë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.
- Me shkresën nr. 3483/3 prot., datë 06.07.2022 është njoftuar ndryshimi i DT, pa bërë ndryshimin e afatit.

Nga auditimi, u konstatua se procesverbalet e mbajtura nga komisionet e prokurimit nuk janë protokolluar, në mospërputhje me *“Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”*, neni 18.

Përgjegjësia për hartimin e fondit limit është e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe D.K., me detyrë Përgjegjës në DMF, anëtarë.

#### **Hartimi i kriterëve të kualifikimit:**

- Në pikën 2.2.3., kërkohet që OE *“duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe 2022....prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKB”*. Ky kriter nuk i përmbush dispozitat e LPP dhe Rregullave të prokurimit publik, pasi AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 *“Kriteret detyruese për skualifikim”*, pika 2.

- Në nënpikën 2.3.1., gërmat a dhe b, kërkohet që OE të ketë *“....punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet”* dhe *“punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”*.

Sa më sipër, duke e ndryshuar nga *“më e madhe”* në *“më e vogël”*, bie në kundërshtim literalisht të drejtpërdrejtë me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 39, *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, pika 5, gërmat a dhe b.

- Në nënpikën 2.3.2., janë kërkuar licencat:

- NP-1-B, *“Punime gërmimi në tokë”*, është e mbivlerësuar, pasi kjo korrespondon me vlerën 21-50 milion lekë, e cila nuk parashikohet në projektide apo preventiv;
- NP-2-C, *“Ndërtime civile dhe industriale”*, limiti i së cilës është më i ulët se vlera e fondit limit. Kjo licencë duhet të ishte e nënkategorisë D, që korrespondon me vlerën 101-200 milion lekë;
- NS-2-B, *“Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre”*, është e mbivlerësuar, pasi kjo korrespondon me vlerën 21-50 milion lekë, e cila nuk parashikohet në projektide apo preventiv;
- NS-4-C, *“Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues”*, është e mbivlerësuar, pasi kjo korrespondon me vlerën 51-100 milion lekë, e cila nuk parashikohet në projektide apo preventiv.
- NS-8-B, *“Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”*, nuk duhet të ishte, pasi nuk parashikohen ndërtime parafabrikat në asnjë vlerë, ndërkohë që licenca e kërkuar korrespondon me vlerën 21-50 milion lekë, e cila nuk parashikohet në projektide apo preventiv.
- NS-14-B, *“Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj”*, është e mbivlerësuar, pasi kjo korrespondon me vlerën 51-100 milion lekë, e cila nuk parashikohet në projektide apo preventiv.

- Në nënpikën 2.3.3., është kërkuar disponimi i stafit inxhinierik pa marrë në konsideratë përcaktimet specifike të legjislationit të fushës, ku duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një institucion arsimor, kriteret e përcaktuara janë të lidhura ngushtë me vjetërsinë në punë, eksperiencën dhe kualifikimet përkatëse. Kriteret e vendosura nga AK nuk japin garanci dhe siguri për kontratën.

- Në nënpikën 2.3.7., kërkohet që OE të ketë “....1 (një) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”....”. Kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordinаторit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve”, pika 5.
- Në nënpikën 2.3.7., kërkohet që OE të ketë “....1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar”. Kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe nuk gjen mbështetje në Ligjin e përmendur.
- Në nënpikën 2.3.7., kërkohet që OE të ketë “....1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë për “Auditues Energjie”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj”. Kjo kërkesë nuk është e përshtatshme, pasi trajnimi nuk vërteton certifikimin. Certifikatën për auditues të energjise e jep ministria përkatëse, e cila është i vetmi autoritet kompetent.
- Nuk është kërkuar disponimi i shoferëve apo manovratorëve, sipas listës së makinerive të kërkuara.
- Nga grupi i auditimit, nuk gjenden të argumentuara makineritë e mëposhtme:  
2 copë kamionçina deri 3 ton, pasi edhe mjete me kapacitet më të madh mund të kryenin të njëjtat funksione dhe nuk ka pse të kërkohen në mënyrë specifike këto mjete;  
1 copë ekskavator me zinxhirë, pasi nuk ka terrene të vështira apo zona me lagështirë të madhe, të cilat do të bënin të pamundur ecjen e makinerive me goma.  
Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.  
Përgjegjësia për vendosjen e kritereve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara, është e NJHDT dhe A.P., me detyrë Përgjegjës në DPKZHT, kryetar; S.C., me detyrë Specialist në DPKZHT dhe D.K., me detyrë Përgjegjës në DMF, anëtarë, të cilët kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit për hartimin e projektit.

#### **Vlerësimi i ofertave:**

Në datën 15.07.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli për hapjen e ofertave, nga ku u konstatua pjesëmarrja e 5 OE, si më poshtë:

1. S.O.;
2. A.K.;
3. G.C.;
4. S.;
5. Z..

Në datën 25.07.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli për klasifikimin e ofertave, ku kualifikohen OE S. dhe OE Z..

Për vlerësimin dhe arsyet e kualifikimit/skualifikimit të OE nuk është mbajtur PV i posaçëm, por të dhënat janë në sistemin SPE.

Me shkresën nr. 3483/3 datë 29.07.2022 është dërguar Ftesa për ofertë OE S. dhe OE Z., të cilat janë kualifikuar në fazën e parë.

Me nr. 4187 prot., datë 05.08.2022, është dorëzuar oferta e OE S. në vlerën 137,930,000 lekë.

Me nr. 4190 prot., datë 08.08.2022, është dorëzuar oferta e BOE Z. & A.M. në vlerën 137,840,000 lekë.

Në datën 10.08.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli për hapjen e ofertave si më sipër.

Me nr. 3483/6 prot., datë 10.08.2022 nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, nga ku u konstatua se nuk është dhënë asnjë detaj në lidhje me vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e OE në Fazën 1.

Në datën 11.08.2022, nga KVO është mbajtur PV pa numër protokolli për njoftimin e klasifikimit të ofertave, ku OE S. është vlerësuar me 98.16 pikë dhe BOE Z. & A.M. është vlerësuar me 100 pikë.

Me shkresën nr. 3483/7, datë 11.08.2022, është bërë njoftimi i klasifikimit, sipas PV më sipër. Detajet e vlerësimit të dokumentacionit u audituan në SPE, nga ku u konstatua se vlerësimi i ofertuesve të sipërpërmendur është bërë sipas tabelës më poshtë:

| Nr. | OE pjesmarrës | Arsyet e kualifikimit/skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës                                                                                                                                                        |
|-----|---------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | S.O.          | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Mungon Dokumentacioni Tekniko Ligjor                                                                                                                                           |
| 2   | A.K.          | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Mungon eskavator me goma, kamioncina 3 -5 ton dhe autoboti i ujit. Nuk ka mundur të paraqesë përgjegjes për demet në mjedis, si dhe mekanik sipas kriterëve të vecanta të DST. |
| 3   | G.C.          | Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:<br>Nuk ka arritur të përmbushë pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes dhe nuk ka deklaruar Drejtuesin Teknik sipas pikes 2.3.8 |
| 4   | S.            | Kualifikuar                                                                                                                                                                                                            |
| 5   | Z.            | Kualifikuar dhe shpallur fitues                                                                                                                                                                                        |

Hartimi i Raportit Përmbledhës përpara klasifikimit të ofertuesve dhe shpalljes së fituesit, si dhe mangësitë në hartimin e tij, janë në kundërshtim me LPP, neni 99, “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”, germa b) dhe ç), si dhe Rregullat e PP, neni 84 “Raporti përmbledhës”, pika 2.

Kontrata është lidhur me nr. 3483/10 prot., datë 13.09.2022, me afat 1 muaj projektim dhe 9 muaj zbatim.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE Z. & A.M., u konstatua se:

- Kontrata e bashkëpunimit e paraqitur dhe oferta përkatëse nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në Rregullat e PP, neni 88, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1.
- OE nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës për vetëdeklarimet, në lidhje me Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit, në mospërputhje me LPP, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, si dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6;
- Nga auditimi, u konstatua se OE “Z.” ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore vetëm për bashkinë Lushnjë dhe Shkodër, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Berat, Dimal, Has, Cërrik, Belsh, Tiranë, Kuçovë, Kavajë, Skrapar, Roskovec, Fier dhe Gramsh. Gjithashtu, konstatohet se OE Z. nuk ka vërtetuar shlyerjen e energjisë elektrike në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit.<sup>16</sup>
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.7. pasi:
  - Certifikata “Përgjegjës për sigurinë në punë” e z. B.H., është e lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar për certifikimin e punonjësve dhe certifikata tjetër është lëshuar nga shoqëria H., e cila është e akredituar vetëm për certifikimin e punonjësve përdorues të pajisjeve elektrike.<sup>17</sup>
  - Certifikata “Përgjegjës për demet në mjedis” e znj. A.N. është lëshuar nga shoqëria H., e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë.
  - Certifikata “Auditues Energjie” e znj. N.M., është e lëshuar nga Universiteti i Tiranës dhe vërteton kryerjen e kursit për auditues energjie. Certifikata profesionale dhe e vetmja që ka fuqi ligjore për auditimin e energjisë, lëshohet nga Agjencia për Eficientësi dhe Energji, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Nuk plotësohet nënpika 2.3.9., pasi punonjësit e paraqitur nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesa dhe dëshmitë e kualifikimit të tyre nuk janë nga shoqëri të licencuara apo akredituara për trajnimin e punonjësve ose janë nga shoqëri të cilat janë të licencuara dhe akredituara vetëm për certifikimin mbi sigurimin teknik të punonjësve të cilët punojnë me pajisjet dhe instalimet elektrike.

<sup>16</sup> [https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf\\_id/Z.](https://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/perf_id/Z.)

<sup>17</sup> <http://dpa.gov.al/en/accredited-bodies/>

- Certifikata “Përgjegjës për punime në lartësi” e z. E.D. dhe F.H., janë lëshuar nga shoqëria H., e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Disa nga makineritë teknologjike, nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”. Gjithashtu, dokumentacioni shoqërues i këtyre makinerive është në gjuhë të huaj, i papërkthyer dhe në disa raste i palexueshëm.
- Për mjetet dhe pajisjet, për të cilat megjithëse disponohen fatura, deklarata zhdoganimit, etj., nuk vërtetohet disponimi i tyre, sepse fatura është një dokument i përkohshëm. Një mjet, makineri apo pajisje pasi blihet, regjistrohet në regjistrat kontabël përkatës dhe vetëm këta regjistra mund të vërtetojnë disponimin dhe pronësinë e tyre.

**Konkluzion:**

Për sa më sipër BOE Z. & A.M. nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Grupi i auditimit konkludon se kjo procedurë auditimi duhet të ishte anuluar, të rishikoheshin kriteret e kualifikimit, vlerësimi i ofertave dhe të rishpallej për tenderim.

Duke shpallur fitues BOE Z. & A.M., i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT, AK ka lidhur kontratë me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën 137,820,000 lekë pa TVSh.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat d) dhe dh); neni 3 “*Parime të përgjithshme*”, pikat 1 dhe 2; neni 76, “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2; LPP, neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5; neni 87 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1; neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3; neni 98 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, pika nr. 1, germa a); VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1 dhe 6; neni 45 “*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*”, pika 1; neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, paragrafi i fundit.

Përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban titullari i AK, z. B.Sh. dhe KVO, i përbërë nga T.F., Kryetar; A.M., Anëtar dhe E.D., Anëtar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 11.08.2023

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

**Shkak:** Moszbatimi i kuadrit ligjor në përlllogaritjen e fondit limit, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për llogaritjen e fondit limit, NjP dhe anëtarët e KVO.

**Ndikimi/Efekti:** Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, për vlerën 137,820,000 lekë pa TVSH.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

#### **2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.**

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin “*Sistemim, Asfaltim Rrugëve Kodra e Miut dhe Rindërtimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vorë*”, u konstatua se:

- Objekti i kontratës “Sistemim, Asfaltim Rrugëve Kodra e Miut dhe Rindërtimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vorë” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 831/2 prot. datë 22.02.2022, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Vorë, përfaqësuar nga G.P. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “B.I.” Shpk & “L.K.” shpk, përfaqësuar me prokurë të posacme nga OE “B.I.” Shpk, përfaqësuar nga administratori K.I.. Vlera e kontratës është 63,636,004 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 6 muaj nga fillimi i punimeve. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar operatori ekonomik “D.” Shpk, me licencë nr. MK. 1676/12 përfaqësuar nga administratori ing. V.T.. Për kolaudimin e punimeve është përcaktuar operatori ekonomik “G.L.C.” Shpk, me licencë nr. MK. 2928/10 përfaqësuar nga administratori ing. L.H.. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët në datën 29.07.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët më datë 29.07.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 29.07.2022. Njoftimi i përfundimit të punimeve dhe procesverbali i përfundimit të punimeve mbajtur nga palët, është realizuar më datë 27.01.2023, brenda afati kontraktual prej 6 muajsh. Akti i kolaudimit është realizuar në mars 2023. Me urdhërin nr. 44 datë 29.03.2023, është ngritur komisioni për marrjen e përkohëshme në dorëzim dhe në datën 29.03.2023 objekti është marrë në dorëzim nga investitori.

**Titulli i Gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim, Asfaltim Rrugëve Kodra e Miut dhe Rindërtimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vorë”, nga kontraktori “B.I.” shpk & “L.K.” shpk.

**Situata:** Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatuan pasaktësitë si më poshtë vijon:

1. Kontrata në preventivin e ripunuar, kapitulli “Punime Dherash”, zëri nr. 1, nr. 3.137 “Gërmim dheu me eskavator goma 0.15 m<sup>3</sup>, në themele, tokë e zakonshme kategoria III, me shkarkim në tokë”. Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Bashkinë Vorë, janë përshkruar sipërfaqet e profileve tërthore të piketave të rrugës, ku disa piketa nuk përputhen me llogaritjet e sipërfaqeve në librezat e masave. Sipërfaqja e seksioneve tërthore është përcaktuar me pajisje topografike GPS, duke nxjerrë kuotat e tokës dhe kuotat e projektit të zbatuar. Pas verifikimit të profileve të seksioneve tërthore të projektit, vërehen sipërfaqe tërthore të pasakta në disa seksione, duke rritur volumet e punimeve të dherave. Llogaritjet e gabuara të papërputhura në përgjithësi janë në Aksin 2 dhe Aksin 3. Nga rillogaritja e volumeve të projektit, bazuar sipërfaqeve tërthore me pasaktësi, rezulton vlera prej 134,000 lekë pa TVSH ose 160,800 lekë me TVSH, e përfituar padrejtësisht nga kontraktori për shkak të llogaritjeve të pasakta në projekt.

2. Në situacionin përfundimtar, zëri “Trotuar me 6 cm beton, me pllaka”, pasqyrohet sasia 482 m<sup>2</sup>. Libreza e masave paraqet sasinë 483.76 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i librezës së masave dhe verifikimi në objekt, në të dy krahët e trotuarit pasqyrohen sipërfaqet e akseve, por në përlllogaritje nuk janë zbritur gropat e mbjella me fidanë 80 cm x 80 cm. Referuar situacionit përfundimtar janë realizuar ose vendosur 80 copë fidanë në trotuare. Duke përlllogaritur sipërfaqen e një grope fidani, rezulton 0.64 m<sup>2</sup> (0.8 m x 0.8 m). Duke shumëzuar për totalin e fidanëve rezulton sipërfaqja 51.2 m<sup>2</sup> (0.64 m<sup>2</sup> x 80 copë). Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen e trotuarit me 51.2 m<sup>2</sup> dhe me çmimin përkatës 1,300/m<sup>2</sup>, rezulton vlera 66,560 lekë pa TVSH ose 79,872 lekë me TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi **vlera 240,672 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga diferenca faktike e punës së realizuar dhe punimeve të parealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.

**Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 8, datë 11.08.2023**

**Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për

*mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 831/2 prot. datë 22.02.2022.*

**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Shkak:** Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Vorë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **240,672 lekë** nga kontraktori BOE “B.I.” shpk & “L.K.” shpk, për punime të likuiduara por të parealizuara.

## **2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

**2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;**

**2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;**

Bashkia Vorë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, në datën 17.05.2019.

### **➤ Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022**

Duke iu referuar sistemit e-Leje dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Vorë, gjatë periudhës 01.01.2022 deri 31.12.2022 janë zhvilluar 850 aplikime, ndër të cilat janë miratuar **40 leje** ndërtimi, **146 leje** rindërtimi, **39 leje** zhvillimi, **29** certifikata përdorimi dhe **44** deklarata paraprake për kryerje punimesh, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Duke u bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga DPZHT e Bashkisë Vorë, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **11 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **11 leje** ndërtimi, të paraqitura në Aneksin L2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t’u audituar rastet e mëposhtme të lejeve së ndërtimit, për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, të paraqitura në Aneksin L3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej situata në lidhje me mosparaqitjen në planvendosjen e miratuar, të numrave të kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet dhe mosparaqitjen e saktë të të dhënave të tregueve të zhvillimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes:** Mosparaqitja në planvendosjen e miratuar e numrave të kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet dhe mosparaqitja e saktë e të dhënave të treguesve të zhvillimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi, u konstatua se për objektin: “*Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim*”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik nuk pasqyrohen numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të

zhvillohet, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Nga auditimi, u konstatua se për objektin: “*Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 1981/5, datë 30/08/2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë, në tabelën e të dhënave të zhvillimit të paraqitura në planvendosje nuk përfshihet e gjithë sipërfaqja e ndërtimit, pasi sipërfaqja e ballkoneve prej 108 m<sup>2</sup> nuk bën pjesë. Sipërfaqja totale e ndërtimit nga 3476 m<sup>2</sup> është 3584 m<sup>2</sup>, duke shtuar edhe sipërfaqet e ballkoneve.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023.

**Kriteri:** VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 15, pika 1, gërma c, “*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*”;

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i numrit të kateve të objekteve me të cilat do të kufizohet objekti që do të zhvillohet ndikon në mosrespektimin e distancave ndërmjet objekteve; në normat e lejuara të distancave; në lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; në diellëzimin dhe orientimin; Mosparaqitja e saktë e të dhënave në tabelën e treguesve të zhvillimit në planvendosjen e miratuar, ndikon në parametrat e zhvillimit, në respektimin e distancave nga kufiri i pronës, në ruajtjen e distancave ndërmjet objekteve dhe në vlerësimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të gjithë elementët e nevojshëm në planvendosjen e paraqitur, përfshirë numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet ndërtimi i ri dhe të dhënat e sakta të treguesve të zhvillimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim; z. S.K., me pozicion specialist, nga periudha 16.03.2021-01.07.2022.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në lidhje me mosrespektimin e distancave ndërmjet objekteve.

**Titulli i gjetjes:** Mosrespektimi i distancave minimale ndërmjet objekteve.

**Situata:** Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim*”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, në planvendosjen e miratuar, në orientimin veri-lindor, objekti kufizohet me një objekt në lartësinë e 2 kateve i cili ka çarje në fasadë dhe nuk ka rrugë kalimi ndërmjet dy objekteve, duke ruajtur distancën 1 metër nga kufiri i pronës, nga një distancë minimumi prej 5 metrash nga kufiri i pronës që duhet të respektonte dhe një distancë prej 10 metra ndërmjet objekteve, në kundërshtim me VKM-në nr. 457, datë 29.6.2022, neni 27 ku përcaktohet ndryshimi i nenit 34, distanca minimale midis ndërtimeve, pika 3; Ndërmjet dy faqeve të objekteve nuk ka rrugë kalimi dhe duhet respektuar distanca minimale prej 10 metrash ndërmjet objekteve.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023

**Kriteri:** VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar me vendimin nr. 457, datë 29.6.2022, në nenin 27 përcaktohet ndryshimi i nenit 34, distanca minimale midis ndërtimeve, pika 3;

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i distancave minimale ndërmjet ndërtimeve, duke u bazuar tek kriteret e mësipërme çënojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit, të mbrojtjes nga zjarri, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar distancat ndërmjet ndërtimeve dhe të respektohet distanca minimale për aksesin ndërmjet dy ndërtimeve që gjenden përballë njëri-tjetrit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim; z. S.K., me pozicion specialist, nga periudha 16.03.2021 - 01.07.2022*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes:** Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:

1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë. Në planvendosjen e miratuar distanca nga kufiri i pronës nuk është matur në përfundim të faqes së ndërtimit, por në një pjesë të sfazuar të saj. Distanca nga 9 metra që duhet të respektohet për objektin në lartësinë e 8 kateve është 7.5 metra nga kufiri i pronës.

2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohen daljet konsol, të cilat janë sipërfaqe ndërtimi e shfrytëzueshme. Distanca që duhet të respektohet nga kufiri i pronës është 3 metra për objektin në lartësinë e 2 kateve, përfshirë edhe daljen konsol prej 1.53 metrash. Distanca nga kufiri i pronës në orientimin lindor, e cila pasqyrohet në planvendosje 3.8 metra, është 2.27 metra. Ndërsa distanca nga kufiri i pronës në orientimin jugor, nga 3 metra e pasqyruar në planvendosje është 1.47 metra.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023.

**Kriteri:** VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimeve të reja në parcelat me të cilat kufizohet, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me kriteret përkatëse dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, për lejen e ndërtimit nr. 1, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar*

i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim; z. S.K., me pozicion specialist, nga periudha 16.03.2021 -01.07.2022

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, për lejen e ndërtimit nr. 2, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim;

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua 1 praktikë në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar të ndërtimit në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

**Titulli i gjetjes:** Mosrespektimi i lartësisë së ndërtimit në bazë të kondicioneve urbane të përcaktura në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në Rregulloren e Planit.

**Situata:** Nga auditimi, u konstatua se në objektin “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, lartësia e përgjithshme e ndërtimit tejkalon lartësinë e lejuar, duke mos qenë në përputhje me kondicionet urbane të përcaktuara sipas njësise VO\_UB\_A2\_9-1. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, datë 17.05.2019, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë VO\_UB\_A2\_9-1, në sistemin urban, me kategorinë e lejuar banim 100% dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 4, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 50%, me lartësi ndërtimi 27 metra dhe me numrin e lejuar të kateve mbi tokë 8 kate. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, gërma a, lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet nga kuota mesatare e sistemit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit. Objekti nuk është në lartësinë e 27 metrave, por në lartësinë e 27.50 metra, pa përfshirë nuklin e shkallëve dhe ashensorit, me një lartësi totale 29 metra.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023.

**Kriteri:** Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 20, “Plani i përgjithshëm vendor”; VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”, pika 1, gërma a;

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, ndikon në: lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; normat e lejuara të distancave; vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë; diellëzimin dhe orientimin; respektimin e normave mjedisore;

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në planvendosje, që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe me kondicionet urbane të lejuara sipas njësise përkatëse.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim;

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika në lidhje me mosparaqitjen në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

**Titulli i gjetjes:** Mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit, si më poshtë:

1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë. Sipërfaqja e banimit të objektit që do të zhvillohet është 4.456 m<sup>2</sup>. Në bazë të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 19, nga sipërmarrësi duhet të ishte siguruar kalimi pa shpërblim i të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk është paraqitur marrëveshja për kalimin e sipërfaqes ndërtimore të favor të fondit publik. Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Vorë është realizuar një marrëveshje ndërmjet palëve, e cila duhet të ishte ngarkuar në sistem përpara miratimit të lejes.
2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, nuk pasqyrohet projekti në formatin dwg i ngarkuar në sistemin e-leje, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma ç, në të cilën përcaktohet se duhet të ngarkohet në sistem: “Projekti i plotë arkitektonik dhe relacioni shoqërues i tij, të nënshkruar elektronikisht nga projektuesi në format pdf dhe dwg”

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”; Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 19.

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me leje ndërtimi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë, duke ndikuar në verifikimin e projektit teknik me të gjitha detajet e paraqitura në versionin elektronik dwg dhe në sigurinë e realizimit të marrëveshjes ndërmjet palëve për kontributin e krijimit të fondit publik të banesave sociale.

**Shkak:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, për lejen e ndërtimit nr. 1, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim; z. S.K., me pozicion specialist, nga periudha 16.03.2021 -01.07.2022.*

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, për lejen e ndërtimit nr. 2, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë*

*specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, të paraqitura e ngarkuara në sistemin e-leje gjatë aplikimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që për lejet e ndërtimit të miratuara nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse, si më poshtë:

1. “Magazinë 1 kat dhe zyra 2 kat me mur rrethues”, miratuar me vendimin nr. 2466/5, datë 16.08.2022, me zhvillues “S.C.” ShPK, në Prezë, Vorë. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, mungon mendimi i Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në lidhje me distancën që duhet të respektojë ndërtimi i ri nga kanali me të cilin kufizohen.

2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, mungon mendimi i Drejtorisë së Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, konformitetin në lidhje me distancën që duhet të respektojë ndërtimi i ri nga kanali me të cilin kufizohen.

*Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023*

**Kriteri:** VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 3.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e marrjes së lejes dhe autorizimeve përkatëse në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi ndikon në miratimin e lejes së ndërtimit pa qenë në konformitet me legjislacionin në fuqi.

**Shkak:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje ndërtimi dhe të vijohet me miratimin e lejes së ndërtimit pas konformitetit të tyre.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim;*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit.

**Titulli i gjetjes:** Moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimit të lejes të ndërtimit.

**Situata:** Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Magazinë 1 kat dhe zyra 2 kat me mur rrethues”, miratuar me vendimin nr. 2466/5, datë 16.08.2022, me zhvillues “S.C.” ShPK, në Prezë, Vorë, nuk është konvertuar resursi i tokës nga “arë” në “truall”. Në vendimin e VNMsë paraprahe, me aplikimin nr. AN050420220003, datë 27.04.2022, në pikën 3.2, në masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis, përcaktohet se: “Ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë ndryshimin e statusit

të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi”. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, në dokumentacionin e pronësisë pasuria është në statusin “arë” dhe jo në statusin “truall”.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 28.07.2023

**Kriteri:** VKM nr. 440, datë 3.6.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 6.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, ndikon në ndërtimin e objekteve në resursin e tokës “arë” dhe jo në resursin e tokës “truall”, duke cënuar ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.

**Shkak:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Vorë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z. B.Sh., me detyrë Kryetar i Bashkisë Vorë; z. G.D., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 03.11.2021 e në vijim; z. A.P., me detyrë përgjegjës planifikimi, nga periudha 15.08.2022 e në vijim; z. S.C., me detyrë specialist jurist, nga periudha 20.07.2020 e në vijim;*

Nga auditimi u konstatua se për objektin: “Magazinë 1 kat dhe zyra 2 kat me mur rrethues”, miratuar me vendimin nr. 2466/5, datë 16/08/2022, me zhvillues “S.C.” ShPK, në Prezë, Vorë, në relacionet e ngarkuara në sistemin e-leje nuk përshkruhet funksioni dhe qëllimi i destinacionit të objektit. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, datë 17.05.2019, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë VO\_UB\_S\_1-13, në sistemin urban, me kategorinë S., shërbime 100% dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 1.2, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 60%, me lartësi ndërtimi 13 metra dhe me numrin e lejuar të kateve mbi tokë 3 kate. Në përdorimet e lejuara bëjnë pjesë funksionet si: Qendër Panairi; Qendër Tregtare; Treg shumice; Treg pakice; Bar; Restorant; Hotele. Në përdorimet e ndaluara bëjnë pjesë funksionet si: Banim; Industri; Ekonomi. Në relacionin e mbrojtjes kundër zjarrit përshkruhet si objekt me funksion prodhimi, duke krijuar paqartësi nëse aktiviteti i ushtruar dhe qëllimi i destinacionit është në përputhje me tipologjinë e lejuar të ndërtimit dhe përdorimet e ndaluara si industri dhe ekonomi.

Nga auditimi u konstatua se për objektin: “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë, mënyra e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur me vlerën e duhur të taksës, nga 4% të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet, ishte përlllogaritur me 3% të vlerës, në mospërputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 27.

- Mënyra e llogaritjes së ndikimit në infrastrukturë në bazë të preventivit është si më poshtë:  $105,904,166.69 \text{ lekë} \times 4\% = 4,236,167 \text{ lekë}$ .

- Në bazë të verifikimeve të sipërfaqes së ndërtimit nuk janë përfshirë daljet konsol me gjerësi 1.53 metra,  $108 \text{ m}^2$ , si sipërfaqe e shfrytëzueshme. Llogaritja në bazë të çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri si qendër biznesi është si më poshtë:

$3,584 \text{ m}^2 \times 51,500 \text{ lekë/m}^2 \times 1.5 \times 4\% = 11,074,560 \text{ lekë}$ .

- Tarifë vendore për kërkesën “për leje punimesh” jo publike për studimet e reja 1% e vlerës së investimit:  $3,584 \text{ m}^2 \times 32,113 \text{ lekë/m}^2 \times 1\% = 1,150,930 \text{ lekë}$ .

- Totali = 12,225,490 lekë.

Fatura e përlogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Vorë është 4,464,991.48 lekë, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën 12,225,490 lekë. Mënyra e përlogaritjes nuk është e rregullt, pasi në bazë të paketës fiskale për ndërtime të destinuara për qëndër tregtare apo të biznesit, vlera e nivelit të taksës është 4%. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme, prej 7,760,498.52 lekë përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Vorë. Në observacionet e dërguara u paraqitën fakte të reja në lidhje me një aplikimin për ndryshim projekti dhe mënyra e përlogaritjes së taksës është rishikuar me vlerën 4%. Diferenca e vlerave të pasqyruara gjatë fazës së mbajtjes së aktkontatimit është likujduar në fazën e miratimit të ndryshimit të projektit në periudhën pas auditimit.

## **2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)**

### **2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.**

**Titulli i Gjetjes:** Mbi organizimin dhe funksionimin joefektiv të IMTV-së.

**Situata:** 1. Referuar Strukturës organizative të Bashkisë Vorë për vitin 2022 dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe Inovacionit/Sektorit të Burimeve njerëzore në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, u konstatua se IMTV është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Në vitin 2022 struktura e IMTV ka në përbërje 6 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 5 inspektorë, sipas paraqitjes në Aneksin IMTV1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për periudhën objekt auditimi, IMTV është drejtuar nga Kryeinspektor J.K., i cili rezulton me profil arsimor “Menaxhim Biznesi”, niveli Bachelor dhe nga data e pezullimit 07.11.2022 e në vijim, detyrën e kryeinspektorit krahas detyrës së saj me urdhër të Brendshëm e ka kryer Inspektore R.Ç. me profil arsimor “Juridik” niveli Bachelor.

Nga të dhënat e pasqyruara në Aneksin IMTV1, rezulton se nga Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe vetëm 2 prej tyre plotësojnë kriteret konform kërkesave ligjore për të ushtruar funksionet e Inspektorit të IMTV: A.Ç. dhe R.Ç.; ndërsa 6 inspektorët e tjerë përfshirë dhe Kryeinspektorin nuk plotësojnë kriteret.

Për sa më sipër, konstatohet se në IMTV Bashkia Vorë, para dhe përgjatë periudhës objekt auditimi, është punësuar staf në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Kryeinspektorët dhe disa nga inspektorët e cituar më sipër, nuk kanë arsimin e duhur për të ushtruar detyrën e K/inspektorit dhe atë të inspektorit.

2. Lidhur me strukturën organizative të IMTV Bashkia Vorë nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se: në korrik të vitit 2021 njësia u plotësua me numrin e inspektorëve konform strukturës organizative (6) të miratuar me Urdhërin e kryetarit nr. 07 me nr. 96 prot., datë 07.01.2021 “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Pezë dhe Bërxull për vitin 2021” dhe Urdhërin e kryetarit nr. 67 me nr. 2647 prot., datë 18.05.2022 (1 kryeinspektor + 5 inspektorë) “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2022” dhe funksionoi e tillë deri më mars 2022; u plotësua në maj 2022 deri në shtator 2022; nga shtatori 2022 e në vazhdim funksionon me strukurë jo të plotë, ku bie në sy pezullimi i kryeinspektorit, funksionet e të cilit i ushtron me urdhër të brendshëm një prej inspektorëve.

3. Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë ushtruar inspektime në 23 subjekte, për të cilat janë mbajtur procesverbale konstatimi dhe janë nxjerrë vendime. Një informacion i

përmbledhur është paraqitur në Aneksin IMTV2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

4. Nga kontrolli i dokumentacionit, u **konstatua** se kryeinspektori, për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujore dhe atë vjetor të punës, veprim në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Vorë, miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

Informacioni në lidhje me kontrollet e zhvilluara gjatë vitit 2022, është paraqitur në Aneksin IMTV3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

5. Lidhur me aktet e mbajtura “*procesverbal konstatimi*”, rezultoi se janë nxjerrë vendime “*masa administrative*” ndaj 23 subjekteve kundërvajtës, konform akteve ligjore;

Nga 23 subjektet me “masë administrative” janë pranuar dhe paguar gjoba nga 6 subjekte në vlerën 500,000 lekë; detyrimi i papaguar nga 17 subjekte kundërvajtës është 5,100,000 lekë, për të cilat nga IMTV janë dërguar praktikat në Gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv; 2 prej tyre rezultojnë në proces gjyqësor.

Nga auditimi u **konstatua** se vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, u **konstatua** se nuk janë bërë kallëzime penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar; por kryeinspektori i IMTV, ka njoftuar Komisaratin e Policisë Vorë, e cili nga ana e vet ia përcjellë Prokurorisë informacionin e marrë. Kjo procedurë ka ndjekur këtë linjë, pasi struktura e IMTV nuk ka qenë e plotë (nga komunikimi i subjektit).

7. Me mosangazhimin e IKMT për ekzekutimin e vendimeve të marra nga IMTV, është krijuar një periudhë e gjatë kohore inaktive. Nga ana e IMTV për këtë periudhë u **konstatua** se nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “*leje pezullimi*” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii; gjithashtu nga komunikimi verbal u **konstatua** se kjo situatë e krijuar sjell rrezikun e aplikimit të këtyre objekteve për proces legalizimi pranë ASHK-së. Nga auditimi, rezultoi se nuk ka komunikim dhe bashkëpunim midis Bashkisë Vorë dhe ASHK-së si për marrje informacioni dhe për kërkesë pezullimi të procedurës për legalizim.

- Lidhur me konstatimet e mësipërme, çdo subjekti kundërvajtës i është krijuar një dosje me gjithë praktikën e ndjekur: proces verbale, vendime, foto etj, duke bërë të mundur miradministrimin e dokumentacionit, konform kërkesave ligjore.

8. Nga auditimi **rezultoi se** nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit dhe Drejtoria Ligjore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMTV-së Bashkia Vorë, ky sistem do të bënte të mundur hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të ekzekutuar brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMTV.

## 2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer

***kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.***

1. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit 2022 nga 23 kontrolle të ushtruara në terren, janë përpiluar 17 Vendime për “prishje objekti” për 16 subjekte, të cilat kanë rezultuar pa leje të lëshuar nga DPKZHT/Bashkia Vorë dhe janë shoqëruar edhe me vendosje të masës administrative (gjobë).

Informacioni në lidhje me kontrollet e zhvilluara gjatë vitit 2022 dhe masat e marra, është paraqitur në Aneksin IMTV4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për këto subjekte krahas vendimit “masë administrative” është shoqëruar me vendim “prishje objekti” për 17 subjekte; vendim “pezullim punimesh” për 18 subjekte;

Për 17 subjektet me vendim “për prishje objekti pa leje”, është dërguar informacion dhe kërkesë zyrtare IKMT për mbështetje në makineri e mjete për ekzekutimin e vendimeve të nxjerra nga IMTV Bashkia Vorë:

Shkresa nr. 2254/1 prot., datë 09.05.2022 me objekt “Dërgohet informacion” për 9 subjekte të periudhës nëntor 2021-mars 2022;

Shkresa nr. 3904 prot., datë 15.07.2022 me objekt “Kërkesë për mbështetje me mjete dhe makineri për ekzekutim të vendimeve për prishje” për 47 subjekte të periudhës qershor 2021-mars 2022;

Shkresa nr. 3904/1prot., datë 04.10.2022 me objekt “Kërkesë për mbështetje me mjete dhe makineri për ekzekutim të vendimeve për prishje” për 5 subjekte të periudhës mars 2021-shtator 2022;

Shkresa nr. 6600 prot., datë 17.11.2022 me objekt “Kërkesë për mbështetje me mjete dhe makineri për ekzekutim të vendimeve për prishje” për 52 subjekte të periudhës qershor 2021-shtator 2022 (listë përmbledhëse e dy shkresave dërguar më parë;

U **konstatua** se nga ana e IMTV, nisur nga vonesat e IKMT për ekzekutim të vendimeve dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, nuk rezulton të jetë paraqitur në kërkesat buxhetore vjetore si nevojë imediate pajisjen e IMTV-së Bashkia Vorë (blerje) me mjetet dhe makineritë e duhura të cilat shërbejnë për prishjen e objekteve, pra për ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti pa leje”. Kjo do sillte rritje të efektivitetit në aktivitetin e IMTV nga njëra anë dhe të besueshmërisë së komunitetit ndaj veprimtarisë së bashkisë, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se ndonëse në IKMT janë përcjellë kërkesat për bashkëpunim në ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti”, për periudhën nën auditim (deri në korrik 2023), nga ana e IKMT nuk është ekzekutuar asnjë vendim.

3. Nga kontrolli, verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi verbal **rezultoi** se vjelja e gjobave për vendimet e marra nga IMTV, në rastet e mospagimit vullnetar nga subjekti i kundërligjshëm dhe që dërgohen në Gjykatë, ekzekutimi i vendimeve të gjykatës realizohet nëpërmjet zyrave përmbartimore private, në zbatim të Ligjit nr. 10031/2018 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” i ndryshuar me Ligjin nr. 109/2016 datë 27.10.2016.

“Kontrata e Shërbimit” është plotësuar sipas Modelit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 4321/4 datë 18.07.2017 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Modelit të Kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit”.

Në Bashkinë Vorë (pala kreditore në cilësinë e palës kërkuese të shërbimit) përfaqësues ligjor i saj në kontratë është Kryeinspektori i IMTV; ndërsa nëse procedura të ndryshme kalojnë në proces gjyqësor (ankimim), kryeinspektori autorizon një prej inspektorëve. Në “Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë Vorë” dhe atë të IMTV-së, neni 113 “detyrat e Inspektorit” nuk gjendet e listuar kjo detyrë, duke rezultuar në mungesën e një ndarje

dhe përshkrimi të plotë të detyrave që duhet të përmbushë dhe përgjegjësi që ka inspektori i IMTV-së, edhe pse për çdo rast kryeinspektori ka nxjerrë autorizimin për përfaqësim ligjor në gjykatë. Në këto kushte kryeinspektori duhet të kërkonte bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Vorë ose në kërkesën e fundvitit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore drejtuar gjithë njësitë të strukturës mbi “*nevojat për burime njerëzore dhe pozicionin përkatës*”, të kërkonte vendosjen në strukturën e IMTV një pozicion të ri “Jurist” për të mbuluar procedurat ligjore në Gjykatë.

### **2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.**

Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se janë ushtruar nga k/inspektori/ët inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi, dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje janë përpiluar “*proces verbale konstatimi*”. U **konstatua** se për subjektet e tjera nuk janë përpiluar akte kontrolli, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar dhe nenin 51 “*Inspektimi*” të Ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*”. Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit profesional/arsimor sipas ligjit për të kryer akte inspektimi/kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se nga ana e IMTV-së janë mbajtur proces verbale konstatimi vetëm për “*shkelje afati*” pra konstatim i karakterit ligjor.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa dh; Ligji nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” neni 51 “*Inspektimi*” i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, neni 52 pika 1/e; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*”; pika 1/b/ii; Ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 3, neni 29 pika 3,4; Pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Vorë, miratuar me Vendimin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues. Shmangen detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nuk jep garanci për një kontroll efektiv dhe cilësor të territorit.

**Shkaku:** Strukturë e paplotë dhe me personel të pakualifikuar dhe në mospërputhje me detyrimet që përcakton ligji.

**Rëndësi:** E lartë

**Rekomandim 1:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për të plotësuar strukturën e IMTV me staf të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, duke publikuar shpalljet e vendeve vakante në portalin e punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit;

**Rekomandimi 2:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar të marrin masa për implementimin e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMTV si dhe për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

**Rekomandimi 3:** Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së të hartojnë e miratojnë planet mujore e vjetore të aktivitetit të tyre; të mbajnë akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të përgatisin praktikën për kallëzim penal ndaj subjekteve kundërvajtës; rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit dhe me ASHK Vendore Tiranë, për të patur një informacion të plotë në kohë reale mbi aplikuesit për leje legalizimi dhe statusin e ndërtimeve të cilat janë objekt i procesverbaleve të konstatimit të përpiluara nga inspektorët e IMTV-së Bashkia Vorë.

## **2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

### **2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.**

Auditimi i fundit në Bashkinë Vorë është kryer në vitin 2022, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 25 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 7 masa për shpërblim dëmi;
- 4 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike;
- 1 rekomandim për masa disiplinore, ku vetë subjekti ka caktuar masa për 3 (tre) punonjës.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j “Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit”, Bashkia Vorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve nr. 5669/1 prot., datë 10.10.2022, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, por nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh.

**Zbatuar pjesërisht**

### **2.7.2. Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.**

Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Vorë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Raportimi 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve nuk është dërguar në KLSH brenda afateve ligjore.

**Pa zbatuar**

### **Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH**

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Vorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH, me shkresën nr. 5669/1 prot., datë 10.10.2022, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

**Pa zbatuar**

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Vorë ka kthyer përgjigje në KLSH

me shkresën nr. 2443/1 prot., datë 17.10.2022, duke mos respektuar afatin 20 ditor nga marrja e shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, afat i cili është përmbushur deri në datën 03.10.2021. Në këtë datë, KLSH duhet të ishte vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe nga Bashkia Vorë duhet të ishte dërguar “*Plani i veprimeve*”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së.

#### ***Zbatuar pjesërisht***

Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, pika 2, Bashkia Vorë duhet të kishte raportuar shkresërisht brenda afatit 6 muajor nga data e mbërritjes së RPA, të dërguar nga KLSH me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Vorë me nr. 2443 prot., datë 12.09.2022. Nga auditimi rezultoi se ky raportim nuk është bërë, pasi afati 6 muajor është përmbushur në datën 11.03.2023, periudhë e cila përkon me fazën në terren të grupit të auditimit për zbatimin e programit të auditimit nr. 1173/1 datë 09.01.2023. Gjatë zhvillimit të auditimit, Bashkia Vorë i është përgjigjur kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre.

#### ***Në Proces***

Bashkia Vorë, në lidhje me “*Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së*” dhe për masat e marra për zbatimin e tyre, ka raportuar në Këshillin Bashkiak me shkresën nr. 239 prot., datë 24.01.2023, me objekt: “*Raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022, “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit”*”.

#### ***Zbatuar***

**Konkluzion:** Nga verifikimet e bëra mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm i KLSH-së, rezulton se nga 30 rekomandime, janë pranuar 30 rekomandimet e lëna, nga të cilat janë zbatuar 9 rekomandime ose 30% e tyre. Ky nivel i ulët realizimi ka ardhur pasi nga ana e Titullarit të Bashkisë Vorë si dhe për shkak të mosfunksionimit me efektivitet të GMS në Bashkinë Vorë, nuk janë marrë masat e duhura, që brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore, të miratohej “*Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve*”, duke vënë në dijeni KLSH-në.

**Titulli i gjetjes:** Mos respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, mos respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit dhe mosraportim në Këshillin Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

**Situata:** Sikurse është cituar më lart, Bashkia Vorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH, me shkresën nr. 5669/1 prot., datë 10.10.2022, por nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh, sipas Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, germa j; gjithashtu nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, sipas Ligjit nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, pika 2; dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 50, pika 5.

**Trajtuar gjerësisht në Akt Verifikimin nr. 1, datë 28.07.2023**

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2. Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 50, pika 5.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Vorë të kryhen në mospërputhje me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

**Shkak:** Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Vorë me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Bashkia Vorë të marrë masa në vijimësi, për të respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, për të respektuar afatin e kthimit të përgjigjes mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit dhe për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

### ***2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.***

**Titulli i gjetjes:** Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të KLSH, në Bashkinë Vorë.

**Situata:**

#### **MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

- Në lidhje me hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Vorë, bazuar në Urdhër Nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”, në të cilën janë plotësuar kërkesat në përputhje me strukturën organizative, të miratuar bazuar në Urdhër Nr. 67, datë 18.05.2022, nr. 2647 prot., përsa i takon ndarjes së detyrave, përshkrimin e detyrave funksionale, si dhe përcaktimin e përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të institucionit.
- Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur bazuar në Urdhër Nr. 55, datë 21.04.2022, nr. 2064 prot., por nuk ka funksionuar për vitin 2022, pasi nuk është kryer asnjë takim i këtij grupi lidhur me proceset dhe funksionet kryesore të veprimtarisë së institucionit. Strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut, për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, nuk janë hartuar dhe nuk figurojnë si dokumentacion në Bashkinë Vorë. Gjithashtu nuk është hartuar gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës për drejtoritë kryesore të institucionit.
- Gjatë vitit 2022, përsa i takon rregullimit të pozicioneve të punës të Shërbimit Civil, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka janë evidentuar raste që punonjësit e emëruar me Kod Pune, të jenë trajtuar si Nëpunës të Shërbimit Civil dhe për çdo procedurë konkurimi është vënë në dijeni DAP.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**1.2. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Janë kryer përditësime të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vorë, bazuar në Urdhër Nr. 214, datë 01.12.2022, nr. 6910 prot., “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit, të Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative”. Gjithashtu vihet re se, nuk janë hartuar programe të trajnimeve profesionale të stafit dhe nuk ka një sistem të mirfilltë komunikimi, që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Për vitin 2022 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar pa Përgjegjës, por është emëruar përgjegjës i ri i NjAB duke nisur nga data 31.05.2023, bazuar në Urdhër Nr. 02, datë 31.05.2023, nr. 3071 prot., “Për ushtrimin e përkohshëm të detyrave shtesë të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**2.2. Rekomandim:** Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vorë.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Karta e auditimit është përgatitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Vorë, me shkresën nr. 2775 prot., datë 26.05.2022. Përsa i takon hartimit të planeve vjetore të auditimit, vihet re sa janë marrë masat për të planifikuar auditime në sektorë, që konsiderohen me risk. Nga ana tjetër dosja e përhershme e auditimit nuk është krijuar manualisht ose në format elektronik.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**3.1. Rekomandim:** Këshilli Bashkiak Vorë të marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm brenda datës 31 Dhjetor si dhe të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Lidhur me këtë rekomandim, nuk është përgatitur Kalendar i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitin 2022, por është hartuar dhe miratuar kalendar i përgatitjes së PBA-së për periudhën 2024 - 2026, me Vendim Nr. 82, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e kalendarit të PBA-së 2024 - 2026” dhe formularet D1 dhe C1, përkatësisht burimet buxhetore 2024 - 2026 dhe tavanet buxhetore për këtë periudhë. Gjithashtu janë miratuar tavanet buxhetore me Vendim nr.31, datë 28.04.2023 “Miratimi i tavanëve buxhetore afat – mesëm, 2024 - 2026”, të cilat janë dërguar

në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për rekomandime dhe gjithashtu është miratuar parashikimi afatmesëm i të ardhurave për periudhën 2022 – 2024.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentojë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka marrë masat për krijimin dhe hartimin e një buxheti real dhe objektiv, në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke minimizuar diferencat midis parashikimit dhe realizimit. Ndërkohë vihet re se, nga ana e Bashkisë Vorë nuk janë realizuar konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, për parashikimin e kërkesave të tyre buxhetore.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**5.1. Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Vorë të merren masa për hartimin në përputhje me kërkesat ligjore dhe dërgimin në institucionet përkatëse të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit sipas afateve të përcaktuara. Titullari i Bashkisë Vorë të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar është miratuar Buxheti Faktik për vitin 2022, me Vendim Nr. 30, datë 28.04.2023 “Miratimin e realizimit të Buxhetit Faktik për vitin 2022”, gjithashtu është miratuar edhe raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2022, me Vendim Nr. 32, datë 28.04.2023 “Raportet e monitorimit të Buxhetit të vitit 2022”.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Në Bashkinë Vorë janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve bazuar në Urdhër Nr. 226, datë 30.12.2022, nr. 7546 prot., “Për zbatimin e masave organizative nr.6 të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, por nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të cilat janë evidentuar me statusin në proces zbatimi, madje as për rekomandimet e lëna nga auditimi i fundit, në afatet e përcaktuara prej 20 ditësh dhe 6 – muaj, që nga momenti i marrjes së raportit përfundimtar të auditimit.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Vorë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin e informacionit për nevojat vjetore, me qëllim planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtorja e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Vorë ka marrë masa për planifikimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, duke ngritur grupin e punës për vlerësimin e situatës dhe marrjen në konsideratë të gjendjes faktike të të dhënave në terren, realizimin e të ardhurave të vitit aktual dhe konsultimin me grupet e interesit, duke finalizuar kështu procesin e hartimit

dhe planifikimit të të ardhurave vjetore. Për subjektet që kanë lidhur marrëveshje për pagesën më këste të detyrimeve dhe nuk kanë respektuar kushtet e marrëveshjes dhe afatet e pagesës, është zgjidhur marrëveshja e lidhur dhe ka rifilluar zbatimin e masave shtrënguese, bazuar në legjislacionin në fuqi. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore për vitin 2022 ka arritur një nivel prej 87.9% të realizimit të planit të të ardhurave.

**Statusi:**

**Në proces zbatimi**

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Vorë gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vorë, ka marrë masat duke lidhur marrëveshje, që kanë përmbajtje dhe formë të dokumenteve zyrtare, për kryerjen e pagesës me këste nga subjektet debitorë, për të likuiduar detyrimet tatimore.

**Statusi:**

**Në proces zbatimi**

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Ky rekomandim është realizuar me mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2022 dhe kjo llogari është saktësuar dhe kontabilizuar për vlerën 302,988,134 lekë.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Ky rekomandim është realizuar me mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2022 dhe kjo llogari është saktësuar dhe kontabilizuar për vlerën 56,077,560 lekë. Gjithashtu Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë ka marrë masa dhe po vijon të punojë, për nxjerrjen e kontratave që u ka mbaruar afati i garancisë, për t’i dërguar më pas në Drejtorinë e Urbanistikës për marrje në dorëzim përfundimtar.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Ky rekomandim është realizuar me mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2022 dhe kjo llogari është saktësuar dhe kontabilizuar për vlerën 412,867,557 lekë.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim,

përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë ka hartuar një regjister të aktiveve të njësive dhe po vijon që ta organizojë dhe plotësojë këtë regjister me të dhënat përkatëse.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemi në kontabilitet i llogarisë nr.230 dhe nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212/202 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë ka sistemuar dhe kontabilizuar llogarinë 231 “Investime në proces” në vlerën 48,564,301 lekë. Ndërsa për llogarinë 230 ka marrë masa për të saktësuar dhe sistemuar në vazhdimësi. Përsa i takon llogarive 202, 212 dhe 213 nuk janë kryer veprimet kontabël.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**14.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Në pasqyrat financiare të vitit 2022, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, janë kryer veprimet kontabël dhe kjo llogari ka rezultuar në vlerën 73,394,841 lekë.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**15.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke kryer mbylljen e saj në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Menaxhimit Financiar ka saktësuar dhe kontabilizuar llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vlerën 412,867,557 lekë.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**16.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vorë, për një pjesë të procedurave të ndjekura, janë hartuar urdherat dhe janë marrë masat për të formuar komisionet, për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, sipas llojit të procedurës së realizuar. Këto komisione kanë pasur në përbërje të tyre të paktën një specialist të fushës për të cilën është realizuar procedura, duke

ndihmuar kështu në dhënien e argumentave për kriteret specifike të procedurave përkatëse, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e tyre.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**17.1. Rekomandim:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Bashkia Vorë, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tilla, të cilat nuk mbështeten në kriterë ligjore, por krijojnë pengesë për operatorët ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga specialistët e fushës, në Njësinë e Prokurimit Bashkia Vorë, janë marrë masa për vendosjen e kriterëve në përputhje me aktet ligjore, për një pjesë të procedurave të prokurimit, duke mos krijuar pengesë për operatorët ekonomikë gjatë konkurimit në procedurat e prokurimit publik.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**18.1. Rekomandim:** Komisionet apo personat e ngarkuar për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të marrin masa në procedurat në vijim që kërkesat për punë të ngjashme të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, duke mos shtuar apo modifikuar në forma të tjera jo ligjore.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga komisionet apo personat e ngarkuar për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, janë marrë masat, që kërkesat për punë të ngjashme të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që vendosja e kriterëve specifike të jetë në përputhje me këto kërkesa.

**Statusi:**

**Në proces zbatimi**

**19.1. Rekomandim:** Titullari i AK, të marrë masa që në çdo procedurë prokurimi, të përcaktojë minimalisht 1 person i cili të jetë specialist i fushës që lidhet me objektin e prokurimit, kjo për të hartuar kriterë të përshtatshme dhe në përputhje me objektin që prokurohet.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga Bashkia Vorë janë marrë masa që në procedurat e prokurimit, të paktën një anëtar i komisionit të ketë qenë specialist i fushës, që lidhet me objektin e prokurimit, duke bërë të mundur hartimin e kriterëve të përshtatshme dhe në përputhje me objektin e prokurimit.

**Statusi:**

**Në proces zbatimi**

**20.1. Rekomandim:** AK të marrë masa që në financimet të cilat janë pjesë e programeve buxhetore shumë vjeçare, të kryej financimin për vitin e parë minimalisht në masën e përcaktuar prej 20% të vlerës së plotë të tij.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Në financimet e programeve buxhetore për vitet 2022 – 2024, janë planifikuar dhe kryer të gjitha investimet afat - gjata në masën mbi 20% të vlerës së plotë të tij, sipas udhëzimeve të buxhetit.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**21.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit/infrastrukturore, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga ana e DPKZHT-së janë marrë masa për shqyrtimin e detajeve dhe kushteve teknike për të gjithë projektet e objekteve të planifikuara për pajisjen me leje Ndërtimi/Infrastrukturore.

**Statusi:**

**Zbatuar**

**22.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vorë, të marrë masa që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të respektohen distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga ana e DPKZHT-së, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, vihet re se janë marrë masa për respektimin e distancës ndërmjet objekteve, duke respektuar distancat ndërmjet pronave kufitare, distancat nga kufiri i rrugës, nga objektet ekzistuese si dhe duke respektuar lartësitë e objekteve, vetëm për një pjesë të lejeve të ndërtimit. Ndërsa pjesa i takon pjesës tjetër të lejeve, nuk është respektuar plotësisht distanca, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**23.1. Rekomandim:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Vorë, të merren masa që në shqyrtimin e lejeve ndërtimit të saktësohen volumet e pasqyruar në projektin e ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe respektimin e kriterëve sipas pasaportës së njësive strukturore.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga ana e DPKZHT-së janë marrë masa që të gjitha lejet e miratuara të jenë në përputhje me kriteret dhe treguesit e zhvillimit sipas pasaportës së Njësive Strukturore përkatëse, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vorë, të miratuar me Vendim Nr.3, datë 17.05.2019 të KKT-së. Ajo që është evidentuar, pjesa i takon përcaktimit të saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është se nuk janë kryer llogaritje të sakta për të përcaktuar vlerën reale të saj.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,828,092 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,560 lekë pa tvsh** nga BOE “B.” SHPK & “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 804/5 prot datë 15.04.2019, me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ, Rruga e Vromit Ahmetaq, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj BOE “B.” SHPK & “A.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3496 prot., datë 23.06.2023, por nuk ka arkëtuar asnjë pjesë të vlerës prej **591,560 lekë pa tvsh**.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **321,072 lekë pa tvsh** nga BOE “E.” SHPK & “R.” SHPK & “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në

kontratën me nr. 2520/5 prot datë 26.04.2019, me objekt “Rikonstruksion i plotë dhe shtesë e shkollës “Vajdin Lamaj”, Domje”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj BOE “E.” SHPK (ndryshuar në “E.C.” SHPK) & “R.” SHPK & “S.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3503 prot., datë 23.06.2023 dhe ka arkëtuar vlerën e plotë prej **321,072 lekë pa tvsh.**

**Statusi:**

**Zbatuar**

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,001,402 lekë pa tvsh** nga OE “B.I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1298/5 prot datë 03.06.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Muçaj, Sheraj dhe Veselëve, Fshati Muçaj”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj OE “B.I.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3501 prot., datë 23.06.2023, por nuk ka arkëtuar asnjë pjesë të vlerës prej **1,001,402 lekë pa tvsh.**

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **200,675 lekë pa tvsh** nga BOE “S.2.” SHPK & “V.E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1428/5 prot datë 29.05.2019, me objekt “Ndërtimi i kanalit b/a dhe ndriçim në rrugën Miqësia Domje, NjA Bërçull”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj BOE “S.2.” SHPK & “V.E.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3502 prot., datë 23.06.2023, por nuk ka arkëtuar asnjë pjesë të vlerës prej **200,675 lekë pa tvsh.**

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**5.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **252,500 lekë pa tvsh** nga BOE “G.” SHPK & “E.K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1893/5 prot datë 05.06.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Mojre dhe Fioret Gjec Kodër, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj BOE “G.” SHPK & “E.K.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3497/1 prot., datë 10.07.2023, por nuk ka arkëtuar asnjë pjesë të vlerës prej **252,500 lekë pa tvsh.**

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **271,405 lekë pa tvsh** nga OE “4.A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 377/5 prot datë 05.04.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Pashtriku dhe ndërtimi i rrjetit KUZ, Rruga e Liqenit, NjA Bërçullë, Domje”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj OE “4.A.” SHPK bazuar në shkresën nr. 3500 prot., datë 23.06.2023, por nuk ka arkëtuar asnjë pjesë të vlerës prej **271,405 lekë pa tvsh.**

#### **Statusi:**

#### **Pjesërisht i zbatuar**

**7.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **189,478 lekë** nga Shoqëria S. ShPK, në cilësinë e zhvilluesit në lejen e ndërtimit me nr. 8256/5 prot datë 17/12/2020 me objekt “Kapanon 1 kat, zyra 2 kat dhe mur rrethues”, në adresën Muçaj, Bashkia Vorë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Bashkia Vorë ka bërë njoftimin në formë shkresore ndaj shoqërisë S. shpk, bazuar në shkresën nr. 5630 prot., datë 07.10.2022, për objektin “Kapanon 1 kat, Zyra 2 kat dhe mur rrethues”, ku është konstatuar shtim i numrit të kateve, që çon edhe në shtim të sipërfaqes totale të ndërtimit nga 1702 m<sup>2</sup> në 1928.56 m<sup>2</sup>, për kryerjen e pagesës së diferencës së munguar të Taksës së ndikimit në Infrastrukturë, në vlerën **252,636.82 lekë. Kjo vlerë ka rezultuar nga llogaritjet që ka bërë vetë** Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Vorë, të paraqitura edhe në shkresën Relacion me Nr. 77 prot., datë 17.07.2023 (gjendet në aneksin nr.1), në të cilën paraqiten llogaritjet e detajuara si vijon:

- Kosto totale e ndërtimit të objektit e përlogaritur duke marrë si referencë koston për m<sup>2</sup> të Entit të banesave, 1928.56 m<sup>2</sup> (sip. totale objektit e konstatuar nga KLSH) x 32,113 lekë/m<sup>2</sup> = **61,931,847.28 lekë.**
- Taksë vendore e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (leje ndërtimi):  
3% e koston së ndërtimit (61,931,847.28 lekë \* 3% = **1,857,955.42 lekë**)
- Tarifë vendore për kërkesë “për leje punimesh” jo publike për studimet e reja: 1% e Koston së ndërtimit (61,931,847.28 lekë \* 1% = **619,318.5 lekë**)
- Totali: 1,857,955.42 lekë + 619,318.5 lekë = **2,477,273.92 lekë.**
- Nga shuma prej 2,477,273.92 është bërë diferenca me pagesën e kryer në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit, në vlerën 2,224,637.1 lekë (2,477,273.92 lekë - 2,224,637.1 lekë = **252,636.82 lekë**).

Vlera prej **252,636.82 lekë** është arkëtuar nga Bashkia Vorë, bazuar në mandatin e arkëtimin të datës 13.01.2023.

#### **Statusi:**

#### **Zbatuar**

**D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 164,353,316 lekë.** Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Vorë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ka marrë masa për të dërguar informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet”, por jo në mënyrë periodike.

Përsa i takon arkëtimin të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet debitorë, për ndërtimet e reja që janë legalizuar, vlera prej 164,353,316 lekë, që është lënë si rekomandim

për tu arkëtuar, rezulton se kjo vlerë është llogaritur në mënyrë jo të saktë nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Ky fakt është shpjeguar në mënyrë të detajuar edhe në Realcionin Nr. 78 prot., datë 21.07.2023, të përgatitur nga kjo drejtori. Në relacionin e sipërpërmendur, citohet se “...nga informacioni i dhënë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, lidhur me listën e debitorëve të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për objektet e legalizuara, është bërë një gabim në llogaritjen e vlerës totale të të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë. Është dhënë informacioni për vlerën 164,353,316 lekë, por nga verifikimet e kryera rezultoi se vlera totale e të ardhurave të munguara nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për objektet e legalizuara është në vlerën **38,462,958.18 lekë**”. Përsa i takon vlerës së saktë, referuar relacionit, ka rezultuar nga llogaritjet si më poshtë:

| Informacioni i dhënë gabim (Realcioni nr. 78, datë 21.07.2023) |                    |                     |                    |                    |
|----------------------------------------------------------------|--------------------|---------------------|--------------------|--------------------|
|                                                                | Vorë               | Bërxullë            | Prezë              | Total / Vite       |
| Gjendje në 01.01.2019                                          | 142,423,933        | 7,885,043.1         | 3,363,876.9        | 153,672,853        |
| Janar - Dhjetor 2019                                           | 2,134,936.5        | 946,121.2           | 873,537.8          | 3,954,595          |
| Janar - Dhjetor 2020                                           | 453,853.0          | 324,405.5           | 109,344.8          | 887,603            |
| Janar - Dhjetor 2021                                           | 3,182,807.7        | 1,192,628.7         | 1,462,827.4        | 5,838,264          |
| TOTAL                                                          | <b>148,195,530</b> | <b>10,348,198.5</b> | <b>5,809,586.9</b> | <b>164,353,316</b> |

| Informacioni i saktë (Realcioni nr. 78, datë 21.07.2023) |                      |                      |                     |                      |
|----------------------------------------------------------|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|
|                                                          | Vorë                 | Bërxullë             | Prezë               | Total / Vite         |
| Gjendje në 01.01.2019                                    | 14,208,883.40        | 7,863,463.20         | 3,350,726.60        | 25,423,073.20        |
| Janar - Dhjetor 2019                                     | 2,134,936.50         | 3,262,094.80         | 873,537.80          | 6,270,569.00         |
| Janar - Dhjetor 2020                                     | 453,853.00           | 324,405.50           | 109,344.80          | 887,603.30           |
| Janar - Dhjetor 2021                                     | 3,226,256.60         | 1,192,628.60         | 1,462,827.40        | 5,881,712.60         |
| TOTAL                                                    | <b>20,023,929.50</b> | <b>12,642,592.10</b> | <b>5,796,436.60</b> | <b>38,462,958.20</b> |

Nga ana tjetër vihet re se, nga DPKZHT janë kryer rinjoftime mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për objektet e legalizuara, për të gjithë listën e debitorëve, bazuar në llogaritjen e vlerës së saktë që është për tu arkëtuar nga secili prej tyre, por ende nuk ka filluar të arkëtohet asnjë pjesë nga totali prej **38,462,958.20 lekë**. Gjithashtu kjo drejtori ka marrë masa për të nisur bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë, deri në momentin e kryerjes së pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

#### **Statusi:**

#### **Pjesërisht i zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 29,250,000 lekë.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarivave Vendore dhe IMT rezulton se, IMT ka proceduar me zbatimin e sanksioneve ligjore për debitorët, deri në lidhjen e marrëveshjes me përmbaruesin privat, për arkëtimin e shumës së debisë, por ende nuk është arkëtuar asnjë pjesë nga totali prej 29,250,000 lekë.

#### **Statusi:**

#### **Pjesërisht i zbatuar**

**3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **213,133,571 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, subjektet debitore janë njoftuar për detyrimet e prapambetura, në mënyrë të vazhdueshme dhe janë kontaktuar në terren për rikujtimin e debisë. Gjithashtu është ridërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare pranë bankave të nivelit të dytë për të gjithë subjektet debitore, me shkresën Nr.312 prot., datë 18.11.2022. Gjatë vitit 2022 janë arkëtuar **8,148,962 lekë** të prapambetura nga subjektet debitore nga të cilat (5,007,721 lekë nga biznesi i madh dhe 3,141,241 lekë nga biznesi i vogël), vlerë e cila i zbritet shumës totale të debisë për kategorinë biznes prej 187,018,135 lekë. Nga kategoria biznes kanë mbetur ende pa u arkëtuar **178,869,079 lekë**. Ndërkohë nga kategoria familje nuk është arkëtuar ende asnjë taksë dhe tarifë, nga shuma totale prej 26,115,530 lekë, për këtë kategori.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **11,072,761 lekë** ndaj Bashkisë Vorë.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Tatim Taksave Vendore ka marrë masa duke njoftuar të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet “Karburant”, për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit. Nga totali i shumës prej 11,072,761 lekë, deri tani është arkëtuar vlera 1,800,000 lekë dhe ka mbetur ende pa u arkëtuar vlera **9,272,761 lekë**.

**Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

**E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1.-6.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë me pasojë lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën totale të prokurimit **180,842 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezultoi se:**

Nga Bashkia Vorë, përsa i takon analizimit dhe nxjerrjes së përgjegjësisë për kualifikimin e ofertave, të cilat bazuar në rekomandimin e lënë, janë evidentuar që nuk kanë plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të kualifikuar, në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, janë marrë masa disiplinore për punonjësit përgjegjës, bazuar në Urdhër Nr. 234, datë 30.12.2022, nr. 7554 prot., “Për zbatimin e masave disiplinore të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Referuar Urdhërit Nr. 15, nr. 393 prot., datë 20.01.2023, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, ndryshuar me Urdhër Nr. 69, nr. 3808 prot., datë 14.07.2023, në Bashkinë Vorë është krijuar grupi i komisionit disiplinor i përbërë nga 1 (një) kryetar dhe 4 (katër) anëtarë.

Bazuar në Vendim nr. 3879 prot., datë 20.07.2023, komisioni vendosi për dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vit” për 3 (tre) punonjës, konkretisht për z. R.M., me detyrë Drejtor pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore; z. A.P., me detyrë Drejtor pranë Drejtorisë së Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës; dhe z. A.K., me detyrë Përgjegjës pranë Sektorit të Pastrimit dhe Mbikqyrjes së Kontratave në Drejtorinë e Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës.

Gjithashtu nga Bashkia Vorë janë marrë masat për kualifikimin e ofertave ekonomike, për procedurat e prokurimit për vitin 2022, të cilat plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për Prokurimin Publik.

#### **Statusi:**

**Zbatuar**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vorë ka marrë masa për të mos krijuar detyrime të reja. Ndërkohë është hartuar një plan i likuidimit të detyrimeve, bazuar në Vendim Nr. 41, datë 14.07.2022 “Mbi miratimin e planit të likuidimit të detyrimeve të prapambetura për daljen nga gjendja e vështirë financiare për vitin 2022”, në të cilin Bashkia Vorë do bazohet për të likuiduar në vazhdimësi, detyrimet e prapambetura.

#### **Statusi:**

**Pjesërisht i zbatuar**

### **F. MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Vorë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

#### **Nga verifikimi rezultoi se:**

Në bazë të Urdhërit Nr. 15, nr. 393 prot., datë 20.01.2023, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, ndryshuar me Urdhër Nr. 69, nr. 3808 prot., datë 14.07.2023, në Bashkinë Vorë është krijuar grupi i komisionit disiplinor, i përbërë nga 1 (një) kryetar dhe 4 (katër) anëtarë. Komisioni ka propozuar vendosjen e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vit”, për 3 (tre) punonjës, me Vendim nr. 3879 prot., datë 20.07.2023.

#### **Statusi:**

**Zbatuar**

Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve

| Lloji i rekomandimeve                   | Rekomandime të dhëna | Pranuar            |                    |                   |            | Pa pranuar |
|-----------------------------------------|----------------------|--------------------|--------------------|-------------------|------------|------------|
|                                         |                      | Zbatuar plotësisht | Zbatuar pjesërisht | Në proces zbatimi | Pa zbatuar |            |
| Masa organizative                       | 25                   | 9                  | 12                 | 4                 | -          | 0          |
| Masa shpërblim dëmi                     | 7                    | 2                  | 5                  | -                 | -          | 0          |
| Masa për uljen e borxhit tatimor        | 4                    | -                  | 4                  | -                 | -          | 0          |
| Masa për eliminimin e efekteve negative | 2                    | 1                  | 1                  | -                 | -          | 0          |
| Masa disiplinore                        | 1                    | 1                  | -                  | -                 | -          | 0          |

**Punoi:** Grupi i auditimit

### **Në përfundim nga auditimi rezultoi se:**

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Vorë me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, pra në datën 26.03.2023 janë bërë 6 muaj nga data e dërgimit. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se, nga Bashkia Vorë janë marrë disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Përkatësisht:

Është hartuar plani i veprimit me nr. 5669/1 prot., datë 10.10.2022, ku është përcaktuar struktura ose punonjësit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, si dhe janë shprehur mbi pranimin e tyre. Rezultoi se nga 39 rekomandime të lëna në total, janë pranuar plotësisht të gjitha.

### **Masa Organizative**

- Nga 25 masa organizative; 9 rekomandime janë zbatuar, 12 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara, 4 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 0 rekomandime të pazbatuara.

### **Masa Shpërblim Dëmi**

- Nga 7 masa për shpërblim dëmi; 2 rekomandime janë zbatuar dhe 5 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara.

### **Masa për uljen e borxhit tatimor**

- Nga 4 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore; 4 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara.

### **Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike**

- Nga 2 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike; 1 rekomandim është i zbatuar dhe 1 rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

### **Masa Disiplinore**

- Nga 1 masa disiplinore; 1 rekomandim i zbatuar.

### **Në përfundim rezultoi se:**

**Janë zbatuar gjithsej 13 rekomandime**, 9 rekomandime nga masa organizative, konkretisht (2.1, 3.1, 5.1, 9.1, 11.1, 14.1, 15.1, 20.1, 21.1); 2 rekomandime nga masa për shpërblim dëmi, konkretisht (2.1 dhe 7.1); 1 rekomandim nga masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike, konkretisht (1.1-6.1); dhe 1 rekomandim nga masa disiplinore (1.1).

**Janë pjesërisht të zbatuara 22 rekomandime**, 12 rekomandime nga masa organizative, konkretisht (1.1, 1.2, 2.2, 4.1, 6.1, 10.1, 12.1, 13.1, 16.1, 17.1, 22.1, 23.1); 5 rekomandime nga masa për shpërblim dëmi, konkretisht (1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1); 4 rekomandime masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, konkretisht (1.1, 2.1, 3.1, 4.1); dhe 1 rekomandim nga masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike, konkretisht (2.1).

**Janë në proces zbatimi 4 rekomandime**, 4 rekomandime nga masa organizative, konkretisht (7.1, 8.1, 18.1, 19.1)

**Janë të pazbatuara 0 rekomandime.**

Trajtuar gjerësisht në Akt Verifikimin nr. 1, datë 28.07.2023

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.

**Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Vorë ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit. Gjithashtu mos zbatimi i rekomandimeve ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale dhe

pengon për përmirësimin e tyre në dobi të komunitetit, në mospërdorimin me efikasitet të fondeve të saj si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Vorë.

**Shkak:** Mos ndjekja e të gjitha procedurave nga ana e njësive përgjegjëse, të Bashkisë Vorë, për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 28.07.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore, për zbatimin e plotë të rekomandimeve që kanë rezultuar me statusin në proces zbatimi dhe pjesërisht zbatuar.

**Nga sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, rikërkon si më poshtë vijon:**

- **Masa Organizative**

**1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përkrahimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësive.

- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

***Menjëherë***

**1.2. Rekomandim:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive.

***Menjëherë***

**2.2. Rekomandim:** Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vorë.

***Menjëherë***

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentojë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

***Menjëherë***

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

### *Menjëherë*

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Vorë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin e informacionit për nevojat vjetore, me qëllim planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Vorë gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

### *Menjëherë*

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

### *Në vazhdimësi*

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.230 dhe nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212/202 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

### *Menjëherë*

**16.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**17.1. Rekomandim:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Bashkia Vorë, të marrë masa për shmangien e kritereve të tilla, të cilat nuk mbështeten në kritere ligjore, por krijojnë pengesë për operatorët ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**18.1. Rekomandim:** Komisionet apo personat e ngarkuar për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, të marrin masa në procedurat në vijim që kërkesat për punë të ngjashme të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, duke mos shtuar apo modifikuar në forma të tjera jo ligjore.

### *Në vazhdimësi*

**19.1. Rekomandim:** Titullari i AK, të marrë masa që në çdo procedurë prokurimi, të përcaktojë minimalisht 1 person i cili të jetë specialist i fushës që lidhet me objektin e prokurimit, kjo për të hartuar kritere të përshtatshme dhe në përputhje me objektin që prokurohet.

*Në vazhdimësi*

**22.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vorë, të marrë masa që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të respektohen distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**23.1. Rekomandim:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Vorë, të merren masa që në shqyrtimin e lejeve ndërtimit të saktësohen volumet e pasqyruar në projektin e ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe respektimin e kritereve sipas pasaportës së njësive strukturore.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

• **Masa për shpërblim dëmi**

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,560 lekë pa tvsh** nga BOE “B.” SHPK & “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 804/5 prot datë 15.04.2019, me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ, Rruga e Vromit Ahmetaq, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,001,402 lekë pa tvsh** nga OE “B.I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1298/5 prot datë 03.06.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Muçaj, Sheraj dhe Veselëve, Fshati Muçaj”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **200,675 lekë pa tvsh** nga BOE “S.2.” SHPK & “V.E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1428/5 prot datë 29.05.2019, me objekt “Ndërtimi i kanalit b/a dhe ndriçim në rrugën Miqësia Domje, NjA Bërxull”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**5.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **252,500 lekë pa tvsh** nga BOE “G.” SHPK & “E.K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1893/5 prot datë 05.06.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Mojre dhe Fioret Gjec Kodër, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **271,405 lekë pa tvsh** nga OE “4.A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 377/5 prot datë 05.04.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Pashtriku dhe ndërtimi i rrjetit KUZ, Rruga e Liqenit, NjA Bërxullë, Domje”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

• **Masa për uljen e borxhit tatimor**

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë 164,353,316 lekë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Vorë të

bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

#### **Shënim:**

Përsa i takon arkëtimin të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet debitore, për ndërtimet e reja që janë legalizuar, vlera prej 164,353,316 lekë, që është lënë si rekomandim për tu arkëtuar, rezulton se kjo vlerë është llogaritur në mënyrë jo të saktë nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Ky fakt është shpjeguar në mënyrë të detajuar edhe në Realcionin nr. 78 prot., datë 21.07.2023 (aneksi nr.2), të përgatitur nga kjo drejtori. Në relacionin e sipërpërmendur, citohet se “...nga informacioni i dhënë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, lidhur me listën e debitorëve të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për objektet e legalizuara, është bërë një gabim në llogaritjen e vlerës totale të të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë. Është dhënë informacioni për vlerën 164,353,316 lekë, por nga verifikimet e kryera rezultoi se vlera totale e të ardhurave të munguara nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për objektet e legalizuara është në vlerën **38,462,958.18 lekë**”.

Pra vlera e saktë që duhet të arkëtohet është **38,462,958.18 lekë** (Realcioni Nr. 78 prot., datë 21.07.2023, aneksi nr. 2).

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 29,250,000 lekë.

#### ***Menjëherë***

**3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **213,133,571 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **11,072,761 lekë** ndaj Bashkisë Vorë.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

#### **• Masa për eliminimin e efekteve negative**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Vorë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

#### **2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit**

Me shkresën e protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 657, datë 17.07.2023, z. P.P., ka paraqitur kërkesë për marrjen e pagesës si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë e Klubit të Futbollit Vora Sh.A., ku Bashkia Vorë është ortak i vetëm.

#### **Kronologjia e ngjarjes parashtuar nga z. P.P.:**

Z. P.P. në kërkesën e tij parashtroi se: Në periudhën 01 qershor 2021 – 04 prill 2022 ka punuar në pozicionin e këshilltarit ekonomik në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë Vorë. Njëkohësisht nga data 12 nëntor 2021 dhe aktualisht, jam anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë e Klubit të Futbollit Vora Sh.A., ku Bashkia Vorë është ortak i vetëm.

Që nga data 12.11.2021 e në vazhdim nuk kam marrë asnjë pagesë si anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës me pretendimi se Klubi nuk ka patur mundësi financiare, megjithëse është financuar rregullisht nga Bashkia.

Kërkoj që konform legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregëtare, me ndihmën e grupit të auditimit të bëhen verifikimet përkatëse, për të bërë të mundur pagesat mujore si anëtar i Këshillit të Mbikëqyrës që nga data 12.11.2021 e në vazhdim.

#### Verifikimi i Ankesës

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vorë sipas Programit të Auditimit nr. 520/1 prot., datë 20.06.2023 i ndryshuar, rezultoi se z. P.P. në periudhën 01 qershor 2021 - 04 prill 2022 ka punuar në pozicionin e Këshilltarit Ekonomik në Kabinetin e Kryetarit të Bashkisë Vorë. Njëkohësisht nga data 12 nëtor 2021 është emëruar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë e Klubit të Futbollit Vora sh.a, ku Bashkia Vorë është ortak i vetëm.

Që nga data 12.11.2021 e në vazhdim nuk ka marrë asnjë pagesë si anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës.

Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria e Klubit të Futbollit Vora Sh.A., dokumentacionit që disponon zyra e protokollit dhe Drejtoria e Financës-Buxhetit të Bashkisë Vorë rezultoi se z. P.P. është emëruar Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Klubit të Futbollit Vora Sh.A. me Vendimin nr. 421 datë 12.11.2021 të Aksionerit të vetëm të shoqërisë, Bashkia Vorë. Në datën 19.07.2023 z. Perhati ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga ai pozicion.

Me Vendimin nr. 71 datë 19.07.2023 të Aksionerit të vetëm të shoqërisë Bashkia Vorë është vendosur largimi i tij nga pozicioni i Anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Klubit të Futbollit Vora Sh.A. Në lidhje me kërkesën e tij për të bërë të mundur pagesat mujore si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës që nga data 12.11.2021 e në vazhdim, sipas raportit “*Për miratimin e pasqyrave Financiare të shoqërisë për vitin financiar të mbyllur me 31.12.2022*”, rezultati financiar i Klubit të Futbollit Vora sh.a për vitin 2022 është në vlerën 0 (zero) lekë.

Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare*” neni 160, pika 3 parashikon:

“1. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.”

Rezulton se rezultati financiar i Klubit të Futbollit Vora Sh.A., për vitin 2022 është në vlerën 0 (zero) lekë. Gjithashtu në nenin 161 “*Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme*”, pika 3 parashikon:

#### **2. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari.**

Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e mara. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të mara. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë marrë asnjë vendim nga Këshilli Mbikëqyrës i Klubit të Futbollit Vora sh.a dhe as të jetë mbajtur procesverbal për mbledhjet e tij.

Bazuar sa më sipër dhe pikës 3 të nenit 161, të rregullores së brendshme të Bashkisë Vorë, rezulton se z. Perhati nuk ka të drejtë në ankesën e tij.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Vorë, nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, rezultoi se:

- Për vitin 2022, nuk ka pasur një urdhër specifik ku të përcaktohej koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik.
- Mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve, për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj, nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.
- Nuk është përgatitur harta e proceseve të punës, gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të institucionit.
- Nuk është hartuar plani vjetor i punës për drejtorinë e financës, strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut.
- Përsa i takon trajnimeve të punonjësve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Vorë, nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuar fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, nenet 8, 10, 16, 27 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pikat 3.3 dhe 3.5.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij; të përditësojë dhe të forcojë aktivitetin e GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut; të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vorë rezultoi se:

- Për vitin 2022, struktura e NjAB nuk ka funksionuar siç parashikohet në strukturën organizative të miratuar nga titullari i institucionit për këtë vit dhe sipas specifikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Si rrjedhojë, rezultoi se NjAB e Bashkisë Vorë për vitin 2022 ka qenë e paplotësuar pasi ka pasur vetëm 2 (dy) specialistë dhe nuk ka pasur një Përgjegjës.
- Përsa i përket dërgesës së Kartës së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Vorë nuk rezultoi një shkresë përcjellëse, ku të pasqyrohet dërgesa e saj në MFE.
- Për auditimet e realizuara nga NjAB gjatë vitit 2022, është evidentuar se në dosjet e auditimit ka pasur mungesi të dokumentacionit shkresor standard, që çdo dosje e auditimit duhet të ketë, bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.
- Përsa i takon dosjes së përhershme të auditimit, nuk është krijuar manualisht ose elektronikisht.
- Referuar pasqyrave bashkëlidhur Raportit të Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, janë vënë re pasaktësi në paraqitjen reale të numrit të rekomandimeve të lëna, nga NjAB e Bashkisë Vorë, gjatë auditimeve që janë realizuar gjatë vitit 2022.
- Nuk është hartuar Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 10; Neni 14, pika b); VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njesisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik*”, pika 3; Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për të plotësuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm sipas strukturës me auditues të kualifikuar, me qëllim përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave.

Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm, duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

***Në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin e programeve sipas prioriteteve vendore dhe institucionale, u konstatua se:

1. Janë bërë lëvizje të shpeshta të personelit të kësaj drejtorie veçanërisht ai në pozicionin e drejtorit, të cilat ndikojnë në performancën e aktivitetit të njësisë, duke cenuar realizimin e procedurave brenda afateve kohore dhe sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore;

2. Në PBA-në 2022-2024 dhe Planin vjetor të buxhetit për vitin 2022, nuk janë shprehur qartë objektivat strategjike të bashkisë, të cilat mbështetur në PPV dhe PZHS, bëjnë planifikime buxhetore për ato programe të cilësuar si më prioritaret me projektet përkatëse. Në VKB nr. 99 datë 24.12.2021, PBA 2022-2024/Plani i buxhetit vjetor 2022 nuk janë paraqitur për miratim edhe projektet me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në moszbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 29.

3. Nga Këshilli bashkiak nuk është miratuar “*Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Buxhetit vjetor*” për Bashkinë Vorë dhe njësive të varësisë/administrative për vitin 2022, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*” neni 33;

4. Nga Bashkia Vorë, PBA 2022-2024 dhe Planin vjetor i buxhetit 2022 janë hartuar/miratuar së bashku, duke mos hartuar dhe miratuar veçmas Planin Vjetor, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 29;

5. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime. Por nga auditimi rezultoi se VKB-të nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të Bashkisë Vorë, në moszbatim të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*” neni 23, 24; “*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*” neni 13 dhe neni 19; si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “*Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë*.”

6. Planin buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor. Por u konstatua se mungesa e hartimit veçmas të planit vjetor buxhetor 2022 që është dhe viti i parë i PBA-së, ka sjellë mungesën e pasqyrimin të detajuar të tij në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli për çdo muaj, në moszbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar.

7. Nga aktrakordimi vjetor me Thesarin rezultoi se ka një mopërputhje të vlerës së planifikimit të shpenzimeve. Kështu sipas Thesarit plani i buxhetit është 2,207,302,535 lekë, ndërsa sipas Financës 2,211,987,000 lekë, me një diferencë prej 4,684,465 lekë. Nga grupi i KLSH-së u kërkua një informacion për këtë diferencë. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dha këtë përgjigje: “*Gjatë kontrollit të formulave të mbledhjes është pa përfshirë në shumatore vlera 3.880.850 lekë*”. Mbetet e pa përfshirë dhe njëherësh e pajustificuar vlera 803,615 lekë.

8. Bashkia Vorë nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programit 042 “*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe*

gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 056 “Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me 051 “Menaxhimi i mbetjeve”; 036 “Marrëdhëniet në komunitet”, 041 “Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”; mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

9. Për hartimin e PBA dhe projekt buxhetit vjetor 2022, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës, duke mos marrë drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë dhe nevojat e komunitetit nëpërmjet komunikimit dhe konsultimit publik, duke mos zbatuar korrektësisht kërkesat e nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, të paraqesin për miratim në Këshillin Bashkiak së bashku me PBA-të edhe Planin vjetor dhe projektet e planifikuara për buxhetim, me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore në çdo program; duke planifikuar në buxhet fonde për ato programe të cilat janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare dhe duke hartuar një plan buxhetimi vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### **Menjëherë e në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi mosrealizimin e planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore u konstatua se:

1. Ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre; kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme, duke bërë që buxheti për vitin 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie;

2. Nuk janë bërë raportimet 4 dhe 8 mujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por është bërë vetëm raportimi vjetor (12 mujor) sipas formateve të përcaktuara nga MFE, me shkresë nr. 2354 prot., datë 26.04.2023. Kjo në kundërshtim me nenin 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

3. Me VKB nr. 99 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” është miratuar Fondi Rezervë në vlerën 15,452 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës në 6,645.9 mijë lekë, që në total janë në vlerën 22,097.9 mijë lekë. Referuar Ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74% e vlerës që duhej të planifikohej dhe se për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur.

4. Referuar kriterëve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e tij nga ana e Pushtetit Vendor/Bashkitë, rezultoi se për vitin 2022 fondi për emergjencat civile është planifikuar në vlerën 29,696 mijë lekë, nga i cili nuk ka patur shpenzime dhe është trashëguar për vitin pasardhës.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të

kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1, që nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 38,967.3 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 9,271.3 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 76.2% të vlerës që duhej planifikuar. Së bashku me fondin e emergjencës arrin vlerën 36,341.9 mijë lekë ose (-)2,625.4 mijë lekë më pak dhe që përbën 93% të fondit që duhet të planifikonte Bashkia Vorë për këtë zë buxhetor.

5. Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total vjen në rënie nga viti 2021 në vitin 2022; investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit në vlerën (-) 146,754.8 mijë lekë; si dhe në krahasim me vitin 2021 ky mosrealizim ka një rritje prej (-) 13,091.5 mijë lekë. Ky konstatim, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar, por kanë ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Në Bashkinë Vorë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

**Menjëherë e në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Mbi nivelin e realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre; Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

1. Ndonëse struktura e DTT Bashkia Vorë është e plotë në numër dhe aktiviteti i saj është i planifikuar dhe i organizuar, nga auditimi rezultoi se ka probleme në vjeljen e të ardhurave dhe nuk ka patur efektivitet, pasi evidentohet një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitore). Kjo e ka burimin në mosplotësimin e kriterëve të veçanta që duhet të plotësojnë 3 prej punonjësve të kësaj strukture dhe pozicioni i “specialist verifikimi” i mbetur vakant që prej vitit 2020, për arsye transferimi në Drejtorinë e Bujqësisë. Referuar fushës së veprimtarisë së DTT, detyrave dhe përgjegjësive që ka, personeli përbërës i saj duhet të ketë profil financiar-ekonomik; Edhe pse në përbërjen e saj është një specialist me profil arsimor IT, nuk është bërë e mundur implementimi i një Sistemi për administrimin e informacionit tatimor të Bashkisë Vorë, e krijimit të një regjistri të plotë elektronik të subjekteve taksapaguese si dhe në mosevidentimin në kohë reale të subjekteve (ose vonesa në evidentimin e tyre), mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mosdeklarime si dhe vonesa në arkëtimin e të ardhurave, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, si dhe Rregulloren e brendshme të bashkisë, miratuar me shkresën nr. 6910 prot., datë 01.12.2022;

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, në mungesë të një databaze të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, me një informacion të plotë të tyre në mungesë edhe të një Sistemi IT, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit, kjo ka çuar në mos llogaritje të tatimit dhe për vitet 2021 e 2022 është vjelë respektivisht 3,134 mijë lekë dhe 716 mijë lekë; Taksa e kalimit e të drejtës në

pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë dhe në vitin 2022 ka mundur të realizojë vjeljen e taksës në vlerën 9,502 mijë lekë ose 1,102 mijë lekë më shumë se planifikimi. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë;

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Vorë, nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Nuk ka bashkëpunim të DTT me UK Vorë për të marrë mbi vete rolin e agjentit tatimor dhe deri në fund të vitit 2022 Akt rakordimet me agjentët tatimorë UK Vorë dhe ASHK nuk janë mbajtur;

- Akt rakordime me DRSHTRR nuk janë mbajtur, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve dhe gjendjes në thesar, por nga ana e Bashkisë Vorë nuk është konfirmuar baza e të dhënave statistikore mbi të cilën janë bërë llogaritjet dhe është vlerësuar niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime të cilat janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Neni 117, UMF Nr. 26, datë 04.09.2008 “*Për Taksat Kombëtare*”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

3. Në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 214 dhe me nr. 6910 prot., datë 01.12.2022, nuk është përcaktuar personi të cilit i ngarkohet detyrë për ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët;

- Në zbatim të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “*Të ardhurat nga taksat e ndara*” të Ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njëjësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. U konstatua se rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nuk janë kryer, por informacioni përftohet nëpërmjet rakordimeve mujore me Degën e Thesarit.

- Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “*Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël*” Vorë e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. U konstatua se nuk bëhen rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për efekt të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, por nga ana e DRT Tiranë çdo muaj nëpërmjet shkresave zyrtare, vihet në dijeni Bashkia Vorë.

- Rakordimet me ASHK, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer, në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar.

4. Në Bashkinë Vorë, ndonëse numri i regjistrimeve të bizneseve të reja (të përhershme dhe sezonale) ka ardhur në rritje dhe rezulton më i lartë se i atyre të mbyllura, përsëri mbetet i lartë relativisht numri i bizneseve të mbyllura (117). Për këtë nga ana e Bashkisë Vorë, Koordinatori i Riskut, GMS, Drejtoria e Taksave e Tarifave, nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që vilen nga aktiviteti i tyre; Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, njoftimet mbi detyrimet dhe pagesat bëhen me shërbim postar ose dorazi, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që u kërkuar, rezultoi se informacionet e vëna në dispozicion, nuk janë analizuar si në total ashtu edhe për çdo zë tatimor nga ana e DTT/ Bashkia Vorë.

5. Janë 509 përfitues, të cilët nuk paguajnë “*taksën mbi ndërtesën*”. (lista e detajuar në aneksin

e Akt Konstatimit). Nga verifikimi me zgjedhje rastësore të dosjes së disa përfituesve, rezultoi se dokumentacioni ishte dorëzuar konform kërkesave të përcaktuara në VKB. U konstatua se nga ana e DTT Vendore Vorë nuk është vendosur vlera e taksës për çdo përfitues dhe rrjedhimisht nuk është llogaritur vlera totale e saj, si një përfitim financiar i komunitetit;

- Përfitojnë lehtësira dhe përjashtohen nga taksa “*mbi kalimin e të drejtës së pronësisë*” për pasuritë e paluajtshme 3 kategori. Kjo taksë vilet nga ASHK, në rolin e agjentit tatimor e cili përfiton një komision prej 3% të shumës së arkëtuar. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore Vorë. U konstatua mungesa e dhënies së informacionit nga kjo drejtori nëse ka përfitues, pasi si edhe më lart është shprehur mungesa e akt rakordimeve me ASHK;

- Nga auditimi u konstatua se Sektori Taksa e Tarifa/Bashkia Vorë nuk ka pasqyruar një informacion të plotë për përfituesit nga “*tarifa e pastrimit*”, duke mos përlllogaritur vlerën e tarifës së plotë që duhet të paguanin këta përfitues në rast se nuk do të klasifikoheshin në kategoritë përfituese të mospagesës /lehtësira të tarifës së pastrimit. Kjo për të analizuar efektin financiar që ka në buxhetin e bashkisë nga njëra anë, dhe atë social për komunitetin nga ana tjetër;

- Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira nga “*Tarifa e shitjes së tokës bujqësore*” për këto raste: kalimi nga një fermer i regjistruar te një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor; brenda lidhjes gjinore familjare, kur dhurohet apo hiqet dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “*Për tokën*” i ndryshuar. Kjo tarifë vilet nga Drejtoria e Administrimit, menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës. Nga auditimi u konstatua mungesë informacioni;

- Përfitojnë lehtësira nga Tarifa e Çertifikatës së përdorimit - niveli “a”<sup>18</sup>, të gjitha Agrobizneset që do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Vorë, duke e vlerësuar si një stimul për investime në prodhime bujqësore e blegtorale. Kjo tarifë vilet nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit. Nga auditimi u konstatua mungesë informacioni.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave/Bashkia Vorë të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukture, për miradministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

**5.2. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

**5.3. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë të caktojë një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor.

**5.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Vorë të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Vorë nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Vorë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

**5.5. Rekomandimi:** Bashkia Vorë dhe drejtoritë përgjegjëse të marrin masat për të krijuar si

---

<sup>18</sup> Niveli a-150 lekë/m<sup>2</sup> për të gjithë sipërfaqen e pronës që do të konvertohet nga tokë arë në truall

praktikë të punës së tyre, procedurën e përlllogaritjes së vlerës së detyrimeve për ato taksa e tarifa, të cilat bazuar në VKB për miratimin e paketës fiskale vjetore, përjashtojnë disa kategori sociale, kjo për të analizuar efektin financiar që ka në buxhetin e bashkisë nga njëra anë, dhe atë social për komunitetin nga ana tjetër.

**5.6. Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të analizojnë situatën e detyrimeve të atij grupi debitorësh familjarë dhe biznesi, objektet e banimit apo të ushtrimit të aktivitetit tregtar të të cilëve, janë dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, me qëllim hartimin e një plani masash për të definuar statusin e debisë për këtë kategori debitorësh.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analizave të llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, u konstatua se në fund të vitit 2021 paraqitej në vlerën 98,503,377 lekë dhe për periudhën ushtrimore 2022 paraqitej në vlerën 101,503,377 lekë. Diferenca e vitit ushtrimor 2022 me atë paraardhës prej 3,000,000 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15% e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2021. Vlera prej 101,503,377 lekë e mbetur në fund të vitit 2022, duhet të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” si dhe nënvlerësimin e “*Aktiveve Afatgjata Materiale*” në shumën 101,503,377 lekë. Sa më sipër, është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*” Pika 2, Klasa 2, “*Aktivet afatgjata*” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”, Seksioni II “*Aktivet e Qëndrueshme të Patrupëzuara*”, Pika 1/b “*Klasifikimi kontabël*”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 56-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vorë, të marrë masat për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilin është kryer investim mbi bazën e projekt-studimeve, si dhe të sistemohet edhe llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për vlerën 101,503,377 lekë.

### ***Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të Bashkisë Vorë, u konstatua se nuk ka një regjistër të plotë për aktivet “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Mungesa e një regjistri të plotë aktivesh sjell problematika në kryerjen e një procesi të saktë inventarizimi dhe vlerësimi aktivesh, për shkak të mungesës së informacionit mbi amortizimin e akumuluar, vlerën e tyre dhe kostot nëse mbahen apo nxirren jashtë përdorimi. Sa më sipër, është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 26 dhe pika 30.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 56-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa që nëpërmjet strukturave të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme si dhe të në mënyrë të saktë kryejë kontabilizimin e llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”.

### ***Menjëherë***

**8. Gjetje nga auditimi:** Në mënyrë analitike në llogarinë nr. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në fund të vitit 2022 janë regjistruar aktive me vlerë totale 4,137,982,916 lekë ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 4,175,682,822 lekë. Pra, diferenca prej 37,649,906 lekë nuk është paraqitur në mënyrë analitike në regjistrat e aktiveve në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 26 dhe pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 56-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Vorë, të bëhet rakordimi me regjistrat e aktiveve të Bashkisë Vorë, për llogarinë nr. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,175,682,822 lekë.

#### ***Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, u konstatua se nga ana e Bashkisë Vorë është reflektuar pakësimi i aktiveve, e cila nuk është bërë bazuar në procedurën e asgjësimit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 56-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Vorë të marrë masa në vijimësi për ngritjen e komisioneve të asgjësimit të aktiveve, kur nga komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve janë vlerësuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimi.

#### ***Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, u konstatua se në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet vlera kontabël prej 56,077,560 lekë, vlerë kjo e cila është e parakorduar me degën e thesarit Tiranë. Mosrakordimi i vlerës së llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” ndërmjet Bashkisë Vorë dhe Degës së Thesarit Tiranë rezulton me diferencë në vlerën 167,000 lekë, veprim ky në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 56-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Vorë të marrë masa të menjëhershme për të rakorduar me degën e thesarit llogarinë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, për vlerën 167,000 lekë dhe sistemimin e saj në kontabilitet.

#### ***Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023***

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “*Shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbeturinave për Bashkinë Vorë*” dhe “*Shërbimi i pastrimit të mbeturinave, emergjenca 90 ditë*”, llogaritja e fondit limit është bërë në kundërshtim me VKM-në nr. 319, datë 31.5.2018 “*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve*”, pika 1 “*Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes*”, duke mos aplikuar formulën përkatëse për llogaritjen e banorëve rezidentë. Nga Bashkia Vorë nuk është bërë asnjë studim, në bazë të së cilit të mos merrej në konsideratë formula e dhënë në VKM-në në fjalë. Nga grupi i auditimit u konstatua se edhe zërat e tjerë të preventivit janë rritur në mënyrë fiktive, të paargumentuara dhe të pambështetura në manualët dhe metodikat në fuqi, si p.sh. larja e rrugëve ditën dhe natën jashtë qendrave të banuara, larja e konteinerëve me pajisje të posaçme, mbivendosja e pastrimit të vend-grumbullimit të mbeturinave, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 67-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen

specialistë të fushës të mirëtrajnuar, si dhe të përdoren eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 77, “Kriteret për kualifikim”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve”, pika 5, VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pika 1 “Dispozitat e përgjithshme të modelit të llogaritjes”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 67-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmblidhjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 67-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatuan probleme në lidhje me protokollimin e procesverbaleve, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, nenet 12, 14 dhe 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 67-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Vorë, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Vorë dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për lejen e ndërtimit të objektit “*Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim*”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik nuk pasqyrohen numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet, në bazë të legjislacionit në fuqi. Për lejen e ndërtimit të objektit “*Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate*”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë, në planvendosjen e miratuar nuk janë pasqyruar të dhënat e plota të parametrave të zhvillimit. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 15, pika 1, gërma c, “*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*”;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të gjithë elementët e nevojshëm në planvendosjen e paraqitur, përfshirë numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet ndërtimi i ri dhe të dhënat e sakta të treguesve të zhvillimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim*”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objekteve. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar me VKM nr. 457, datë 29.6.2022, neni 27 ku përcaktohet ndryshimi i nenit 34, distanca minimale midis ndërtimeve, pika 3;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar distancat ndërmjet ndërtimeve dhe të respektohet distanca minimale për aksesin ndërmjet dy ndërtimeve që gjenden përballë njëri-tjetrit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:

1. “*Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim*”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;

2. “*Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate*”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më

sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje me kriteret ligjore dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se në objektin “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë, lartësia e përgjithshme e ndërtimit e tejkalon lartësinë e lejuar, në mospërputhje me kondicionet urbane të përcaktuara sipas njësisë VO\_UB\_A2\_9-1. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 20, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 37, “Lartësia e ndërtimeve”, pika 1, gërma a;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruara në planvendosje, të cilat duhet jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit. Mungon marrëveshja ndërmjet palëve për kontributin e krijimit të fondit publik të banesave sociale, në lejet e ndërtimit me objekte:

1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;

2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” dhe me Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 19.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse për lejet e ndërtimit me objekt:

1. “Ndërtim godinë banimi me dy kate shërbime, 6 Kate Banim dhe dy kate nëntokë parkim”, miratuar me vendimin nr. 3097/5, datë 02.09.2022, me zhvillues “I.I.” ShPK, në Vorë;

2. “Qendër biznesi, magazinë për mallra të konsumit të gjerë 2 kate”, miratuar me vendimin nr. 1981/5, datë 30.08.2022, me zhvillues S.P., J.P., G.P., me adresë Gjokaj, në Vorë. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 14, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të marrë miratimet e nevojshme

nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje ndërtimi dhe të vijohet me miratimin e lejes së ndërtimit pas konformitetit të tyre.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për objektin “Magazinë 1 kat dhe zyra 2 kat me mur rrethues”, miratuar me vendimin nr. 2466/5, datë 16.08.2022, me zhvillues “S.C.” ShPK, në Prezë, Vorë, nuk është konvertuar resursi i tokës nga “arë” në “truall”. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Vendimin nr. 440, datë 3.6.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 410, datë 27.6.2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 6;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Vorë të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi organizimin e IMTV Bashkia Vorë u konstatua se:

1. Struktura e miratuar nuk është në përputhje me kriteret ligjore, pasi vetëm 2 inspektorë plotësojnë kriteret konform kërkesave ligjore për të ushtruar funksionet e Inspektorit të IMTV, ndërsa 6 inspektorët e tjerë përfshirë dhe Kryeinspektorin nuk i plotësojnë kriteret. Personeli i IMTV është punësuar në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

Nga Bashkia Vorë, nuk janë publikuar vendet vakante në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), por njoftimet për punësim bëhen në stendat e bashkisë dhe rrallëherë në rrjetet sociale. Mospublikimi i shpalljes së vendeve vakante në AKPA për IMTV është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19 pika 1,2.

2. Kryeinspektori (i emëruar/i komanduar), për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujorë dhe atë vjetor të punës, në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” dhe pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Vorë, miratuar me Urdhërin nr. 27, me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018 të titullarit të Bashkisë Vorë.

3. Nga auditimi u konstatua se vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të Ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, neni 52, pika 1 germa e), i ndryshuar. Masa e gjobës e caktuar 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet ligjore, masa e gjobës përllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast, kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

4. Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se nuk janë bërë kallëzime penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

5. Nga IMTV nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “vendim pezullimi/vendim për prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii. Nga auditimi rezultoi se nuk ka komunikim dhe bashkëpunim midis Bashkisë Vorë dhe ASHK-së si për marrje informacioni dhe për kërkesë pezullimi të procedurës për legalizim.

6. Nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për

një bashkëpunim dhe administrim me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit e Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ligjore. Megjithatë Bashkia Vorë disponon një ekskavator dhe dy fadroma, në asnjë rast nuk janë përdorur për ekzekutimin e vendimeve të prishjes, nga ana e IKMT nuk është ekzekutuar asnjë vendim, por kjo procedurë i është deleguar IKMT-së. Për mungesë të bashkërendimit me drejtoritë dhe sektorët e tjerë në bashki, nga IMTV nuk është zbatuar Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

7. Nga auditimi rezultoi se nga k/inspektori/ët janë ushtruar inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje, janë përpiluar “proces verbale konstatimi”. Për subjektet e tjera nuk janë përpiluar akte kontrolli, në kundërshtim me nenin 4 dhe nenin 5, germa a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, nenin 51 “Inspektimi” të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, dhe pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 106-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të marrë masa për të plotësuar strukturën e IMTV-së me staf të kualifikuar, kryesisht të profilit inxhinierik dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, si dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, të marrin masa për implementimin e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMTV-së.

Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së të hartojnë e miratojnë te titullari planet mujore e vjetore të aktivitetit të tyre, të mbajnë akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë në ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse dhe jo vetëm, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi: 1.** Bashkia Vorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH, me shkresën nr. 5669/1 prot., datë 10.10.2022, por nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Gjithashtu nga ana e Bashkisë Vorë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit të KLSH-së. Nuk është bërë as raportimi në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2. Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**2.** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara Bashkisë Vorë nga KLSH-ja me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej:

- 25 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 7 masa për shpërblim dëmi;
- 4 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore;
- 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike;
- 1 rekomandim për masa disiplinore, ku vetë subjekti ka caktuar masa për 3 (tre) punonjës.

Janë zbatuar gjithsej 13 rekomandime, 9 rekomandime nga masa organizative, konkretisht (2.1, 3.1, 5.1, 9.1, 11.1, 14.1, 15.1, 20.1, 21.1); 2 rekomandime nga masa për shpërblim dëmi, konkretisht (2.1 dhe 7.1); 1 rekomandim nga masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet,

eficence dhe efektivitet të fondeve publike, konkretisht (1.1-6.1); dhe 1 rekomandim nga masa disiplinore (1.1).

Janë pjesërisht të zbatuara 22 rekomandime, 12 rekomandime nga masat organizative, konkretisht (1.1, 1.2, 2.2, 4.1, 6.1, 10.1, 12.1, 13.1, 16.1, 17.1, 22.1, 23.1); 5 rekomandime nga masat për shpërblim dëmi, konkretisht (1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1); 4 rekomandime nga masat për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, konkretisht (1.1, 2.1, 3.1, 4.1); dhe 1 rekomandim nga masat për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike, konkretisht (2.1).

Janë në proces zbatimi 4 rekomandime, 4 rekomandime nga masa organizative, konkretisht (7.1, 8.1, 18.1, 19.1)

Janë të pazbatuara 0 rekomandime.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 110-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 372/30 prot., datë 26.09.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe të përshpejtojë zbatimin e masave në proces si më poshtë:

**Masa organizative:**

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.2. Rekomandimi:** Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

Gjithashtu në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vorë.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentojë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë në proces zbatimi, si dhe të raportojë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi nivelin e zbatimit të tyre.

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e

akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vorë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.230 dhe nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212/202 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

**16.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Vorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

**17.1. Rekomandimi:** Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Bashkia Vorë, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tilla, të cilat nuk mbështeten në kriterë ligjore, por krijojnë pengesë për operatorët ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

**22.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vorë, të marrë masa që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të respektohen distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve.

**23.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Vorë, të merren masa që në shqyrtimin e lejeve ndërtimit të saktësohen volumet e pasqyruar në projektin e ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe respektimin e kriterëve sipas pasaportës së njësive strukturore.

#### **Masa për shpërbllim dëmi:**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,560 lekë pa tvsh** nga BOE “B.” SHPK & “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 804/5 prot datë 15.04.2019, me objekt “Ndërtim i rrjetit KUZ, Rruga e Vromit Ahmetaj, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,001,402 lekë pa tvsh** nga OE “B.I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1298/5 prot datë 03.06.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Muçaj, Sheraj dhe Veselëve, Fshati Muçaj”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **200,675 lekë pa tvsh** nga BOE “S.2.” SHPK & “V.E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1428/5 prot datë 29.05.2019, me objekt “Ndërtimi i kanalit b/a dhe ndriçim në rrugën Miqësia Domje, NjA Bërxull”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **252,500 lekë pa tvsh** nga BOE “G.” SHPK & “E.K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1893/5 prot datë 05.06.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Mojre dhe Fioret Gjec Kodër, NjA Prezë”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **271,405 lekë pa tvsh** nga OE “4.A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 377/5 prot datë 05.04.2019, me objekt “Sistemim-Asfaltim Rruga Pashtriku dhe ndërtimi i rrjetit KUZ, Rruga e Liqenit, NjA Bërxullë, Domje”, Bashkia Vorë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht

informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 164,353,316 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Vorë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 29,250,000 lekë.

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **213,133,571 lekë** nga taksapaguesit privatë dhe familjarë.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **11,072,761 lekë** ndaj Bashkisë Vorë.

**Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike:**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

*Brenda datës 31 mars 2024*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Vorë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **240,672 lekë me TVSh**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “Sistemim, Asfaltim Rrugëve Kodra e Miut dhe Rindërtimi Fshati Marqinet 2, Bashkia Vorë” u konstatua se është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 831/2 prot. datë 22.02.2022, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B.I.”shpk & “L.K.” shpk. Vlera e kontratës është 63,636,004 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 6 muaj nga fillimi i punimeve. Nga rillogaritja e volumeve të projektit, bazuar sipërfaqeve tërthore me pasaktësi, rezulton vlera prej 134,000 lekë pa TVSH ose 160,800 lekë me TVSH, e përfituar padrejtësisht nga kontraktori për shkak të llogaritjeve të pasakta në projekt. Nga verifikimi i librezës së masave dhe verifikimi në objekt, në të dy krahet e trotuarit pasqyrohen sipërfaqet e akseve, por në përlllogaritje nuk janë zbritur gropat e mbjella me fidanë 80 cm x 80 cm. Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen e trotuarit me 51.2 m<sup>2</sup> dhe me çmimin përkatës 1,300/m<sup>2</sup>, rezulton vlera 66,560 lekë pa TVSH ose 79,872 lekë me TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi **vlera 240,672 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga diferenca faktike

e punës së realizuar dhe punimeve të parealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve, nr. 831/2 prot. datë 22.02.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 67-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Vorë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **240,672 lekë** nga kontraktori BOE “B.I.” shpk & “L.K.” shpk, për punime të likuiduara por të parealizuara.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime u konstatua se:

**1.** Bashkia Vorë për zbatimin e vendimeve gjyqësore ka një vlerë detyrimi të mbartur (progresive) për vitin 2022 prej 8,298,940 lekë, nga të cilat vlera 5,948,139 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt “*dëmshpërblim page*” për largime nga puna të punonjësve në **3** raste dhe 2,350,801 lekë për “*dëmshpërblime të tjera*” i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore për **3** raste; ndërsa vlera prej 2,268,510 lekë e paguar për “shpronësim publik” dhe “dëmshpërblim dëmi” vlerësohet si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të shpronësimit, dëmshpërblim dëmit etj. Pra vlerat e paguara vitet e mëparshme për “*dëmshpërblim page*”, “*shpronësime*”, “*dëmshpërblime*” etj dhe vlera 2,268,510 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 nga Bashkia Vorë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

**2.** Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e çështjeve gjyqësore të cilat janë në “proces”, rezulton se: nga **24** çështje në total, **6** çështje janë me objekt “*shpërblim dëmi*” ose “*përmbushje detyrimi*”, ndërsa **18** çështje janë për vendimet “*largim nga puna*” dhe kanë si objekt të padisë “*shpërblim page*” për ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune me “Kod Pune” dhe “*shpërblim page & kthim në punë*” për ata punonjës që kanë qenë me statusin e nëpunësit civil. Vlera e pretenduar e paditësve me zbardhjen e Vendimit të Gjykatës, është e konsiderueshme dhe riskon rritjen e vlerës së detyrimit të prapambetur të akumuluar.

**3.** Në PBA 2022-2024/Planin vjetor 2022 dhe tabelën e programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “*planifikim për detyrimet e prapambetura*”; kjo ka sjellë që likuiditeti i detyrimeve të prapambetura nga ana e bashkisë Vorë në raport me vlerën e detyrimit, të jetë i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, kjo pasi shoqërohet edhe me lindjen e detyrimeve nga vendime të reja për procese gjyqësore të nisura më parë dhe rrisin pamundësinë për pagesa nga mungesa e fondeve.

**4.** Janë **63** subjekte kreditore ndaj Bashkisë Vorë si “*detyrime për investime*” me **73** fatura në total të palikuiduara, vlera 325,018,779.94 lekë është trashëguar për tu likuiduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve të miratuar me VKB nr. 21/2022; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, Bashkia Vorë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

**5.** Bashkia Vorë është debitore “*për mallra e shërbime*” ndaj 14 subjekteve me 39 fatura në vlerë totale 81,789,394.80 lekë; u konstatua se likuidimi i faturave të prapambetura për mallra

e shërbime të kryera ndër vite, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 50 datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e menaxhimit financiar, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin e riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja, monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e burimeve njerëzore dhe inovacionit të marrin masa dhe të analizojnë rastet e punonjësve të larguar nga puna, të nxjerrin personat përgjegjës me qëllim mospërsëritjen e tyre në në ardhmen, duke parandaluar kështu efektet negative në buxhetin e bashkisë.

*Menjëherë e në vijimësi*

#### **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidentimin e detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2022 sipas programit të auditimit u konstatua se:

1. Nga auditimi i të dhënave, rezulton se *më datën 31.12.2022* për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitorë për debitorët familjarë është në vlerën **275,768,705 lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **65,711,729 lekë**; *për vitin 2022* sipas rakordimit me DTT-në detyrimi (për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është **24,831,031 lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është 227,045 mijë lekë; Vlera prej **275,768,705 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vorë**, nga mosarkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

- Ka një rritje të numrit të debitorëve për “taksën e ndërtesës” e cila deri në 31.12.2022 është në vlerën progresive 26,940,901 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si dhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mosmarrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimit vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur si numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar;

- Realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 2,124,000 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 73%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e debisë është për 1113 familjet debitorë prej 1,926,237 lekë, e cila është e *ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë*;

2. Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se numri i debitorëve ka ardhur në rënie në total dhe për çdo njësi administrative, por konstatohet se numri total i debitorëve të krijuar nga

mospagimi i taksës së “*ndikimit në infrastrukturë*” për periudhën 01.01.2018 deri në 31.12.2022 është i lartë 600 debitorë në vlerën totale të debisë 42,885,729.1 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë.

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të gjitha të dhënat që përmban Vendimi për lejen e legalizimit, por informacioni plotësohet nga Vendimi i ardhur nga ASHK, por në momentin kur debitori paraqet kërkesë për të tërhequr faturën e detyrimit. Kjo sjell mungesën e informacionit paraprak mbi detyrimin e secilit subjekt për “*taksën e ndikimit në infrastrukturë*”.

3. Nga auditimi i detyrimeve të biznesit të vogël dhe të madh, u konstatua se numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Vorë me 183 (122+61) debitorë, NJA Prezë me 77 (43+34) debitorë dhe NJA Bërshull me 63 (54+9) debitorë. Në total për 323 debitorë vlera e debisë progresive bashkë me penalitetin është 47,012,803 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

- Struktura tatimore e Bashkisë Vorë, për asnjë nga subjektet veçanërisht ato të biznesit të madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, është mjaftuar vetëm me njoftimin për pagesën e detyrimeve dhe ka zbatuar një pjesë të procedurave administrative për to, pasi nuk është kërkuar *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 i ndryshuar;

- Lidhur me debitorët objektet ku ushtrojnë aktivitetin e tyre janë dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, rezultoi se nga ana e DTT Bashkia Vorë, iu është bërë kërkesë subjekteve të dëmtuara për të mbyllur (pezulluar) NIPT-in; Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, konstatohet se: janë **2** subjekte debitoare që i përkasin biznesit të madh me një vlerë debie 4,597,089 lekë; janë **68** biznese, objekti ku kanë zhvilluar aktivitetin është dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019; nga këto janë **9** biznese debitoare me vlerën totale të debisë deri më 31.12.2022 prej 479,308 lekë; deri më 31.12.2021 janë **7** biznese debitoare me vlerë të debisë 343,015 lekë dhe gjatë vitit 2022 ky numër është rritur me **2** debitorë të rinj në vlerë totale të debisë për vitin 2022 me 136,293 lekë. Vlera totale **5,076,397** lekë (4,597,089+479,308) është e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë dhe me mundësi të vogël për tu arkëtuar.

- Janë 56 debitorë familjarë, vendbanimet e të cilëve janë shembur nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019. U konstatua se nga ana e Drejtorisë së Taksave e Tarifave/Bashkia Vorë, nuk janë përlllogaritur veçmas detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që kanë për të paguar familjet debitoare për periudhën para dhe pas tërmetit. Nga Titullari i bashkisë dhe GMS nuk është analizuar situata e këtij grupi debitorësh, për të cilët duhet të ishte hartuar një plan masash mbi vijimësinë e statusit të debisë së tyre.

4. Nga aktiviteti i IMTV dhe masat administrative të vendosura prej saj, nga informacioni i vënë në dispozicion u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vorë janë vendosur **23** gjoba me vlerën në total 5,100,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë **114** gjoba në vlerën **41,000,000 lekë**, nga të cilat rezultojnë të likuiduara **31** gjoba në vlerën 4,650,000 lekë; për gjobat e papaguara (të papranuara) janë bërë kërkesat në gjykatë për tu shpallur titull ekzekutiv. Për **2** objektet e dëmtuara nga tërmeti grupit të auditimit nuk iu vu ndonjë dokument në dispozicion mbi procedurën që do vijohet për vlerën debitoare të tyre; Pra vlera prej 36,350,000 lekë konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë;

- Nga të dhënat pasqyruar në tabelën e kontratave të qirasë, rezulton se janë lidhur kontrata qiraje me 4 subjekte, për afate të ndryshme kohore, nga të cilat 3 subjekte kanë paguar detyrimin kontraktor, ndërsa **1** subjekt “V.A.” Sha nuk ka paguar detyrimin i cili deri në 31.12.2022 është në vlerën progresive prej **21,343 \$**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vorë;

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga Bashkia Vorë për vitin ushtrimor 2022/2023 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të pajisura me autorizim, të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se këto 14 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe gjatë vitit 2022 kanë paguar pjesërisht detyrimet në vlerën 1,800,000 lekë total; janë 5 subjekte të papajisura me autorizim të cilat nuk kanë paguar detyrimin dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre; deri në 31.12.2022 është e papaguar vlera 3,200,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munuar për buxhetin e Bashkisë Vorë;

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Bashkia Vorë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit mbi vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore progresive në vlerën totale 275,768,705 lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshime, neni 181 "*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*".
- Drejtoria e Taksa e tarifave Bashkia Vorë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj me qëllim vjeljen e detyrimit në rastet e paraqitjes së tyre për shërbime të ndryshme në sportelet e bashkisë;

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksa e tarifave dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 42,885,729.1 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**1.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksa e Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 14 subjekteve për arkëtimin e vlerës 3,200,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre; si dhe ndaj 5 subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre pa u pajisur me autorizimin përkatës.

**1.4. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksa e Tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për të arkëtuar vlerën progresive prej 21,343 \$, që subjekti "V.A" nuk ka paguar vlerën e përcaktuar në kontratën e qirasë me Bashkinë Vorë.

**1.5. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë zbardhjen e vendimeve për gjobat e vendosura, duke llogaritur edhe kamatëvonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, për të arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Vorë vlerën totale 36,350,000 lekë;

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## **E. MASA DISIPLINORE**

### **E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

**a) Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:**

- |              |                                               |
|--------------|-----------------------------------------------|
| 1. Znj. T.Ç. | 17.11.2020-16.04.2021                         |
| 2. Znj. L.S. | E autorizuar si NZ nga 16.04.2021- 02.02.2022 |
| 3. Znj. A.D. | E autorizuar si NZ nga 02.02.2022-07.03.2022  |
| 4. Z. D.K.   | I autorizuar si NZ 07.03.2022- 15.08.2022     |
| 5. Z. S.B.   | 15.08.2022 e në vazhdim                       |

Në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar,

- Për anomali në planifikimin e buxhetit me të ardhurat e veta, pasi konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore.

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, ndonëse në periudha të pamjaftueshme për të ndjekur gjithë hapat e procedurës nga planifikimi, zbatimi deri te monitorimi/raportimi i Buxhetit vjetor për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024, sipas përcaktimeve në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin vjetor “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; kjo pasi me Urdhër të brendshëm të Titullarit të bashkisë, janë transferuar në pozicione të tjera, duke krijuar vende vakante në këtë drejtori dhe si pasojë edhe procedura me mangësitë apo problematikat e përcjella në Akt konstatim dhe Projekt Raport.

- Për znj. A.D., z. D.K. dhe z. S.B., për mosndjekjen me përgjegjshmëri të aktrakordimeve me thesarin lidhur me diferencën e papërfshirë dhe njëherësh të pajustificuar në vlerën 803,615 lekë.

- Z. S.B., me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, gjithashtu ka përgjegjësi për:

- Mbivlerësimin e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” si dhe nënvlerësimin e “*Aktiveve Afatgjata Materiale*” në shumën prej 101,503,377 lekë;
- Mungesën e një regjistri të plotë të aktiveve “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve;
- Në mënyrë analitike në llogarinë nr. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në fund të vitit 2022 janë regjistruar aktive me vlerë totale 4,137,982,916 lekë ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 4,175,682,822 lekë. Pra, diferenca prej 37,649,906 lekë nuk është paraqitur në mënyrë analitike në regjistrat e aktiveve;
- Nga auditimi i pasqyrës 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” është konstatuar se nga ana e Bashkisë Vorë është reflektuar pakësimi i aktiveve, e cila nuk është bërë bazuar në procedurën e asgjësimit;
- Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” është konstatuar se në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 paraqitet vlera kontabël prej 56,077,560 lekë,

vlerë kjo e cila është e parakorduar me Degën e Thesarit Tiranë;

- Si kryetar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 2 procedura prokurimi;

**6. Z. R.M. me detyrë Drejtor Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;**

Për moszbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mosmarrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 236,557 mijë lekë, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3., nenin 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, si dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj

Për hartimin e fondit limit jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në dy procedura prokurimi dhe për vendimmarrjen jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, si kryetar i KVO-së në një procedurë prokurimi;

**7. Z. G.D. me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit,**

Për mosmarrjen e masave efektive për të ulur ndjeshëm numrin e debitorëve historikë për rritur arkëtimet e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit të periudhës 2018-2022.

Për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, në pesë procedura prokurimi,

**8. Z. T.F., si kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 5 procedura prokurimi;**

**9. Z. A.M., si anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 5 procedura prokurimi;**

**10. Z. E.D., si anëtar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 3 procedura prokurimi dhe anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 2 procedura prokurimi;**

**11. Z. A.P., si kryetar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 3 procedura prokurimi dhe anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 2 procedura prokurimi;**

Për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit, etj.

**b) Vërejtje, për punonjësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. M.D. me detyrë përgjegjes Sektori i Planifikimit dhe vlerësimit të taksave;**

**2. Znj. K.O. me detyrë përgjegjës Sektori i taksa e tarifa Familjare;**

**3. Z. A.L. me detyrë përgjegjës i Sektorit të biznesit;**

Për moszbatim të detyrave funksionale lidhur me hapat administrative dhe ligjorë për mbledhjen e të ardhurave dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga taksat edhe tarifat vendore, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, DTTë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu

II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj

4. Z. A.I., si kryetar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 5 procedura prokurimi;
  5. Z. A.K., si kryetar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 2 procedura prokurimi dhe anëtar në 2 procedura prokurimi;
  6. Z. E.S., si anëtar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 4 procedura prokurimi;
  7. Znj. D.G., si kryetare e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për veprime/mosveprime jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 1 procedurë prokurimi;
  8. Znj. D.S., si anëtare e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për veprime/mosveprime jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 1 procedurë prokurimi;
  9. Znj. A.S., si anëtar i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, për veprime/mosveprime jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 1 procedurë prokurimi;
  10. Z. A.P., si anëtar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 4 procedura prokurimi;
  11. Z. S.C., si anëtar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 3 procedura prokurimi dhe anëtar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 1 procedurë prokurimi;
  12. Z. E.S., për vendosjen e kriterëve të tepërta, të gabuara ose të paargumentuara në 2 procedura prokurimi;
  13. Z. A.V., si kryetar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 1 procedurë prokurimi;
  14. Znj. R. B., si anëtare e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 1 procedurë prokurimi;
  15. Z. D.B., si anëtar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të tenderit në 1 procedurë prokurimi;
  16. Z. S.K., si anëtar i Komisionit për Hartimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike jo në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik në 1 procedurë prokurimi;
- Për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, etj.

**E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Për z. J.K., me detyrë Kryeinspektor i IMTV, për mospërmbyllje të detyrave funksionale të përcaktuara në Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar; Ligji nr. 183/2014 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 894 datë

04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

#### **F. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vorë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarre veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

#### **G. MASA ADMINISTRATIVE**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar me nenin 12 të Ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, *i rekomandojmë* Titullarit të Bashkisë Vorë, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative ndaj:

Operatorit Ekonomik “D.” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. V.T., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara në kontratën me objekt: “Sistemim, asfaltim i rrugëve Kodra e Miut dhe rindërtimi i fshatit Marqinet 2, Bashkia Vorë”, datë 22.02.2022, për punime të deklaruara më tepër, të përfituara padrejtësisht nga kontraktori në vlerën 240,672 lekë me TVSH.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

#### **GRUPI I AUDITIMIT**

J.P.

S.J.

K.P.

K.F.

O.F.

A.K.

## **DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

B.D.